



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2026 – Numri: 172

Tiranë – E mërkurë, 5 gusht 2026

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 82/2026, datë 23.7.2026	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar..... 17521
Dekret i Presidentit nr. 466, datë 3.8.2026	Për shpallje ligji..... 17522
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 604, datë 30.7.2026	Për transferimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes tek Bashkia Peqin, të pasurisë nr. 15/46, zona kadastrale 2908, për një shtesë në vendimin nr. 510, datë 6.7.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Peqin, të qarkut të Elbasanit”, të ndryshuar, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar..... 17523
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 609, datë 30.7.2026	Për përcaktimin e procedurave specifike për importimin, hedhjen për konsum, lëvizjen, kontrollin, mbikëqyrjen, ngjyresit dhe shënjesit e nënprodukteve të naftës..... 17525
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 610, datë 30.7.2026	Për rregullat, procedurat, shpenzimet dhe kompensimin financiar për shërbimet jashtë vendit të punonjësve..... 17533
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 616, datë 30.7.2026	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 466, datë 30.7.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Strategjisë së Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve, 2021–2027, dhe të planit të saj të veprimit”, të ndryshuar..... 17538
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 627, datë 30.7.2026	Për miratimin e organizimit dhe zhvillimit të programit “Pas shkolle” të kategorive, kritereve dhe mënyrës së përzgjedhjes, shpërblimit të trajnuesve, si dhe mënyrës së financimit të këtij programi..... 17565

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 630, datë 30.7.2026	Për krijimin e Regjistrit Kombëtar të Aktivitetit të Licencuar dhe të Lejuar të Bimës së <i>Cannabis</i> -it.....	17568
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 631, datë 30.7.2026	Për krijimin e Institutit Kombëtar Onkologjik, si strukturë shëndetësore universitare dhe kërkimore-shkencore.....	17571



LIGJ
Nr. 82/2026

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË LIGJIN NR. 7850, DATË 29.7.1994,
“KODI CIVIL I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË”, I NDRYSHUAR¹

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 463 shtohet paragrafi i dytë me këtë përmbajtje:

“Përjashtimisht, afatet e ekzekutimit të detyrimeve monetare dhe lindjen e kamatëvonesave në transaksionet tregtare ndërmjet sipërmarrjeve, si dhe ndërmjet sipërmarrjeve dhe autoriteteve publike rregullohen sipas parashikimeve të ligjit për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare.”.

Neni 2

Neni 628 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 628

Prodhuesi është përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga të metat e produkteve të tij, përveç kur:

a) prodhuesi ose importuesi nuk ka vënë në qarkullim produktet në treg ose në shërbim;

b) në rastin e një distributori, ky i fundit nuk e ka bërë produktin të disponueshëm në treg;

c) sipas rrethanave të vërtetuara, vlerësohet sipas ligjit se të metat që kanë shkaktuar dëmin nuk ekzistojnë në kohën e vënies në qarkullim të produktit në treg, të vënë në shërbim ose, në rastin e një distributori, të bëres të disponueshëm në treg, ose ato kanë lindur më vonë;

ç) produkti nuk ka qenë prodhuar për shitje ose ndonjë formë tjetër shpërndarjeje, me qëllim të caktuar ekonomik të prodhuesit, as edhe i prodhuar ose i shpërndarë në kuadrin e një ndërmarrjeje ose veprimtarie profesionale;

d) të metat janë rrjedhim i faktit se produkti ka qenë në përputhje me kërkesat ligjore;

dh) njohuritë shkencore e teknike nuk kanë mundur të zbulojnë të metat në kohën e vënies në qarkullim të produktit në treg ose në shërbim ose gjatë periudhës në të cilën produkti ishte nën kontrollin e prodhuesit;

e) është fjala për prodhimin e një lënde të parë ose fabrikimin e një pjese përbërëse të produktit, të cilat në formimin e produktit rezultojnë me të meta ose si rrjedhojë e udhëzimeve të gabuara të dhëna nga prodhuesi i produktit;

ë) në rastin e një personi që modifikon një produkt, e meta që shkaktoi dëmin lidhet me një pjesë të produktit që nuk është prekur nga modifikimi.”.

Neni 3

Në nenin 629 shtohen paragrafët e tretë dhe të katërt me këtë përmbajtje:

“Përgjegjësia e prodhuesit ndaj personit të dëmtuar nuk mund të kufizohet ose përjashtohet nëpërmjet klauzolave kontraktuale ose me ligj.

¹ Ky ligj është përafëruar pjesërisht me:

- Direktivën 2011/7/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 16 shkurt 2011, “Për luftën kundër pagesave të vonuara në transaksionet tregtare”. Numri CELEX 32011L0007, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 48, datë 23.2.2011, faqe 1–10.

- Direktivën (BE) 2024/2853 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 23 tetor 2024, “Për përgjegjësinë për produktet me të meta dhe që shfuqizon Direktivën e Këshillit 85/374/KEE”.

Numri CELEX 32024L2853, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, 2024/2853, datë 18.11.2024.

- Direktivën (BE) 2015/2366 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 25 nëntor 2015, “Për shërbimet e pagesave në tregun e brendshëm, që ndryshon Direktivat 2002/65/KE, 2009/110/KE dhe 2013/36/BE dhe Rregulloren (BE) nr. 1093/2010, dhe që shfuqizon Direktivën 2007/64/KE”, e ndryshuar. Numri CELEX 32015L2366, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 337, datë 23.12.2015, faqe 35–127.



Parashikimet e këtij neni janë të zbatueshme edhe për operatorët ekonomikë sipas nenit 631 të këtij Kodi.”.

Neni 4

Në nenin 630, paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë:

“Një send quhet se është me të meta kur nuk jep sigurinë që pritet prej tij, duke pasur parasysh gjithë rrethanat, e në veçanti:

a) paraqitjen dhe karakteristikat e produktit, duke përfshirë etiketimin, dizajnin, karakteristikat teknike, përbërjen dhe paketimin e tij dhe udhëzimet për montimin, instalimin, përdorimin dhe mirëmbajtjen e tij;

b) përdorimin e arsyeshëm që pritet prej produktit;

c) efektin në produkt të çdo aftësie për të vazhduar të mësojë ose të fitojë karakteristika të reja pasi të vendoset në treg ose të vihet në shërbim;

ç) efektin e arsyeshëm të parashikueshëm në produkt nga produkte të tjera që pritet të përdoren së bashku me produktin, duke përfshirë edhe me anë të ndërlidhjes;

d) kohën kur produkti u vendos në treg ose u vendos në shërbim, ose kur prodhuesi ruan kontrollin mbi produktin pas atij momenti, kohën kur produkti del nga kontrolli i prodhuesit;

dh) kërkesat përkatëse të sigurisë së produktit, duke përfshirë kërkesat e sigurisë kibernetike që lidhen me sigurinë;

e) çdo tërheqje e produktit ose çdo ndërhyrje tjetër përkatëse që lidhet me sigurinë e produktit nga një autoritet kompetent ose nga prodhuesi;

ë) nevojat specifike të grupit të përdoruesve për përdorimin e të cilëve është parashikuar produkti;

f) në rastin e një produkti qëllimi i të cilit është parandalimi i dëmtimit, çdo dështim i produktit për të përmbushur atë qëllim.”.

Neni 5

Në nenin 631 bëhen këto ndryshime:

1. Në paragrafin e parë, togfjalëshi “duke përjashtuar produktet bujqësore dhe produktet e rrjedhura nga gjuetia” zëvendësohet me togfjalëshin “skedat e prodhimit digjital, lëndët e para dhe programet softuer”;

2. Paragrafi i dytë shfuqizohet.

3. Në paragrafin e katërt pas fjalës “prodhues” shtohet togfjalëshi “çdo përfaqësues i autorizuar i prodhuesit, si dhe çdo operator ekonomik që vendos në treg një produkt, që vendos në shërbim produktin ose”.

Neni 6

Në nenin 1022, paragrafi i tretë, pas fjalës “rekomande” shtohet togfjalëshi “përveç rastit kur parashikohet ndryshe me ligj”.

Neni 7

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 23.7.2026.

Shpallur me dekretin nr. 466, datë 3.8.2026, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

DEKRET

Nr. 466, datë 3.8.2026

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 82/2026, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7850, datë 29.7.1994, ‘Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë’, i ndryshuar”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**



VENDIM

Nr. 604, datë 30.7.2026

PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TEK BASHKIA PEQIN, TË PASURISË NR. 15/46, ZONA KADASTRALE 2908, PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 510, DATË 6.7.2011, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË PEQIN, TË QARKUT TË ELBASANIT”, TË NDRYSHUAR, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 8, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

zona kadastrale 2908, me vendndodhje në njësinë administrative Peqin, sipas formularit gjithsej 1 (një) fletë dhe planit të rievimit gjithsej 1 (një) fletë, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij, me qëllim përdorimin për realizimin e funksioneve administrative të saj.

2. Pasuria e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, i shtohet listës së inventarit, që i bashkëlidhet vendimit nr. 510, datë 6.7.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Peqin, të qarkut të Elbasanit”, të ndryshuar.

3. Pasuria e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, me numër rendor 352 dhe me emërtimin “Dega e mobilizimit”, Peqin, sipas listës së inventarit, që i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar, hiqet nga kjo listë.

4. Bashkisë Peqin i ndalohet të ndryshojë destinacionin e pasurisë së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi.

5. Ngarkohen Bashkia Peqin, Ministria e Mbrojtjes dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

VENDOSI:

KRYEMINISTËR

Edi Rama

1. Transferimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes tek Bashkia Peqin, të pasurisë nr. 15/46,

1.FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE
(Per inventarizimin e pronave te vecanta)

Bashkia Peqin				Identifikoi: Ilir Zyba Specialist DPKTMP							
				Supervizoi: Anita Dehima Pergjegjes DPKTMP							
Fusha e përdorimit të Pronës : Administrate				Aprovoi : Bukurosh Maçi Kryetar i Bashkisë							
Nr. Rendor	A		B				C				
	Zona kadastrale & Indexi i Hartes	Nr. Pasurisë	Lloji i Pronës	Emri i Pronës Adresa	Sip Totale e Pronës (m2)	Nga sip totale : Sa ndertese (m2)	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni/ Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni/ Enti perdorues Statusi juridik i	Te dhena te tjera (Shenime te vecanta)	
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	
1	2908 PE-F-5	15/46	Truall + Ndertese	"Ish-Qender Mobilizimi" Bashkia Peqin	409	193.93	Administrate	Bashkia Peqin	Bashkia Peqin	2Kat	



PLAN RILEVIMI PËR PUNIME KADASTRALE					
PRONAR: MINISTRIA E MBROJTJES		DATË: 18/03/2026		QËLLIMI: TRANSFERIM	
VENDNDODHJA					
BASHKIA: PEQIN		ZV.ASHK/DV.ASHK: DVASHK ELBASAN		ZONA KADASTRALE: 2908	
TE DHENAT E PASURISË		NUMRI I PASURISË: 15/46		INDEKSI I HARTËS: PE; F-3	
LLOJI PASURISË: TRUALL		SIP.PASURISË: 409 M2		SIP.GJURME NDËRTESE: 193.93 M2	
		NUMRI KATEVE: 2 KT		NUMRI PËMEVE:	
X = 479726.3439 Y = 4545540.5033		KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE		X = 479820.7198 Y = 4545540.5033	
SHPJEGUES KUFIRI I PASURISË NR.15/46 SIPAS GJENDJES FAKTIKE SIPËRFAQE TRUALLI=409 m² SIPËRFAQE GJURME NDËRTESE=193.93 m² NDËRTESEA ËSHTË 2 KATE.					
X = 479726.3439 Y = 4545470.8367		SH 1:500		X = 479820.7198 Y = 4545470.8367	
Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT
1	V		HARTË KADASTRALE	15/200	
2	L		HARTË KADASTRALE	15/229	
3	J		HARTË KADASTRALE	15/228	
4	P		HARTË KADASTRALE	15/223	
REALIZOI PËR BASHKINË PEQIN: PUNDI ILIR ZYBA NËNSHKRIMI DREJTORI: JOHAN SALLUFI NËNSHKRIMI KRYETARI: BUKUROSH MAÇI TEKNOLOGJIA E MATJEVE: T,Z,O,G Kode per teknologjine e matjeve: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Station Total,D-Matje Distancash; HK-Harte Kadastrale; PERCAKTIMI KUFIRIT: HK,P Kode per percaktimin e kufirit:P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale; SHENIME TE VECANTA: PLANI I RILEVIMIT ËSHTË HARTUAR BAZUAR NË GJENDJEN FAKTIKE. SHENIMI KËRKOHET TRANSFERIMI I PASURISË NR.15/46 ME SIPËRFAQE TRUALL= 409 m² DHE SIPËRFAQE GJURME NDËRTESE= 193.93 m². NDËRTESEA ËSHTË 2 KATE. PRONARI/BASHKEPRONARËT-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET NËNSHKRIMI: _____					
Kode per teknologjine e matjeve dhe percaktimi kufirit: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Station Total; D-Matje Distancash; P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale					

VENDIM

Nr. 609, datë 30.7.2026

**PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE
SPECIFIKE PËR IMPORTIMIN,
HEDHJEN PËR KONSUM, LËVIZJEN,
KONTROLLIN, MBIKËQYRJEN,
NGJYRUESIT DHE SHËNJUESIT E
NËNPRODUKTEVE TË NAFTËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 54, të ligjit nr. 61/2012, “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. PËRKUFIZIME

Në kuptim të këtij vendimi, termat dhe shprehjet e mëposhtme kanë këto kuptime:

1. **“Autoritet”**, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

2. **“Ditë punë”**, një ditë gjatë së cilës kryhet puna në Republikën e Shqipërisë, me përjashtim të ditëve të pushimeve dhe festave zyrtare.

3. **“Çmimi i shërbimit të shënjimit”**, tarifa kombëtare e shërbimit të shënjimit, që do t’i paguhet shoqërisë “ALBTrace CO” sh.a., nga subjektet e detyruara dhe do të jetë në shumën prej 6.5 (gjashtë pikë pesë) euro pa TVSH, për 1 000 (një mijë) litra të shënuara.

4. **“Balanca e disponueshme”**, fondet monetare të transferuara paraprakisht nga subjektet e detyruara në llogarinë e posaçme të shërbimit të shënjimit, të cilat, pas konfirmimit të pranimit të pagesës dhe regjistrimit në sistemin zyrtar të shënjimit, përbëjnë kredinë e disponueshme për përdorim nga subjekti, vetëm për kryerjen e shërbimit të shënjimit të karburanteve.

5. **“ALBTrace CO sh.a.”**, ofruesi i shërbimit të shënjimit të karburanteve, që është shoqëria e angazhuar nga qeveria për realizimin e komponentit teknik dhe operativ të sistemit, duke përfshirë sigurimin dhe përdorimin e pajisjeve dhe instrumenteve përkatëse, kryerjen e testeve në terren dhe testeve konfirmuese, si dhe mbështetjen e proceseve të monitorimit në autoritetin dhe nën mbikëqyrjen e administratës doganore.

6. **“Shënjuesi”**, *Ready To Use Marker* (RUM), substanca shënjuese që injektohet nga shoqëria

“ALBTrace CO” sh.a. në produktet që i nënshtrohen shënjimit, duke mundësuar verifikimin e shlyerjes së detyrimeve fiskale përkatëse. RUM-i përbën shënjuesin zyrtar dhe furnizohet ekskluzivisht nga shoqëria “ALBTrace CO” sh.a., e cila zotëron ekskluzivisht të drejtën përkatëse të teknologjisë “*know-how*” për përdorimin e tij.

7. **“Sistemi i integritetit të karburanteve”** (*Fuel Integrity Solution*) (FIS), një sistem i integruar, i administruar nga shoqëria “ALBTrace CO” sh.a., që mundëson monitorimin, kontrollin dhe gjurmueshmërinë e karburanteve përgjatë zinxhirit të furnizimit, ndërsa të dhënat janë pronë e shtetit dhe autoritetit doganor, me qëllim garantimin e cilësisë, integritetit dhe ligjshmërisë së tyre.

8. **“Personeli i autorizuar”**, personeli i shoqërisë “ALBTrace CO” sh.a., i caktuar nga ky i fundit për ta ndihmuar në instalimin, vënien në punë dhe zbatimin e shërbimit të shënjimit dhe gjurmimit dhe për të përfaqësuar kompaninë.

9. **“Produktet e shënjimit”**, produktet e bardha (gazoil dhe benzen), konform standardeve përkatëse të cilësisë dhe që kanë për destinacion hedhjen në qarkullim të lirë, përveç produkteve që janë të përjashtuara/të reduktuara nga taksat, sipas parashikimeve të legjislacionit doganor; specifikuat produktet me emërtimet dhe klasifikimin tarifor të NKM-së, si vijon: gazoil (27101942, 27101944, 27101946, 29101948 dhe 27102011), benzinë pa plumb (27101241, 27101245 dhe 27101249).

10. **“Subjektet e detyruara”**, të gjitha subjektet, që tregtojnë, importojnë, shpërndajnë, transportojnë, magazinonë, prodhojnë, rafinojnë ose kryejnë çdo aktivitet tjetër tregtar me produktet e shënjimit, që janë të detyruara të paguajnë detyrimet fiskale për këto produkte dhe të kërkojnë kryerjen e shërbimit, sipas kuadrit ligjor në fuqi dhe këtij vendimi.

11. **“Shërbimi i shënjimit”**, procesi i shënjimit dhe gjurmimit/monitorimit të produkteve të shënjimit, i cili përbëhet nga dy fazat, si më poshtë vijon:

a) **“Shërbimi i shënjimit”**, që nënkupton procesin nëpërmjet të cilit në produktet e karburantit injektohet shënjuesi nga shoqëria “ALBTrace CO” sh.a.;

b) **“Shërbimi i gjurmimit/monitorimit”**, që nënkupton procesin e monitorimit dhe kontrollit të produkteve të shënjimit, i kryer nën autoritetin dhe mbikëqyrjen e administratës doganore, duke u



mbështetur në teknologjitë dhe sistemet e vëna në dispozicion nga shoqëria “ALBTrace CO” sh.a.;

12. **“Pajisjet e shënjjimit”**, pajisjet elektronike, mekanike dhe *software*-ike të vendosura në terminale, rafineri, depo dhe çdo pikë tjetër të përcaktuar nga autoriteti dhe shoqëria “ALBTrace CO” sh.a., të cilat sigurojnë injektimin e shënjjuesit, regjistrimin e sasisë së injektuar, monitorimin e proceseve dhe garantimin e integritetit të të dhënave të shënjjimit në kohë reale.

13. **“Formulari i vetëdeklarimit”**, dokumenti standard, sipas aneksit I të këtij vendimi, që plotësohet nga subjekti i detyruar, nëpërmjet të cilit deklarohen të dhënat teknike të autobotit dhe sasitë e karburantit sipas dhomave (kompartimenteve) të autocisternës, mbi bazën e dokumentacionit provues ose të dhënave të matjes gjatë procesit të ngarkimit.

Subjekti i detyruar mban përgjegjësi për saktësinë dhe vërtetësinë e të dhënave të deklaruara në këtë formular, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

14. **“Certifikata e shënjjimit të karburantit”**, dokumenti zyrtar, teknik dhe rregullator, i lëshuar nga shoqëria “ALBTrace CO” sh.a., i cili vërteton kryerjen e procesit të shënjjimit dhe përmbajtjen e tij, në përputhje me kërkesat teknike dhe procedurale të përcaktuara. “Certifikata e shënjjimit të karburantit” shërben si provë dokumentare, për:

a) kryerjen e procesit të shënjjimit në vendndodhjen dhe kohën e përcaktuar;

b) identifikimin e llojit të karburantit, sasisë së shënjjuar dhe subjektit përkatës;

c) gjurmueshmërinë e karburantit përgjatë zinxhirit të furnizimit përmes Sistemit të Integritetit të Karburanteve ALBTrace;

II. FUSHA E ZBATIMIT

1. Në përputhje me këtë vendim, subjektet e detyruara pajisen me shërbimin e shënjjimit për të gjitha produktet e shënjjimit në momentin që çlirohen për qarkullim të lirë.

2. Në përputhje me këtë vendim, subjektet e detyruara pajisen me shërbimin e shënjjimit për të gjitha produktet e shënjjimit në momentin që çlirohen për qarkullim të lirë, të cilat hidhen në treg pas fazës së ciklit të furnizimit, përfshirë prodhimin, rafinimin, magazinimin, shpërndarjen dhe çdo proces tjetër, të përcaktuar në legjislacionin në fuqi.

3. Shënjjuesi injektohet në brendësi të produkteve të shënjjimit nga personeli i autorizuar i shoqërisë “ALBTrace CO” sh.a., me anë të teknologjisë së

posaçme të vendosur në dispozicion nga kjo e fundit, duke garantuar saktësinë, sigurinë dhe gjurmueshmërinë e plotë të procesit të shënjjimit.

III. NDALIMET

Subjektet e detyruara pajisen me shërbimin e shënjjimit për të gjitha produktet e shënjjimit të zotëruara prej tyre. Ndalohet:

a) tregtimi, importimi, shpërndarja, transportimi, magazinimi ose kryerja e çdo aktiviteti tjetër tregtar me produktet e shënjjimit që nuk përmbajnë shënjjuesin e injektuar nga shoqëria “ALBTrace CO” sh.a., sipas procedurave të hollësishme, të përcaktuara në këtë vendim;

b) importimi, prodhimi, mbajtja, shitja ose disponimi në çfarëdo mënyre i substancave të ngjashme me shënjjuesin ose që pretendohen të ngjashme me shënjjuesin nga subjekte të ndryshme nga shoqëria “ALBTrace CO” sh.a. apo personeli i autorizuar i shoqërisë “ALBTrace CO” sh.a., me përjashtim të subjekteve, rregullisht të kontraktuara nga kjo shoqëri dhe të autorizuar prej saj për këtë qëllim;

c) kryerja e çdo ndërhyrjeje teknike, manipuluese ose devijuese në pajisjet, aparaturat matëse, *software*-ët e monitorimit apo çdo teknologji tjetër të vënë në dispozicion nga shoqëria “ALBTrace CO” sh.a., për kryerjen e shërbimit të shënjjimit dhe gjurmimit;

ç) kryerja e çdo veprimi, që ka për qëllim ose efekt të pengojë, të shmangë, të devijojë apo të dëmtojë në çfarëdo forme procesin e shënjjimit, gjurmimit, monitorimit, verifikimit apo raportimit të të dhënave të lidhura me shërbimin e shënjjimit.

IV. PROCEDURAT PËR POROSITJEN, PAGESËN DHE KRYERJEN E SHËRBIMIT TË SHËNJJIMIT

1. Shoqëria ALBTrace CO” sh.a. menaxhon urdhrat e shënjjimit, si dhe planifikon disponueshmërinë e shënjjuesit (RUM), si dhe sigurimin e vazhdimësisë dhe ofrimit të pandërprerë të shërbimit të shënjjimit të karburanteve.

2. Subjektet e detyruara porosisin dhe kryejnë pagesën e shërbimit të shënjjimit pranë shoqërisë “ALBTrace CO” sh.a.

3. Çmimi i shërbimit të shënjjimit është në vlerën 6.5 (gjashtë pikë pesë) euro pa TVSH për çdo 1 000 (një mijë) litra karburant të shënjjuar.

4. Procesi i parapagimit për shërbimin e shënjjimit të karburanteve fillon në momentin kur subjekti i detyruar kryen një pagesë, me qëllim sigurimin ose rritjen e balancës së parapaguar të disponueshme për



shërbimin e shënjimit, përmes llogarive bankare të rëna dakord dhe duke përdorur referencë faturimin e kryer nga shoqëria “ALBTrace CO” sh.a., për parapagimin përkatës. Fondet transferohen nga llogaria bankare e subjektit të detyruar në llogarinë bankare të posaçme të përcaktuar të shoqërisë “ALBTrace CO” sh.a.

5. Balanca e parapaguar përbën kredinë monetare të disponueshme të subjektit të detyruar për mbulimin e kostove të shërbimit të shënjimit dhe nuk mund të jetë, në asnjë rast, më e ulët se 6,5 (gjashtë presje pesë) euro, shumë e cila mbulon koston minimale të shënjimit për një sasi prej 1 000 (një mijë) litrash karburant.

6. Pas marrjes së fondeve, shoqëria “ALBTrace CO” sh.a. verifikon pagesën për sa i përket përfundimit të transfertës, saktësisë së shumës dhe monedhës, si dhe përputhshmërisë së referencës së pagesës me subjektin e detyruar përkatës. Deri në përfundimin e këtij verifikimi, fondet nuk konsiderohen të disponueshme për përdorim në sistemin e shënjimit.

7. Pas përfundimit të verifikimit, parapagimi regjistrohet në Sistemin e Integritetit të Karburanteve, duke kredituar balancën e parapaguar të subjektit të detyruar, e cila bëhet menjëherë e përdorshme për kryerjen e operacioneve të shënjimit. Sistemi i Integritetit të Karburanteve shërben si sistemi zyrtar i regjistrimit të balancës së parapaguar dhe siguron zbritjen e saktë dhe automatike të çdo përdorimi të mëtejshëm të shënjuesit. Në mungesë të kredisë minimale të përcaktuar, procesi i shënjimit pezullohet automatikisht deri në rikthimin e saj në nivelin minimal të kërkuar.

8. Pas përditësimit të balancës së parapaguar, shoqëria “ALBTrace CO” sh.a. njofton subjektin e detyruar përmes një njoftimi zyrtar elektronik të transmetuar nëpërmjet postës elektronike, duke konfirmuar kreditimin e balancës së parapaguar dhe disponueshmërinë e fondeve për përdorim operacional, në kuadër të shërbimit të shënjimit.

9. Shërbimi i shënjimit realizohet nga shoqëria “ALBTrace CO” sh.a., pas shlyerjes së të gjitha detyrimeve fiskale të zbatueshme që lidhen me karburantet, objekt akcize.

10. Autoritetet doganore apo tatimore, sipas rastit, refuzojnë çdo shlyerje të detyrimeve fiskale nga subjektet e detyruara nëse shërbimi i shënjimit nuk është kryer për karburantet përkatëse, në

përputhje me parashikimet e ligjit nr. 61/2012, “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, dhe në funksion të statusit të shoqërisë “ALBTrace CO” sh.a. si magazinë fiskale.

11. Administrata doganore ushtron funksionin e saj mbikëqyrës dhe verifikues mbi këtë proces, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

12. Pas përfundimit të procesit të shënjimit të karburanteve, shoqëria “ALBTrace CO” sh.a. gjeneron “Certifikatën e shënjimit të karburanteve”, e cila përbën provë të përmbushjes së detyrimeve për shënjimin e karburanteve të parashikuara në këtë vendim dhe përdoret për qëllime monitorimi dhe kontrolli nga autoritetet kompetente.

13. Çdo porosi shënjimi e paraqitur për ofrimin e shërbimit të shënjimit të karburanteve duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

a) Identitetin e subjektit që kërkon kryerjen e shërbimit të shënjimit;

b) Llojin e karburantit;

c) Vëllimin e karburantit të specifikuar në faturë dhe në kalimatës;

ç) Kapacitetin total të autobotit, numrin e kompartimenteve (dhomave), kapacitetin individual të secilit kompartiment si dhe llojin e karburantit të transportuar në secilin kompartiment;

d) Destinacionin e furnizimit/dërgesës së karburantit dhe identitetin e subjektit pritës;

dh) Dokumentacionin provues që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të zbatueshme të akcizës dhe detyrimeve të tjera fiskale, sipas verifikimit të kryer nga administrata doganore.

14. Shoqëria “ALBTrace CO” sh.a. regjistron porositë e marra në sistemin FIS. Shërbimi i shënjimit të karburanteve do të kryhet nga personeli i autorizuar i shoqërisë “ALBTrace CO” sh.a., në pikat e caktuara për shënjim, siç specifikohet në porosinë e bërë/deklaruar nga secili subjekt i detyruar.

15. Pas marrjes së porosive dhe konfirmimit të pagesës, shoqëria “ALBTrace CO” sh.a. kryen shërbimin e shënjimit “sa më parë të jetë e arsyeshme”, por, në çdo rast, jo më vonë se 24 (njëzet e katër) orë nga data e konfirmimit të pagesës për marrjen e porosisë nga shoqëria “ALBTrace CO” sh.a.

16. Subjektet e detyruara, të cilat porosisin pranë shoqërisë “ALBTrace CO” sh.a., shërbimin e shënjimit pas pagesës së çmimit të shërbimit të



shënjimit, përfitojnë shërbimin përkatës dhe pajisen me konfirmimin përkatës të kryerjes së tij.

V. REALIZIMI I SHËRBIMIT TË SHËNJIMIT

1. Shënjimi i detyrueshëm i lëndëve djegëse përfshin të gjitha produktet e bardha (gazoil dhe benzen), sipas standardeve përkatëse të cilësisë dhe që kanë për destinacion hedhjen në qarkullim të lirë, përveç produkteve që janë të përjashtuara/të reduktuara nga taksat, sipas parashikimeve të legjislacionit doganor; specififikisht produktet me emërtimet dhe klasifikimin tarifor të NKM,-së si vijon: gazoil (27101942, 27101944, 27101946, 29101948 dhe 27102011), benzinë pa plumb (27101241, 27101245 dhe 27101249), përpara vënies së tyre në treg.

2. Shoqëria “ALBTrace CO” sh.a. ka të drejtën ekskluzive për të ofruar shërbimin e shënjimit të karburanteve në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë për të gjitha produktet e shënjimit, si dhe për të arkëtuar çmimin e shërbimit të shënjimit të karburanteve.

3. Shënjimi i karburanteve do të realizohet në 4 pika shënjimi të ngritura dhe të instaluar nga shoqëria “ALBTrace CO” sh.a. dhe të shpërndara në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas nevojave të dakordësuara me DPD-në.

4. Të gjitha subjektet e detyruara, përpara fillimit të procesit të shënjimit janë të detyruara të paraqesin pranë përfaqësuesit të autorizuar, i cili ndodhet në pikën e shënjimit të shoqërisë “ALBTrace CO” sh.a., të miratuar nga DPD-ja, dokumentacionin e detyrueshëm për fillimin e procesit të shënjimit, si më poshtë vijon:

a) Certifikatën e regjistrimit të subjektit (Numri i identifikimit të personit të tatueshëm – NIPT);

b) Konfirmimin e parapagimit ose të disponueshmërisë së një balance të mjaftueshme për ofrimin e shërbimit të shënjimit në sistemin përkatës, si dhe konfirmimin e shlyerjes së të gjitha taksave dhe detyrimeve të zbatueshme;

c) Faturën e shitjes së lëshuar nga importuesi, ku përcaktohen sasi të dhe lloji i karburantit, i cili do t'i nënshtrohet shënjimit;

ç) Vetëdeklarimin/dokumentacionin zyrtar provues (nga procesi i matjes gjatë ngarkimit të karburantit) për sasi të përkatëse, sipas dhomave (kompartimenteve) të autocisternës, në rastet kur këto të dhëna nuk janë të pasqyruara në faturën tatimore. Vetëdeklarimi kryhet nëpërmjet formularit

standard, sipas aneksit I të këtij vendimi, i cili plotësohet nga subjekti i detyruar mbi bazën e të dhënave të sakta dhe të verifikueshme, përfshirë të dhënat që rezultojnë nga procesi i matjes gjatë ngarkimit të karburantit (p.sh. përmes pajisjeve matëse – kalimatës). Subjekti i detyruar mban përgjegjësi të plotë për saktësinë dhe vërtetësinë e të dhënave të deklaruara në këtë formular, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

5. Pa plotësimin dhe verifikimin paraprak të dokumentacionit të parashikuar në pikën 4, procedura e shënjimit të karburanteve nuk lejohet të iniciohet.

6. Në rast mospërputhjeje të dokumentacionit ose konstatimit të shkeljeve nga ana e subjektit gjatë procesit, shoqëria “ALBTrace CO” sh.a. pezullon procesin e shënjimit dhe njofton subjektin që të plotësojë dhe të rregullojë mospërputhjet e konstatuara. Në rast mosplotësimi shoqëria “ALBTrace CO” sh.a. njofton autoritetet doganore për mospërputhjet e konstatuara.

VI. PROCEDURA E SHËNJIMIT TË KARBURANTEVE NGA SHOQËRIA “ALBTRACE CO” SHA

Në zbatim të këtij vendimi dhe në dakordësi me autoritetin doganor, përcaktohen 4 (katër) pika shënjimi të karburanteve, të shpërndara në mënyrë strategjike në territorin e Republikës së Shqipërisë, në të cilat kryhet procesi i shënjimit nga shoqëria “ALBTrace CO” sh.a., në përputhje me procedurat e miratuara në zbatim të këtij vendimi dhe kërkesat ligjore në fuqi.

1. Shoqëria “ALBTrace CO” sh.a., përpara fillimit të çdo procedure të shënjimit të karburanteve, verifikon dokumentacionin e paraqitur nga subjekti detyrues, sipas përcaktimeve në pikën 2, të këtij vendimi.

2. Personeli i autorizuar përgatit sasinë e nevojshme të shënjuesit, bazuar në vëllimin e dokumentuar për secilin kompartiment. Sasia e shënjuesit zyrtar të nevojshëm për shënjimin e autobotëve llogaritet me saktësi, duke përdorur pajisjet e dozimit në zonën e punës nga personeli i autorizuar i shoqërisë “ALBTrace CO” sh.a.

3. Pasi autoboti të jetë gati për shënjim, enët e dozimit të përgatitura transportohen në rampën përkatëse për përdorim të menjëhershëm. Enët e përgatitura të dozimit nuk lihen në asnjë moment dhe në asnjë rrethanë pa mbikëqyrje nga personeli i autorizuar i shoqërisë “ALBTrace CO” sh.a.



4. Shoqëria “ALBTrace CO” sh.a., kryen veprimet, si më poshtë vijon:

a) Verifikimin vizual të ndarjeve të brendshme të autobotit. Personeli i autorizuar i shoqërisë “ALBTrace CO” sh.a. kryen verifikimin vizual të njësisë së transportit të karburantit dhe të vëllimit të karburantit në secilin kompartment, si dhe kryen rakordimin e tyre me planin e shënjitimit, faturën tatimore dhe dokumentacionin tjetër shoqërues;

b) Aplikimin e shënjesit: Personeli i autorizuar i shoqërisë “ALBTrace CO” sh.a. dozon sasinë përkatëse të shënjesit në kompartmentet e autobotit përmes ngarkimit nga sipër;

c) Regjistrimin në sistem: Shoqëria “ALBTrace CO” sh.a. regjistron në Sistemin e Menaxhimit të Integritetit të Karburanteve (FIS) të dhënat për sasinë e shënjesit zyrtar të aplikuar, numrin e shërbimit, identifikimin e subjektit, targën e mjetit, llojin e karburantit, detajet e kompartmenteve dhe vëllimet përkatëse. Të gjitha operacionet e dozimit kryhen në prani të dëshmitarëve të caktuar. Emrat dhe nënshkrimet e personelit të autorizuar dhe të dëshmitarëve regjistrohen dhe përfshihen në “Certifikatën e shënjitimit të karburanteve”, të lëshuar nga shoqëria “ALBTrace CO” sh.a.;

ç) Lëshimin e certifikatës së shënjitimit: Pas përfundimit të procesit të shënjitimit, shoqëria “ALBTrace CO” sh.a. konfirmon në aplikacion se transaksioni është kryer saktë dhe lëshon “Certifikatën e shënjitimit të karburanteve”, në përputhje me procedurat dhe kërkesat në fuqi. Çdo transaksion i shënjitimit duhet të konfirmohet me nënshkrim nga operatori i shoqërisë “ALBTrace CO” sh.a. dhe mbikëqyrësit e kësaj shoqërie, si dhe shoferi i autobotit ose përfaqësuesi i Shoqërisë së Tregtimit të Karburanteve, sipas rastit.

5. Të gjitha nënshkrimet duhet të jenë të qarta, të lexueshme dhe në përputhje me dokumentacionin përkatës të paraqitur. Nënshkrimet kryhen në formë fizike ose elektronike, sipas procedurave të miratuara dhe sistemeve elektronike në përdorim. “Certifikata e shënjitimit të karburanteve” i dorëzohet drejtuesit të mjetit dhe asnjë mjet nuk lejohet të largohet nga terminali pa qenë i pajisur me një certifikatë të vlefshme të shënjitimit të karburanteve.

VII. MBIKËQYRJA E PROCESIT TË SHËNJIMIT NGA AUTORITETI DOGANOR

1. Administrata doganore, përmes Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, ushtron kompetencat e mbikëqyrjes, kontrollit dhe verifikimit mbi procesin

e shënjitimit të karburanteve, me qëllim sigurimin e pagesës së akcizës, parandalimin e evazionit fiskal dhe mbrojtjen e integritetit të tregut të karburanteve.

2. Administrata doganore, pas përfundimit të procesit të shënjitimit nga shoqëria “ALBTrace CO” sh.a., verifikon dhe administron dokumentacionin e mëposhtëm:

a) “Certifikatën e shënjitimit të karburanteve”;

b) Dokumentet e tërheqjes/lirimit të karburantit dhe dokumentacionin shoqërues përkatës;

c) Dokumentet e lirimit të karburantit duhet të pasqyrojnë statusin “karburant i shënjuar”;

3. Shoqëria “ALBTrace CO” sh.a. vendos në dispozicion të administratës doganore çdo të dhënë, raport, dokumentacion të kërkuar për qëllime kontrolli dhe verifikimi.

VIII. SHËRBIMI I MONITORIMIT

1. Shërbimi i monitorimit kryhet nga autoriteti doganor me mbështetjen e shoqërisë “ALBTrace CO” sh.a. dhe përfshin, pa u kufizuar në to, monitorimin dhe analizimin e karburanteve përmes teknologjive të specializuara.

2. Për realizimin e shërbimit të monitorimit/analizimit, autoriteti doganor do të përdorë teknologjinë e vënë në dispozicion nga shoqëria “ALBTrace CO” sh.a., e cila përfshin analizatorë/detektorë portativë, përfshirë laboratorë të lëvizshëm të analizeve.

3. Për realizimin e shërbimit të monitorimit në terren, shoqëria “ALBTrace CO” sh.a., vë në dispozicion të autoritetit doganor 5 (pesë) njësi të lëvizshme laboratorike, të pajisura me analizatorë dhe pajisje të specializuara për analizimin e karburanteve, të cilat përdoren për të mbështetur aktivitetet e inspektimit dhe kontrollit në terren.

4. Të gjithë laboratorët e lëvizshëm, si dhe pikat e shënjitimit të karburanteve në терминалет doganore pajisen me sistem monitorimi me kamera (CCTV), që garantojnë funksionimin e rregullt, regjistrimin dhe transmetimin në kohë reale të pamjeve të procedurave faktike të testimit dhe shënjitimit.

5. Përfaqësuesit e autoritetit doganor do të mbështeten nga përfaqësuesit e shoqërisë “ALBTrace CO” sh.a., në të gjitha aktivitetet e monitorimit të kryera në Republikën e Shqipërisë dhe do t'i garantojnë shoqërisë “ALBTrace CO” sh.a. akses të plotë në të gjitha vendndodhjet ku gjenden karburante që i nënshtrohen shënjitimit dhe që janë objekt kontrolli.



6. Autoriteti harton programin e monitorimeve bazuar në planin e monitorimit sipas faktorëve të riskut dhe të miratuar nga autoriteti doganor. Ky program trajtohet si informacion rreptësisht konfidencial. Objektivat e monitorimit, afatet kohore dhe vendndodhjet që do të monitorohen përcaktohen ekskluzivisht nga autoriteti. Plani përmban vendndodhjen dhe/ose subjekte që konsiderohen me prioritet të lartë për monitorim.

7. Frekuenca e monitorimit në një vendndodhje të caktuar mund të rritet, kur kjo zonë vlerësohet si me risk të lartë nga administrata doganore dhe ofruesi i shërbimit, shoqëria “ALBTrace CO” sh.a.

8. Ditën e monitorimit, autoriteti do t'i kërkojë shoqërisë “ALBTrace CO” sh.a. të vendosë në dispozicion të tij përfaqësuesit e saj, të cilët do të shoqërojnë ekipin e autoritetit në aktivitetin e monitorimit, pa i vënë më parë në dijeni për pikat konkrete dhe kohën e monitorimit.

9. Ruajtja e konfidencialitetit të shërbimit të monitorimit përbën një parim themelor të zbatueshëm për realizimin e suksesshëm të tij.

IX. KUSHTET E REALIZIMIT TË MONITORIMIT DHE DETYRIMET E SUBJEKTEVE TË DETYRUARA

1. Subjektet e detyruara zbatojnë kërkesat teknike të përcaktuara nga shoqëria “ALBTrace CO” sh.a., përfshirë, por pa u kufizuar në to, sigurimin e një mjedisi pune të pastër dhe të lirë nga rreziqet e zjarrit. Zona e monitorimit duhet të jetë e pajisur me fikëse zjarri, dhe, në çdo rast, vendndodhja duhet të jetë e ndriçuar mirë dhe e identifikueshme qartë si pikë monitorimi në terren, me qëllim mundësimin e kryerjes së rregullt të shërbimit të monitorimit.

2. Çdo pengim ose refuzim i ushtruar nga subjektet e detyruara në përmbushjen e detyrimeve, që rrjedhin nga zbatimi i procesit të monitorimit, kur një sjellje e tillë nuk përbën vepër penale, përbën kundërvajtje administrative dhe sanksionohet nga autoriteti, sipas nenit 93, të ligjit nr. 61/2012, “Për akcizat”, të ndryshuar.

3. Monitorimi në terren kryhet nga autoriteti doganor me teknologjinë e vënë në dispozicion nga shoqëria “ALBTrace CO” sh.a., në vendndodhje ku karburanti transportohet, tregtohet ose magazinohet.

4. Kur monitorimi në terren kryhet në stacione karburanti, depo, rezervuarë ose ambiente të tjera magazinimi fikse, mostrat merren drejtpërdrejt nga linja e depozitimit ose furnizimit të produktit.

5. Kur monitorimi në terren kryhet në autobote ose mjete të tjera transporti të karburanteve, përzgjedhja e vendit të monitorimit bëhet duke marrë parasysh sigurinë dhe rendin publik.

6. Asnjë veprimtari monitorimi e shënjjimit të karburanteve nuk do të konsiderohet e vlefshme nëse është kryer pa analizën e realizuar përmes laboratorëve dhe sistemeve teknologjike të vëna në dispozicion nga shoqëria “ALBTrace CO” sh.a.

7. Subjekti i detyruar vë në dispozicion të njësisë së monitorimit në terren dokumentacionin e kërkuar sipas urdhrit të inspektimit, referuar manualeve të autoritetit doganor.

X. PROCEDURA OPERATIVE E MONITORIMIT NË TERREN

1. Marrja e mostrave të karburantit kryhet nga personeli i trajnuar dhe i kualifikuar i shoqërisë “ALBTrace CO” sh.a., në përputhje me standardet ndërkombëtare përkatëse ose procedurat e validuara të marrjes së mostrave dhe me kërkesat e zbatueshme të standardit S SH ISO/IEC 17025:2017 në prani të subjektit të detyruar dhe të përfaqësuesve të administratës doganore.

2. Mostra fillestare merret në volumn prej 500 ml për secilin prej karburanteve, sipas rastit, përkatësisht naftë D1 (kodi doganor 27101943), dhe benzinë pa plumb (kodi doganor 27101245, 27101241), nga burimet e mëposhtme:

a) Të gjithë rezervuarët nëntokësorë ose rezervuarët e magazinimit;

b) Të gjitha pompat e furnizimit, për vendndodhjet me një produkt të vetëm, vetëm pas furnizimit të një mjeti;

c) Dhomat (kompartimentet) e autoboteve që transportojnë karburantet në zinxhirin e furnizimit vendas.

3. Mostrat identifikohen, etiketohen dhe dokumentohen rregullisht dhe transferohen në njësinë e laboratorit të lëvizshëm për analizë, në përputhje me procedurat e miratuara nga shoqëria “ALBTrace CO” sh.a., duke respektuar kërkesat e mëposhtme:

a) Çdo mostër pajiset me etiketë unike identifikimi, ku shënohen të paktën data dhe ora e marrjes, vendndodhja, lloji i karburantit, sasia e mostrës, emri dhe nënshkrimi i përfaqësuesit të shoqërisë “ALBTrace CO” sh.a., në terren, si dhe emri e nënshkrimi i subjektit të detyruar ose përfaqësuesit të autorizuar prej tij.



b) Transporti dhe ruajtja e mostrave kryhen në kushte të kontrolluara, që garantojnë integritetin, gjurmueshmërinë dhe paprekshmërinë e tyre, deri në dorëzimin pranë njësisë së lëvizshme të laboratorit ose laboratorit të testimit, sipas rastit.

4. Çdo transferim dhe marrje në dorëzim e mostrave ndërmjet personave ose njësive përgjegjëse dokumentohet përmes formularit të zinxhirit të ruajtjes së provës (*chain of custody*), i cili nënshkruhet nga palët përkatëse dhe ruhet si pjesë e dokumentacionit zyrtar të procedurës.

XI. ANALIZA E KARBURANTIT DHE GJENERIMI I REZULTATEVE

1. Gjatë procesit të analizimit të karburanteve dhe gjenerimit të rezultateve zbatohen dispozitat e mëposhtme:

a) Personeli i autorizuar i shoqërisë “ALBTrace CO” sh.a. përgatit mostrat në laboratorin e lëvizshëm përkatës, të akredituar në përputhje me standardin S SH ISO/IEC 17025:2017, për metodat përkatëse të provës, dhe, përpara vendosjes së tyre në analizatorin e lëvizshëm të karburanteve, ua paraqet për evidencë përfaqësuesit të administratës doganore dhe subjektit të detyruar ose përfaqësuesit të autorizuar të tij;

b) Subjektit të detyruar ose përfaqësuesit të tij i lejohe të vëzhgojë procesin e analizës përmes dritares së posaçme të vëzhgimit të njësive së laboratorit të lëvizshëm.

2. Rezultati i analizës dhe vendimarrja për përputhshmërinë bëhet, si më poshtë:

2.1 Vendimarrja për përputhshmërinë e rezultatit me kriteret e përcaktuara në këtë vendim kryhet sipas një rregulli vendimarrjeje (*Decision Rule*), duke marrë në konsideratë pasigurinë e zgjeruar të matjes.

2.2 Rezultati i analizës regjistrohet si “KALON” ose “NUK KALON”, si më poshtë:

a) Rezultati “KALON” përcaktohet kur përmbajtja e shënjesit në mostër, e shprehur si vlerë relative ndaj nivelit të shënjesit dhe e matur nga analizatori i karburantit, është të paktën 95%;

b) Në rast të një rezultati “KALON”, ndërmerren veprimet e mëposhtme: Analisti i laboratorit në terren printon në vend 3 (tre) kopje të raportit të analizës në terren. Raporti nënshkruhet nga analisti dhe i dorëzohet administratës doganore dhe subjektit të detyruar, ndërsa një kopje tjetër i paraqitet administratës doganore për nënshkrim për prezencën dhe realizimin e monitorimit;

c) Rezultati “NUK KALON” konstatohet kur përmbajtja e shënjesit në mostër, e matur nga analizatori i karburantit, është nën 95%. Në rast të një rezultati të parë “NUK KALON” ndërmerren veprimet e mëposhtme:

i. kryhet një test i dytë mbi të njëjtën mostër, me qëllim konfirmimin e rezultatit fillestar. Nëse testi i dytë jep rezultat “KALON”, kryhet një test i tretë për verifikim përfundimtar;

ii. nëse testi i tretë jep rezultat “NUK KALON”, produkti i karburantit, objekt monitorimi, konsiderohet jo në përputhje dhe ndërmerren menjëherë masat administrative e procedurale, të parashikuara nga legjislacioni në fuqi;

iii. nëse testi i tretë jep rezultat “KALON” produkti i karburantit, objekt monitorimi, konsiderohet në përputhje me kërkesat ligjore.

3. Mostra e testuar ruhet për qëllime auditimi dhe hetimi nga njësia e inspektimit në terren.

4. Testimi laboratorik kryhet mbi mostrat e marra, në përputhje me procedurat e miratuara dhe nga personel i kualifikuar, në përputhje me protokollet standarde të testimit laboratorik. Rezultatet e testimit konfirmues janë përfundimtare dhe shërbejnë si bazë zyrtare për certifikimin e rezultateve të shënjesit të karburanteve.

5. Analizat laboratorike kryhen sipas metodave të validuara ose të verifikuara, të përshtatshme për qëllimin e testimit, në përputhje me kërkesat e standardit S SH ISO/IEC 17025:2017, duke siguruar vlefshmërinë teknike dhe besueshmërinë e rezultateve.

6. Për qëllime të testimit laboratorik të karburanteve, sasia e mbetur e karburantit nga mostra fillestare prej 500 ml, e marrë gjatë monitorimit në terren, ndahet në pesë (5) mostra me 100 ml secila. Këto mostra shpërndahen, si më poshtë vijon:

a) 2 (dy) mostra për analistët e laboratorit për përdorim në testim dhe ruajtje për qëllime procedurale dhe ligjore;

b) 1 (një) mostër për subjektin e detyruar ose përfaqësuesin e tij të autorizuar;

c) 1 (një) mostër për furnizuesin e produktit të karburantit, me kërkesë të tij;

ç) 1 (një) mostër për administratën doganore, me kërkesë të saj.

7. Në rast se nuk paraqitet kërkesë për tërheqjen e mostrave nga furnizuesi i karburantit ose administrata doganore, çdo mostër e tepërt



asgjësohet nga shoqëria “ALBTrace CO” sh.a., në përputhje me procedurat e miratuara.

8. Shishja e mostrës kryesore, e pajisur me etiketën e identifikimit, mbyllet (vulohet) dhe përdoret si mostër testimi. Shishet e tjera përgatiten veçmas dhe pajisen me etiketë identifikimi, të plotësuar nga analisti i laboratorit në terren i shoqërisë “ALBTrace CO” sh.a., ku shënohen të paktën informacionet e mëposhtme: numri identifikues i mostrës, lloji i karburantit, data e marrjes së mostrës dhe burimi i mostrës.

9. Njësia e inspektimit në terren dhe shoqëria “ALBTrace CO” sh.a. dokumenton procesin përmes regjistrimit me CCTV, i cili përdoret si pjesë e dokumentacionit provues ose për qëllime verifikimi dhe vlefshmërie procedurale.

10. Testimi laboratorik i karburanteve mund të kryhet edhe pa praninë e përfaqësuesit të subjektit të detyruar, me kusht që të jetë dhënë njoftimi i rregullt dhe që njësia e inspektimit në terren të jetë e pranishme për të dëshmuar zhvillimin e procedurës.

11. Në ambientet e autoritetit doganor ngrihet dhe funksionon një laborator i pajisur me kapacitete teknike të nevojshme dhe standarde ekuivalente me laboratorët e shoqërisë “ALBTrace CO” sh.a. Laboratori operon në përputhje me kërkesat e standardit S SH ISO/IEC 17025:2017 dhe shërben si strukturë mbështetëse për kryerjen e analizave verifikuese shtesë, me karakter konfirmues dhe kontrollues. Për sigurimin e besueshmërisë së rezultateve, laboratori mund të akreditohet për fushën përkatëse të testimit nga një organ akreditimi, nënshkrues i marrëveshjes EA MLA ose ILAC MRA.

12. Aktivizimi i laboratorit për kryerjen e analizave bëhet vetëm në raste të arsyetuara teknikisht dhe mbi bazën e një kërkesë zyrtare. Rastet e aktivizimit bëhen me kërkesë të strukturave mbikëqyrëse të autoritetit doganor, sipas manualeve përkatëse teknike.

13. Rezultatet e analizave dokumentohen në raport zyrtar laboratorik, i cili ka karakter referues për qëllime verifikimi dhe kontrolli. Raportet e analizave ruhen dhe administrohen nga autoriteti doganor.

XII. BASHKËPUNIMI

NDËRINSTITUCIONAL DHE FILLIMI I SHËNJIMIT

1. Të gjitha institucionet publike të Republikës së Shqipërisë, si dhe Policia e Shtetit janë të detyruara

të ofrojnë asistencë, të sigurojnë akses në informacion dhe të bashkëpunojnë me shoqërinë “ALBTrace CO” sh.a., dhe autoritetin doganor sa herë që një asistencë e tillë kërkohet për zbatimin e këtij vendimi.

2. Regjimi i shënjimit dhe monitorimit të karburanteve fillon të zbatohet pas përfundimit të periudhës së implementimit të projektit të shënjimit të karburanteve, e cila zgjat deri në 6 (gjashtë) muaj nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. Pas fillimit të zbatimit të këtij regjimi, asnjë produkt, që i nënshtrohet shënjimit, nuk mund të tregtohet, të importohet, të shpërndahet, të transportohet, të magazinohet, të prodhohet, të rafinohet apo të jetë objekt i operacioneve të çfarëdollojshme tregtare në territorin e Republikës së Shqipërisë, nëse nuk i është nënshtruar shërbimit të shënjimit dhe monitorimit, në përputhje me këtë vendim.

XIII. ZBATIMI DHE MASAT NDËSHKUESE

Të gjitha shkeljet, që lidhen me shënjimin e karburanteve, përveç sanksioneve të parashikuara nga legjislacioni doganor dhe fiskal në fuqi, si dhe nga çdo akt tjetër ligjor përkatës, i nënshtrohen masave administrative, fiskale dhe/ose penale, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi për akcizat, doganat dhe kundërvajtjet tatimore.

XIV. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Për qëllime të zbatimit të këtij vendimi, të gjitha subjektet e detyruara të produkteve të shënjimit, tregtarët dhe/ose pronarët e pikave të shitjes së karburanteve detyrohen të paraqesin deklaratën e inventarit të produkteve të naftës në gjendje, të identifikuar sipas degës, rafinerisë ose depos përkatëse, brenda një afati prej 30 (tridhjetë) ditësh nga data e fillimit të zbatimit të regjimit të shënjimit dhe monitorimit, sipas këtij vendimi.

2. Deklarata e inventarit paraqitet pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave (DPD), sipas rastit, ku subjekti ka të regjistruar vendin kryesor të ushtrimit të veprimtarisë, dhe duhet të përmbajë të dhëna të detajuara, mbi:

a) llojin e produkteve të naftës në gjendje, duke përcaktuar se këto produkte përfaqësojnë inventarin ekzistues përpara fillimit të shërbimit të shënjimit i cili do të realizohet nga shoqëria “ALBTrace CO” sh.a., dhe do të njoftohen me shkrim të gjithë operatorët dhe palët e interesuara, të gjitha produktet e naftës që do të qarkullojnë ose do të hidhen në treg do t'i nënshtrohen detyrimisht



procesit të shënjimit, në përputhje me procedurat e përcaktuara në këtë vendim;

b) sasinë ose vëllimin përkatës të produkteve në inventar;

c) vlerën përkatëse të inventarit të deklaruar.

3. Të dhënat e deklaruar në përputhje me pikat 1 dhe 2 të këtij kreu përdoren si bazë fillestare referuese për qëllime të monitorimit, kontrollit dhe verifikimit të mëtejshëm nga autoritetet kompetente, në kuadër të zbatimit të këtij vendimi.

4. Mosparaqitja e deklarates së inventarit brenda afatit të parashikuar në pikën 1, të këtij kreu, si dhe paraqitja e të dhënave të pasakta ose të paplota trajtohet, sipas legjislacionit tatimor dhe doganor në fuqi.

5. Në vendimin nr. 612, datë 5.9.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për dispozitat zbatuese të ligjit ‘Për akcizat’”, të ndryshuar, në pikën 1, të nenit 109/1, togfjalëshi “produktet e bardha” (gazoil dhe benzen) hiqet, si dhe shfuqizohen pikat 2 dhe 4, të këtij neni, si dhe pika 1, e nenit 109/2.

6. Ngarkohen Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe shoqëria shtetërore “ALBTrace Co” sh.a. për zbatimin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

ANEKS I

FORMULAR VETËDEKLARIMI PËR TË DHËNAT E AUTOBOTIT DHE NGARKESËS SË KARBURANTIT

I. TË DHËNAT E SUBJEKTTIT TË DETËRUAR

Emri i subjektit: _____

NIPT-i: _____

Adresa: _____

Përfaqësuesi ligjor: _____

II. TË DHËNAT E AUTOBOTIT (AUTOCISTERNËS)

Targa e mjetit: _____

Nr. shasie: _____

Kapaciteti total i autobotit (litra): _____

Numri i kompartimenteve (dhomave): _____

III. TË DHËNAT E NGARKESËS SIPAS KOMPARTIMENTEVE

Nr. kompartimenti	Kapaciteti (litra)	Sasia e ngarkuar (litra)	Lloji i karburantit
1			
2			
3			
4			
5			

IV. BURIMI I TË DHËNAVE

☐ Të dhënat bazohen në faturën tatimore

☐ Të dhënat bazohen në matjen gjatë ngarkimit të karburantit (përmes kalimatësit)

☐ Të dhëna të tjera (specifiko): _____

V. DEKLARIMI

Unë, i nënshkruari _____, në cilësinë e përfaqësuesit të autorizuar të subjektit të detyruar, deklaroj se të dhënat e mësipërme janë të sakta, të plota dhe të përditësuara, në përputhje me gjendjen faktike të ngarkesës së karburantit në momentin e deklarimit.

Jam i ndërgjegjshëm se çdo deklarim i pasaktë apo i rremë përbën shkelje dhe sanksionohet sipas legjislacionit në fuqi.

VI. DATA DHE NËNSHKRIMI

Data: _____._____._____

Emri dhe mbiemri: _____

Nënshkrimi: _____

Vula e subjektit: _____

VENDIM

Nr. 610, datë 30.7.2026

PËR RREGULLAT, PROCEDURAT, SHPENZIMET DHE KOMPENSIMIN FINANCIAR PËR SHËRBIMET JASHTË VENDIT TË PUNONJËSVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 16, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

I. RREGULLAT PËR DËRGIMIN ME SHËRBIM TË PUNONJËSVE JASHTË VENDIT

1. Punonjësit e njësive të qeverisjes së përgjithshme, përfshirë edhe këshilltarët e jashtëm në njësitë e qeverisjes qendrore, të cilët dërgohen me shërbim jashtë vendit për të marrë pjesë në veprimtari ndërkombëtare, konferenca, takime pune ose trajnime afatshkurtra të nevojshme për mbarrëvajtjen e punës, përfitojnë trajtim financiar për mbulimin e shpenzimeve të shërbimit.

Në kuptim të këtij vendimi, si trajnime afatshkurtra të nevojshme për mbarrëvajtjen e punës konsiderohen trajnimet me kohëzgjatje jo më shumë se një muaj.

2. Në fillim të çdo viti, njësitë e qeverisjes së përgjithshme, në përputhje me fondet buxhetore të disponueshme, hartojnë dhe miratojnë programin vjetor të veprimtarive që do të zhvillohen jashtë vendit. Programi miratohet nga titullari i institucionit dhe, kur është e nevojshme, mund të rishikohet ose të përditësohet gjatë vitit.

3. Dërgimi me shërbim jashtë vendit kryhet me urdhër të titullarit të njësisë së qeverisjes së përgjithshme, nga e cila varet njësia shpenzuese. Në urdhër përcaktohen niveli i përfaqësimit të institucionit, qëllimi i shërbimit, si dhe numri i punonjësve pjesëmarrës. Për qëllimet e këtij vendimi, “titullar i njësisë së qeverisjes së përgjithshme” është:

a) Për njësitë e qeverisjes qendrore:

i. Ministri ose personi i deleguar prej tij, për aparatin e ministrisë; ndërsa, për çdo institucion në varësi të Kryeministrit ose të ministrisë, titullari i institucionit përkatës;

ii. Sekretari i Përgjithshëm i institucionit përkatës, për aparatin e institucionit të Presidentit të Republikës, të Kuvendit dhe për deputetët, të Kryeministrit, si dhe të institucioneve kushtetuese;

iii. Titullari i institucionit për institucionet e tjera të pavarura;

iv. Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë për aparatin përkatës të këtyre organeve;

v. Kryetari i gjykatës përkatëse për gjyqtarët dhe aparatin e gjykatave të tri niveleve;

b) Për njësitë e qeverisjes vendore, është kryetari i njësisë;

c) Për fondet speciale, është titullari i fondit special.

II. SHPENZIMET DHE RREGULLAT PËR DËRGIMIN ME SHËRBIM TË PUNONJËSVE JASHTË VENDIT

1. Shpenzimet për dërgimin me shërbim të punonjësve jashtë vendit përfshijnë:

1.1 Shpenzimet e transportit, si më poshtë vijon:

a) shpenzimet e transportit për vajtje-ardhje jashtë vendit;

b) shpenzimet e transportit nga vendi i nisjes deri në aeroport dhe nga aeroporti në destinacion, si dhe anasjelltas;

c) shpenzimet e transportit për lëvizjet ndërmjet qyteteve të ndryshme, brenda shtetit pritës, kur këto lëvizje kryhen për nevoja pune dhe janë parashikuar paraprakisht në urdhrin e shërbimit;

ç) shpenzimet për pagesën e tarifave rrugore (tolla, taksa autostradash ose tarifa të ngjashme) që lidhen me transportin kombëtar ose ndërkombëtar.

1.2 Shpenzimet e akomodimit në hotel, që mbulohen në mënyrë të diferencuar sipas kategorive të përcaktuara në lidhjen nr.1, si më poshtë vijon:

a) Për kategoritë 1 dhe 2, akomodimi në hotel deri në 5 yje;

b) Për kategoritë 3 dhe 4, akomodimi në hotel deri në 4 yje;

c) Për kategorinë 5, akomodimi në hotel deri në 3 yje.

Në raste të veçanta, kur organizohen veprimtari ndërkombëtare dhe rezervimi kryhet nga organizatorët ose kur natyra e veprimtarisë nuk lejon ndarjen e grupit në hotele të ndryshme, shpenzimet e fjetjes njihen në bazë të faturës përkatëse. Nga ndarja në kategori për efekt të shpenzimeve të akomodimit përjashtohen punonjësit e Gardës së Republikës së Shqipërisë, të cilët janë përgjegjës për mbrojtjen dhe ruajtjen e personaliteteve, sipas përcaktimeve të legjislacionit përkatës, të cilët akomodohen në të njëjtin hotel me personalitetin që shoqërojnë. Kur distanca ndërmjet hotelit dhe destinacionit, ku zhvillohet veprimtaria, duke respektuar kategoritë e përcaktuara më sipër, është e konsiderueshme, si edhe në rastet kur gjatë procedurës së përzgjedhjes së ofertave rezulton se një strukturë hoteliere me klasifikim më të lartë (më shumë yje) ofron tarifë më të ulët ose të barasvlershme me atë të strukturave të parashikuara në këtë vendim, titullari i institucionit miraton në



urdhrin e shërbimit akomodimin në këtë kategori më të lartë hotelerie.

1.3 Shpenzimet për pagesa të ndryshme, që lidhen me udhëtimin dhe qëndrimin jashtë vendit, përfshirë siguracionin shëndetësor, taksën e vizës, qiranë e zyrës, si dhe çdo taksë apo detyrim tjetër të përcaktuar nga legjislacioni i vendit pritës. Për çdo shpenzim tjetër, që nuk është i parashikuar në këtë vendim, merret paraprakisht mendimi i ministrisë përgjegjëse për financat.

1.4 Shpenzimet ushqimore për ditët e qëndrimit, që caktohen sipas tabelës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij në euro/USD, për çdo grup funksionesh dhe shtetesh, si dhe sipas tabelës nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për kategorizimin e shteteve në grupe. Përfshihet, për punonjësit që dërgohen jashtë vendit për trajnime afatshkurtra, masa e shpenzimit ushqimor është 40 euro/USD në ditë, në rastet kur kjo nuk mbulohet nga pala pritëse. Kur shpenzimi ushqimor mbulohet pjesërisht nga pala pritëse, në një vlerë më të ulët se 40 euro/USD, masa e përfitimit llogaritet si diferencë e kësaj vlere.

2. Për qëllim të këtij vendimi, në tabelën nr. 1, togfjalëshi “të barasvlershme me ta në pagë” nuk përfshin shtesat mbi pagë për vjetërsi në punë, për kushte apo natyrë të veçantë pune, si dhe për vështirësi dhe dëmshmëri, por vetëm pagën e pozicionit.

3. Në rastet e dërgimit me shërbim jashtë vendit, struktura përgjegjëse e njësive të qeverisjes së përgjithshme për sigurimin e transportit dhe akomodimit të punonjësve duhet të marrë në konsideratë kostot ekonomike të operatorëve të shërbimit, si dhe mundësitë për të siguruar transport dhe akomodim në distanca sa më të shkurtra nga vendi ku organizohet aktiviteti.

III. PROCEDURA E MBULIMIT TË SHPENZIMEVE

Shpenzimet e përcaktuara në kreun II të vendimit përballohen, sipas përcaktimeve të mëposhtme:

1. Në rastet kur njësia ngarkohet të mbulojë tërësisht shpenzimet, ato paguhen nga buxheti i miratuar i njësisë. Përfshihen nga ky përcaktim shpenzimet për telefonatat nga hoteli apo telefoni celular personal, bari i dhomës, si dhe shpenzimet për transportin urban, të cilat mbulohen nga vetë punonjësi.

2. Në rastet kur aktiviteti/veprimtaria mbulohet pjesërisht nga pala pritëse, të cilat dokumentohen zyrtarisht nga pritësi, pjesa tjetër e shpenzimeve përballohet nga buxheti i institucionit.

3. Në rastet kur shpenzimet e aktivitetit mbulohen plotësisht nga pala pritëse, institucioni përkatës nuk kryen asnjë pagesë apo shpenzim në lidhje me pjesëmarrjen e punonjësit në këtë aktivitet.

4. Në rastet kur përfaqësimi në aktivitetet ndërkombëtare realizohet me pjesëmarrjen e punonjësve nga njësi të ndryshme të qeverisjes së përgjithshme, shpenzimet e tyre përballohen nga buxheti i çdo njësie përkatëse të qeverisjes së përgjithshme. Përfshihen nga ky përcaktim bëhet për punonjësit e Gardës së Republikës së Shqipërisë, të cilët janë përgjegjës për mbrojtjen dhe ruajtjen e personaliteteve, sipas përcaktimeve të legjislacionit përkatës, shpenzimet e të cilëve përballohen nga buxheti i institucioneve të personaliteteve përkatëse ose nga buxheti i Gardës së Republikës së Shqipërisë, pjesë e të cilit ata janë.

5. Për shkak të rrethanave madhore dhe të paparashikuara, mund të ndodhë që punonjësi i caktuar për kryerjen e shërbimit jashtë vendit të mos sigurojë prezencën në aktivitet ose ta përfundojë atë. Në këto raste, të gjitha shpenzimet e kryera deri në atë moment, së bashku me kostot e mundshme përkatëse, përballohen nga buxheti i njësisë.

Për qëllim të këtij vendimi, si rrethana madhore dhe të paparashikuara konsiderohen, ndër të tjera: sëmundja e menjëhershme ose ndërrimi i jetës së punonjësit apo i një anëtarit të familjes së tij, anulimi i aktivitetit nga organizatorët, çështje të sigurisë nga akte lufte apo terrorizmi, fatkeqësitë natyrore, aksidentet rrugore, anulimet dhe vonesat e mjeteve të transportit që nuk varen nga punonjësi dhe që vërtetohen me dokumentacion përkatës, urdhri i titullarit për angazhim në çështje të tjera që e bëjnë të pamundur pjesëmarrjen në aktivitet, si edhe rastet e ndërprerjes së marrëdhënieve të punësimit, sipas legjislacionit në fuqi. Në çdo rast tjetër, të ndryshëm nga sa parashikohet më sipër, shpenzimet përballohen nga vetë punonjësi.

IV. PROCEDURA E KOMPENSIMIT TË SHPENZIMEVE

1. Kompensimi për shpenzimet e kryera për dërgimin me shërbim jashtë vendit bëhet për çdo shpenzim të përcaktuar në kreun II të vendimit, vetëm në rastet kur ato nuk paguhen nga institucioni.



Në çdo rast, kompensimi i shpenzimeve bëhet sipas faturës, biletës ose dokumentit përkatës justifikues elektronik apo fizik, në përputhje me përcaktimet e këtij vendimi.

2. Punonjësi i institucionit, i cili dërgohet me shërbim ose trajnim jashtë vendit mbi bazën e shkresës autorizuese të titullarit, përfiton, përparnisjes së udhëtimit, në formë paradhënieje në llogarinë e tij bankare, pjesën e shpenzimeve që lidhen me shërbimet e udhëtimit. Pjesa e shpenzimeve që lidhet me biletat e avionit vajtje-ardhje dhe me akomodimin në hotel është detyrim dhe sigurohet drejtpërdrejt nga institucioni/njësia përgjegjëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në rastet kur shpenzimet e akomodimit në hotel nuk sigurohen paraprakisht nga institucioni/njësia përgjegjëse, punonjësi kryen vetë me shpenzimet e tij rezervimin dhe/ose pagesën e hotelit.

Pas kthimit nga shërbimi, njësia përkatëse e financës e institucionit bën llogaritjen e shpenzimeve faktike, mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga punonjësi dhe, sipas rastit,

institucioni derdh në kohën më të shpejtë të mundshme në llogarinë bankare të punonjësit diferencën e shumës së përfitueshme ose të papërfituar, ose punonjësi kthen pjesërisht në llogarinë e unifikuar të thesarit shumën e tepërt të parapaguar, e cila është arkëtuar paraprakisht nga punonjësi në arkën e institucionit, pas kthimit nga udhëtimi.

V. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Këto rregulla rekomandohen të zbatohen edhe për entet publike jobuxhetore, ndërmarrjet shtetërore dhe shoqëritë tregtare me kapital mbi 50 për qind shtetëror.

2. Vendimi nr. 870, datë 14.12.2011, i Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

Tabela nr. 1: Masa ditore e kompensimit ushqimor sipas kategorive dhe funksioneve

NË EURO/USD

Nr	Kategoritë	Masa e dietës		
		Shtetet e Grupit I	Shtetet e Grupit II	Shtetet e Grupit III
1	Presidenti, Kryeministri dhe Kryetar i Kuvendit	150	140	120
2	Zëvendëskryeministri, Zëvendëskryetar i Kuvendit, Ministër dhe nëpunës të tjerë në funksione drejtuese me pagë më të lartë ose të barazvlefshme me ta	120	100	80
3	Deputetët e Kuvendit dhe nëpunës të tjerë në funksione drejtuese me pagë më të lartë ose të barazvlefshme me ta; Zëvendësm ministër; Sekretar i Përgjithshëm si dhe nëpunës në funksione të tjera drejtuese të barazvlefshme me ta në pagë, apo me pagë më të lartë	80	75	70
4	Ambasador, Konsull i Përgjithshëm, të ngarkuarit me punë në shtete të tjera jashtë vendit, Drejtor i Përgjithshëm, Drejtor drejtorie në ministri dhe institucione të tjera qendrore, si dhe nëpunës në funksione të tjera të barazvlefshme me ta në pagë apo me pagë më të lartë	60	55	50
5	Nëpunës dhe punonjës të tjerë	55	50	45



Tabela nr. 2. Kategorizimi i shteteve

Shtetet e grupit I	Shtetet e grupit II	Shtetet e grupit III		
Austri	Samoa Amerikane	Afganistan	Iran	Tanzani
Belgjikë	Anguilë	Algjeri	Irak	Tajlandë
Bullgari	Antigua e Barbuda	Angolë	Xhamajkë	Timor-Leste
Kroaci	Azerbajxhan	Armeni	Kenia	Togo
Çekia	Bahamas	Arubë	Kiribati	Tonga
Qipro	Bahrejn	Bangladesh	Korea e Veriut	Trinidad e Tobago
Danimark	Barbados	Bjellorusi	Kosovë	Tunizi
Estoni	Belizë	Benin	Kirgistan	Turkmenistan
Finland	Kepi i Gjellbër	Bermudë	Kamerun	Ishujt Turks dhe Kaikos
Francë	Cote d'Ivoire	Butan	Liban	Tuvalu
Gjermani	Fixhi	Bolivi	Lesoto	Ugandë
Greqi	Ishujt Kuk	Bosnjë-Hercegovinë	Liberi	Uruguai
Hungari	Hong Kong	Botsvanë	Libi	Uzbekistan
Irland	Islandë	Brunei	Makao	Vanuatu
Itali	Kuvajt	Burkina-Faso	Maqedonia e Veriut	Venezuelë
Letoni	Madagaskar	Burundi	Malavi	VietNam
Lituani	Maldivë	Kamboxhia	Mali	Rripi i Gazës
Luksemburg	Ishujt Marshall	Republika Demokratike Popullore e Laos	Moldavi	Jemen
Maltë	Mauritani	Ishujt Kajman	Mongoli	Zambia
Holandë	Mauritius	Republika e Afrikës Qendrore	Mal i Zi	Zimbabve
Poloni	Mikronezi	Çad	Marok	
Portugali	Montserrat	Kili	Mozambik	
Rumani	Nauru	Kolumbi	Mianmar	
Slovaki	Antilet Holandeze	Komore	Namibi	
Sloveni	Nikaragua	Kongo	Nepal	
Spanjë	Samoa	Republika Demokratike e Kongos	Niger	
Suedi	Sao-Tome e Prinsipe	Kosta-Rikë	Nigeri	
Australi	Ishujt Solomon	Kubë	Niue	
Kanada	Shën Kīts dhe Nevis	Xhibuti	Pakistan	
Kinë	Shën-Luçia	Dominikë	Palau	
Indi	Shën Vincenti dhe Grenadinet	Republika Dominikane	Panama	
Izrael	Ishujt Tokelau	Ekuador	Papua Guineja e Re	
Japoni	Ishujt e Virgjër Britanikë	Egjipt	Paraguai	
Koreja e Jugut	Ishujt e Virgjër Amerikanë	Salvador	Peru	
Monako	Brazil	Guineja Ekuatoriale	Filipine	
Katar	Argentinë	Eritre	Porto-Riko	
Zvicër	Kazakistan	Etiopi	Ruandë	
Turqi	Indonezi	Gabon	Senegal	
Emiratet e Bashkuara Arabe	Jordani	Gambia	Sejshelle	
Mbretëria e Bashkuar	Meksikë	Gjeorgji	Siera-Leone	
Shtetet e Bashkuara të Amerikës	Palestinë	Ganë	Somali	
Norvegji	Serbi	Grenadë	Afrika e Jugut	
Lihtenshtajn	Ukrainë	Guam	Sri-Lankë	
Malajzi		Guatemalë	Sudan	
Oman		Guine	Sudani i Jugut	
Arabia Sudite		Guine-Bisau	Surinami	
Rusi		Guajanë	Esvatini	
Zelanda e Re		Haiti	Siri	
Singapor		Honduras	Taxhikistan	



VENDIM
Nr. 616, datë 30.7.2026

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR. 466, DATË 30.7.2021,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
MIRATIMIN E STRATEGJISË SË
ZHVILLIMIT TË BIZNESIT DHE
INVESTIMEVE, 2021–2027, DHE TË
PLANIT TË SAJ TË VEPRIMIT”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15, të ligjit nr. 43/2022, “Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme”, me propozimin e ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 466, datë 30.7.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Strategjisë së Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve, 2021–2027, dhe të planit të saj të veprimit”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në titullin dhe në pikën 1, të vendimit, si dhe në titullin e tekstit të Strategjisë së Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve, 2021–2027, bashkëlidhur vendimit, periudha “2021–2027” zëvendësohet me “2021–2030”.

2. Në Strategjinë e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve, 2021–2027, bashkëlidhur vendimit, bëhen këto shtesa:

a) Në tabelën 11, “Masat në fushën e ndërhyrjes “Tërheqja e investimeve dhe ndërkombëtarizimi””, shtohen veprimet prioritare, si më poshtë vijon:

i. Veprimi prioritar “Programi i ekonomisë qarkulluese industriale dhe parqet ekoindustriale”, sipas aneksit nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

ii. Veprimi prioritar “Përgatitja e industrisë për tregun e gjelbër në tregun e përbashkët (MRV, gatishmëria CBAM dhe efienca e energjisë në prodhim)”, sipas aneksit nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

iii. Veprimi prioritar “Standardet, certifikimi dhe gatishmëria për tregun e vetëm (me modul ndërkombëtarizimi)”, sipas aneksit nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

iv. Veprimi prioritar “Digjitalizimi industrial dhe aksesimi në inteligjencë artificiale/EuroHPC”, sipas aneksit nr. 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

v. Veprimi prioritar “Lehtësimi i veprimtarisë industriale ndërkufitare dhe logjistika”, sipas aneksit nr. 5, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

vi. Veprimi prioritar “Rezilienca (qëndrueshmëria) e zinxhirëve të furnizimit dhe diversifikimi i inputeve (përfshirë CRM)”, sipas aneksit nr. 6, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

vii. Veprimi prioritar “Përditësimi i ligjit të investimeve dhe thjeshtimi i procedurave për projektet industriale”, sipas aneksit nr. 7, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

b) Në tabelën 12, “Masat në fushën e ndërhyrjes “Zhvillimi i NVM-ve, sipërmarrja dhe inovacioni””, shtohen veprimet prioritare, si më poshtë vijon:

i. Veprimi prioritar “Transferimi i teknologjisë, qeverisja e S3 dhe rritja e kapacitetit absorbues”, sipas aneksit nr. 8, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

ii. Veprimi prioritar “Instrumente financiare për modernizimin e transformimin industrial të ndërmarrjeve (dritarja e vetme financiare)”, sipas aneksit nr. 9, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

iii. Veprimi prioritar “Krijimi i Fondit Shqiptar të Inovacionit (FSHI): Instrumenti sovran i bashkinvestimit për rritjen e konkurrueshmërisë dhe ndërmarrjet me rritje të lartë (*Scale-Up*)”, sipas aneksit nr. 10, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

iv. Veprimi prioritar “Përmirësimi i mjedisit rregullator për NMVM-të: Implementimi i “SME Test” dhe kuadri për pagesat e vonuara”, sipas aneksit nr. 11, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

v. Veprimi prioritar “Programi kombëtar i zhvillimit të klasterave industriale dhe integrimi në zinxhirët e IHD-ve”, sipas aneksit nr. 12, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

c) Në tabelën 13, “Masat në fushën e ndërhyrjes “Zhvillimi i kapitalit njerëzor””, shtohet veprimi prioritar “Paketa kombëtare e aftësive të gjelbra dhe digjitale në industri (*Green & digital upskilling*)”, sipas aneksit nr. 13, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

ç) Në pjesën III, “Zbatimi, përgjegjësia e institucioneve, llogaridhënia, raportimi dhe monitorimi”, të strategjisë, shtohet teksti, sipas aneksit nr. 14, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

d) Aneksi nr. 1, “Formati i planit të veprimit i përmbledhur” zëvendësohet me aneksin nr. 15, që i

bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

II. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Mjedisit, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Financave, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, Agjencia “Innovation4Albania” dhe Korporata e Investimeve Shqiptare për zbatimin e masave të përcaktuara në këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

ANEKS NR. 1

M 1.1.4 – Programi i ekonomisë qarkulluese industriale dhe zhvillimi i parqeve ekoindustriale

Objektivat:

- Zhvillimi i modeleve të bashkëveprimit industrial, përmes ripërdorimit eficient të mbetjeve të ngurta, biombetjeve dhe riciklimit të ujërave të

ndotura industriale, në zbatim të detyrimeve të kuadrit rregullator shqiptar të përafëruar me *acquis*-in e Bashkimit Evropian për ekonominë qarkulluese.

- Pilotimi i modelit të parqeve ekoindustriale, duke u bazuar në projektet e zhvillimit të *Durana Tech Park* dhe TEDA Tiranë, si modele referencë për të gjithë vendin.

Përshkrimi: Kjo masë strukturohet si një program i vetëm dhe i integruar i ekonomisë qarkulluese, i cili operon nëpërmjet dy komponentëve ndërlidhës për të nxitur bashkëveprimin dhe eficiencën e burimeve në industrinë përpunuese. Komponenti i parë fokusohet në vlerësimin e kuadrit rregullator për menaxhimin e mbetjeve të ngurta, biombetjeve dhe riciklimit të ujërave të ndotura në sektorin e industrisë dhe pilotimin e modeleve të bashkëveprimit nëpërmjet skemave nxitëse për eficiencën e burimeve. Komponenti i dytë adreson kuadrin rregullator të parqeve ekoindustriale (EIP) dhe hartimin e studimeve të fizibilitetit për projektet pilote. Ky proces do të zbatohet në partneritet me IFC-në, Korporatën Financiare Ndërkombëtare (grupi i Bankës Botërore) dhe SECO-n, në përpunje me marrëveshjen e bashkëpunimit MEI – IFC, të nënshkruar më 17 mars 2025.

Aktivitetet:

Aktiviteti	Afati	Institucionet
1. Vlerësimi i kuadrit rregullator për ekonominë qarkulluese, si edhe pilotimi i modeleve dhe skema e eficiencës së burimeve	2026–2030	Ministria e Mjedisit, AIDA, MEI, AKM
2. Korniza EIP dhe fizibiliteti për <i>Durana Tech Park</i> e TEDA Tiranë	2026–2028	MEI, AIC, IFC/IBRD, SECO

Treguesit (rezultat/ndikim):

Treguesi	Baza	Synimi i ndërmjetëm	Synimi 2030
Mbetje industriale të riorientuara nga landfilli drejt riciklimit (të dhënat për matjen referuar DSIP e <i>Industrial Emission Directive</i>).	Matja 2026	10% (2029)	≥ 30%
NVM me protokolle qarkulluese/plane të gjelbra të zbatuara	0 (2025)	15 (2028)	40
Ndërmarrje në parqet pilot, sipas standardeve EIP	0% (2025)	30% (2028)	60%



ANEKS NR. 2

M 1.1.5 – Përgatitja e industrisë për tregun e gjelbër në tregun e përbashkët (MRV, Gatishmëria CBAM dhe eficientia e energjisë në prodhim)**Objektivat:**

- Funksionalizimi i kuadrit kombëtar për monitorimin, raportimin, verifikimin dhe akreditimin (MRVA) të emetimeve të gazeve serrë, në përputhje me direktivën 2003/87/KE dhe rregulloret zbatuese (BE) 2018/2066 dhe 2018/2067, mbështetja e ndërmarrjeve industriale për zbatimin e kërkesave të MRVA-së dhe zhvillimi i kapaciteteve kombëtare për ofrimin e shërbimeve të verifikimit.

- Rritja e gatishmërisë teknike të ndërmarrjeve eksportuese për t'u përshtatur me kërkesat e rregullores (BE) 2023/956, e ndryshuar, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 10 maj 2023, për krijimin e mekanizmit të rregullimit të karbonit në kufij (CBAM), përfshirë llogaritjen dhe dokumentimin e emetimeve të trupëzuara, mbështetjen për verifikimin e të dhënave dhe transmetimin e informacionit të importuesit në Bashkimin Evropian.

- Mbështetja e ndërmarrjeve prodhuese për reduktimin e intensitetit energjetik dhe adoptimin e masave të eficientës, duke lehtësuar integrimin e vetëkonsumit të energjisë së rinovueshme (RES) në proceset e tyre të prodhimit.

Përshtetja: Masa fokusohet në mbështetjen praktike të industrisë shqiptare, veçanërisht të sektorëve me intensitet të lartë karboni, për zbatimin e kuadrit kombëtar për monitorimin, raportimin, verifikimin dhe akreditimin e emetimeve të gazeve serrë (MRVA). Ndërmarrjeve do t'u ofrohet asistencë teknike për ngritjen e sistemeve të brendshme të menaxhimit të të dhënave, hartimin e raporteve të emetimeve dhe për procesin e verifikimit të tyre. Paralelisht, do të mbështetet zhvillimi i kapaciteteve kombëtare për ofrimin e shërbimeve të verifikimit nga organe verifikuese të akredituara, përmes trajnimit të profesionistëve të parë të verifikimit, përgatitjes së organeve verifikuese kandidate dhe

ngritjes së kapaciteteve të DPA-së për vlerësimin dhe akreditimin e tyre. DPS-ja do të mbështesë shqyrtimin dhe adoptimin e standardeve teknike përkatëse të Be-së në standardet shqiptare.

Komponenti i gatishmërisë CBAM do të zbatohet si një linjë e veçantë asistencë teknike për ndërmarrjet eksportuese në sektorët e përzgjedhur (si çimento, metalurgjia), me qëllim përshtatjen e tyre me kërkesat e rregullores (BE) 2023/956, e ndryshuar. Mbështetja do të përfshijë llogaritjen dhe dokumentimin e emetimeve të trupëzuara në mallra, përgatitjen dhe verifikimin e të dhënave përkatëse dhe transmetimin e informacionit të importuesit në Bashkimin Evropian. Për të kaluar nga një sistem raportimi (MRV) të reduktimi real i emetimeve, kjo masë do të ofrojë asistencë teknike dhe shërbime këshillimore për ndërmarrjet që të auditojnë konsumin e tyre, të hartojnë planet e veprimit të eficientës së energjisë (kjo aktualisht është detyruese për konsumatorët e mëdhenj të energjisë, ndërkohë, duke qenë se ndërmarrjet do t'u nënshtrohen auditimit, është e arsyeshme për të kërkuar dhe hartimin e një plani, si dhe ndoshta edhe punësimin e një menaxheri energjie) dhe të aplikojnë skema të vetëprodhimit të energjisë nga burimet e rinovueshme (si p.sh. solare në tarraca apo brenda zonave TEDA/parqeve industriale). Kjo masë do të jetë gjithashtu plotësuese me masën 1.2.9, ku ndërmarrjet që e kalojnë fazën e auditimit të energjisë mund të aplikojnë për grante në projektet e tyre të investimit për teknologji të reja, që synojnë dekarbonizimin. Ndërsa kjo masë synon posaçërisht tranzicionet teknologjike dhe të eficientës së energjisë brenda proceseve të prodhimit industrial, sipas kapitullit 20, dekarbonizimi më i gjerë dhe tranzicioni i sistemit kombëtar të furnizimit me energji trajtohen nga Plani Kombëtar për Energjinë dhe Klimën (NECP) nën kuadrin e kapitullit 15. Për më tepër, masa do të mbështesë industrinë eksportuese në përshtatjen me kërkesat e tregut ndërkombëtar për certifikata të gjelbra, duke rritur konkurrueshmërinë e tyre brenda Tregut Unik të Bashkimit Evropian nën kuadrin e CBAM-së.

**Aktivitetet:**

Aktiviteti	Afati	Institucionet
1. Mbështetja e ndërmarrjeve industriale për zbatimin e kërkesave MRVA dhe ngritja e kapaciteteve kombëtare për ofrimin e shërbimeve të verifikimit, përfshirë asistencën për raportet e emetimeve, trajnimin e profesionistëve të parë të verifikimit të emetimeve, përgatitjen e organeve verifikuese kandidate për akreditim dhe ngritjen e kapaciteteve të vlerësuesve të trupës kombëtare të akreditimit.	2026–2028	Ministria e Mjedisit, MEI, MIE, AKM, DPA, DPS, sipas fushës së përgjegjësisë
2. Gatishmëria CBAM për eksportuesit: ofrimi i asistencës teknike për përshtatjen me rregulloren (BE) 2023/956, e ndryshuar, llogaritjen dhe dokumentimin e emetimeve të trupëzuara, mbështetjen për verifikimin e të dhënave dhe transmetimin e informacionit të importuesit në Bashkimin Evropian, në sektorët e përzgjedhur.	2026–2030	MEI, Ministria e Mjedisit, MIE, AIDA, AKM,
3. Shërbime këshillimore dhe paketa trajnimi për ndërmarrjet mbi masat e eficiencës së energjisë dhe auditimin energjetik industrial.	2027-2029	MEI, MIE, Agjencia e Eficiencës së Energjisë (AEE), AIDA, Ministria e Mjedisit

Treguesit (rezultat/ndikim):

Treguesi	Baza	Synimi ndërmjetëm	Synimi 2030
Ndërmarrje industriale dhe eksportuese të mbështetura për zbatimin e kërkesave MRVA dhe gatishmëria CBAM	0 (2025)	25 (2028)	60
Kapacitet i ri vetëprodhimi RES i ndërmarrjeve (MW)	Baza ERE 2026	Sipas pasaportës	Përcaktohet me MIE/ERE
Intensiteti energjetik i industrisë përpunuese	INSTAT/Eurostat 2025	-5% (2028)	-10%

ANEKS NR. 3

M 1.1.6 – Standardet, certifikimi dhe gatishmëria për tregun e vetëm (me modul ndërkombëtarizimi)**Objektivat:**

- Rritja e ndërgjegjësimit dhe aftësisë profesionale për Tregun e Përbashkët Evropian dhe ndërtimi i një ekosistemi të qëndrueshëm këshillimor dhe trajnim për pajisjen e sipërmarrjes dhe të forcës së punës me njohuritë dhe aftësitë për tregun evropian.

- Fuqizimi i ndërmarrjeve shqiptare përmes mbështetjes direkte për standardizim dhe certifikim, aksesit të përmirësuar në instrumente financiare (grante dhe kredi të buta) në përputhje me standarde e tregut të përbashkët.

- Promovimi i produkteve shqiptare në tregjet ndërkombëtare.

Përshkrimi: Integrimi i Shqipërisë në Bashkimin Evropian mundëson transformimin e ekonomisë kombëtare, duke kërkuar një konvergencë strukturore të sipërmarrjes shqiptare me standardet e Tregut të Përbashkët Evropian. Për ndërmarrjet shqiptare, ku NMVM-të përbëjnë shtyllën kurriore të ekonomisë, ky proces nuk është thjesht një detyrim ligjor, por një ndryshim paradigme. Pavarësisht potencialit, sektori privat përballet me pengesa kryesore, si mungesa në informacion, certifikim, akses në financim dhe kapacitete teknike për t'iu përgjigjur dinamikës së konkurrencës së Bashkimit Evropian. Kjo masë synon të adresojë këto sfida, duke shndërruar procesin e integritimit në një mundësi konkrete, duke ofruar një udhërrëfyes praktik dhe arkitekturë mbështetëse, që lidh reformat institucionale me nevojat reale të biznesit në vend, për të garantuar që ndërmarrjet shqiptare jo vetëm të jenë të përputhshme me kriteret e



Bashkimit Evropian, por edhe të zhvillohen në mjedisin konkurrues të tregut të përbashkët. Për të rritur produktivitetin dhe konkurrueshmërinë kombëtare në përbashkë me sfidat e tregut evropian, Shqipëria po ndërmerr hartimin e një programi kombëtar gjithëpërfshirës për mbështetjen e sipërmarrjes gjatë dhe pas procesit të integritimit. Ky program shërben si një platformë transformuese, duke lidhur reformat institucionale me nevojat konkrete të biznesit për t'u bërë partnerë në Tregun e Përbashkët të Bashkimit Evropian. Për të adresuar sfidat e identifikuara në “Raportin e gatishmërisë”, programi kombëtar strukturohet mbi tri shtylla strategjike, që synojnë transformimin e sektorit privat në një forcë konkurruese brenda Tregut të Vetëm të Bashkimit Evropian: së pari, krijimin e një infrastrukture gjithëpërfshirëse informimi dhe ndërgjegjësimi (nëpërmjet platformës digjitale EUBIP), së dyti, ngritjen e një ekosistemi të qëndrueshëm këshillimor dhe trajnues për të rritur ekspertizën vendase, dhe, së treti, zbatimin e programeve të zhvillimit të kapaciteteve, lançimi i skemave të granteve dhe instrumenteve financiare, si dhe zgjerimi gradual i masave mbështetëse për transformimin e ndërmarrjeve. Për më tepër, aktivitetet e mbështetjes financiare dhe këshillimore do të mundësojnë mekanizmat e përputhshmërisë për certifikatat e gjelbra dhe standardet e qëndrueshmërisë, të cilat kërkohen për të përforcuar kapacitetin eksportues të produkteve shqiptare në zinxhirët e vlerës.

Aktivitetet:

Aktiviteti	Afati	Institucionet
1. Krijimi dhe funksionalizimi i strukturave të qeverisjes së programit, ngritja e Njesisë së Zbatimit të Programit dhe krijimi i mekanizmave koordinues ndërinstitucionale	2026–2027	MEI, Komitet Ndërmarrës për Integrimin Ekonomik të Sipërmarrjes, Ekipi Kombëtar për hartimin dhe ndjekjen e procesit të implementimit të programit.
2. Zhvillimi dhe operacionalizimi i Platformës Evropiane të Informimit për Biznesin (EUBIP), si dhe krijimi i sistemeve të komunikimit, monitorimit dhe raportimit	2026–2027	MEI, Komitet Ndërmarrës për Integrimin Ekonomik të sipërmarrjes, Ekipi Kombëtar për hartimin dhe ndjekjen e procesit të implementimit të programit.

Aktiviteti	Afati	Institucionet
3. Informimi dhe ndërgjegjësimi i 48,000 ndërmarrjeve në të gjithë territorin e Shqipërisë, si dhe realizimi i vlerësimit të parë të gatishmërisë së tyre dhe operacionalizimi i programeve fillestare të trajnimit	2026–2027	MEI, Komitet Ndërmarrës për Integrimin Ekonomik të Sipërmarrjes, Ekipi Kombëtar për hartimin dhe ndjekjen e procesit të implementimit të programit.
4. Zbatimi i plotë i programeve të zhvillimit të kapaciteteve, lançimi i skemave të granteve dhe instrumenteve financiare, si dhe zgjerimi gradual i masave mbështetëse për transformimin e ndërmarrjeve	2027–2030	MEI, Komitet Ndërmarrës për Integrimin Ekonomik të Sipërmarrjes, Ekipi Kombëtar për hartimin dhe ndjekjen e procesit të implementimit të programit.

Treguesit (rezultat/ndikim):

Treguesi	Baza	Synimi i ndërmjetëm	Synimi 2030
Përqindja e ndërmarrjeve të mesme dhe të mëdha eksportuese të certifikuar sipas standardeve të Bashkimit Evropian (CE/ISO)	Vlerësimi fillestar	25%	50%
Numri i ndërmarrjeve të mbështetura që hyjnë në zinxhirët e vlerës të IHD-ve (<i>Business Linkages</i>)	0	50	150
Rritja mesatare vjetore e eksporteve drejt Bashkimit Evropian për ndërmarrjet përfituese nga programi	Bazë 2026	+10%	+25%

ANEKS NR. 4

M1.1.8 – Digjitalizimi industrial dhe akseset në inteligjencë artificiale

Objektivat:

Krijimi dhe fuqizimi i Qendrës Evropiane të Inovacionit Digjital (EDIH) kombëtare, si *Hub-i Kombëtar i Inovacionit Digjital*, nëpërmjet strukturës së saj operationale, *Digital Innovation Unit* (DIU) si pikë kryesore për ofrimin e shërbimeve të avancuara të digjitalizimit dhe mbështetjes teknike për ndërmarrjet drejt zgjidhjeve teknologjike.



Forcimi i sigurisë së sistemeve të kontrollit ndaj kërcënimeve kibernetike nëpërmjet ekspertizës së specializuar të ofruar nga Qendra Evropiane e Inovacionit Digjital (EDIH) kombëtare.

Integrimi i Shqipërisë në ekosistemin EuroHPC, duke përfshirë pjesëmarrjen në thirrjet e ardhshme për “AI Factory”/“AI Factory Antenna” dhe aplikimi në thirrjet EuroHPC, për t’u mundësuar SME-ve industriale aksesin në infrastrukturën kompjuterike të Inteligjencës Artificiale (AI) pa pasur nevojë për investime të mëdha private.

Përshkrimi: Masa është konceptuar si një platformë e integruar e digjitalizimit industrial, e ndërtuar mbi dy shtylla plotësuese.

Shtylla e parë është ngritja dhe operacionalizimi i Qendrës Evropiane të Inovacionit Digjital (EDIH) kombëtare, e bashkëfinancuar nga programi “Digital Europe” (DIGITAL-2023-EDIH-04), për periudhën 2025–2028, e cila vepron si *Hub-i Kombëtar i Inovacionit Digjital* nëpërmjet strukturës së saj operationale, *Digital Innovation Hub* (DIU). EDIH ofron shërbime “test before invest”, trajnime, rrjetëzim dhe mbështetje teknike për SME-të, *startup*-et dhe institucionet publike. Me fokus në inteligjencën artificiale, sigurinë kibernetike industriale dhe aftësitë digjitale të avancuara, duke synuar mbulimin e mbi 1,000 subjekteve dhe trajnimin e rreth 2,000 profesionistëve, si dhe integrimin e Shqipërisë në rrjetin evropian të EDIH-ve. Për të siguruar konvertimin e këtij mbulimi në adoptim real, EDIH mbështetet nga një skemë nxitëse (*vauchet*/bashkëfinacim), që lehtëson integrimin e zgjidhjeve digjitale dhe të IA-së në ndërmarrjet prodhuese.

Shtylla e dytë siguron aksesin e ndërmarrjeve vendase në infrastrukturën evropiane të inteligjencës artificiale. Duke u mbështetur në anëtarësimin e Shqipërisë në Ndërmarrjen e Përbashkët EuroHPC (qershor 2025) dhe në rolin e AKSHI-it si pikë kombëtare, ndërmarrjet do të shfrytëzojnë infrastrukturën evropiane të llogaritjes me performancë të lartë (HPC) dhe platformat *Cloud* pa pasur nevojë për investime të mëdha private. Ky komponent përfshin pjesëmarrjen në thirrjet e ardhshme “AI Factory/ AI Antenna” dhe një studim fizibiliteti për një Qendër Kombëtare HPC; në rast mospjekës në thirrje, aksesin sigurohet përmes qendrave ekzistuese EuroHPC, në mënyrë që zbatimi i masës të mos kushtëzohet nga rezultati i një thirrjeje të vetme.

Vizioni strategjik bazohet në lidhjen e ekosistemit vendas me rrjetet evropiane EDIH dhe qendrat rajonale të Inovacionit (*AI Factories*, *AI-on-Demand* dhe Objektet e Testimit e Eksperimentimit), duke i mundësuar industrisë shqiptare të testojë, të vërtetojë dhe të zbatojë zgjidhje të avancuara. Për të garantuar qëndrueshmërinë përtej periudhës së bashkëfinancimit të *Digital Europe* (2028), masa parashikon një plan financiar tranzicioni, që siguron vijueshmërinë e shërbimeve të EDIH-ve deri në vitin 2030 dhe më tej, duke nxitur një avantazh konkurrues të qëndrueshëm dhe integrimin në zinxhirët e vlerës të Bashkimit Evropian.

Aktivitetet:

Aktiviteti	Afati	Institucionet
1. Krijimi dhe funksionimi i Qendrës Evropiane të Inovacionit Digjital (EDIH) kombëtare, si <i>Hub-i Kombëtar i Inovacionit Digjital</i> nëpërmjet strukturës së saj operationale, <i>Digital Innovation Unit</i> (DIU)	2026–2027	MEI, DIU
2. Program për trajnimin, rrjetëzimin dhe mbështetjen e SME-ve dhe sipërmarrjeve të reja (<i>startups</i>).	2026–2030	MEI, DIU
3. Angazhimi në EuroHPC: pjesëmarrje në thirrjet për akses në EuroHPC, studim fizibiliteti për një Qendër Kombëtare HPC, dhe aplikim në thirrjet e ardhshme për “AI Factory Antenna”.	2027–2029	MEI, AKSHI

Treguesit (rezultat/ndikim):

Treguesi	Baza	Synimi i ndërmjetëm	Synimi 2030
NMVM-të prodhuese me zgjidhje digjitale/AI të integruara përmes skemës	0 (2025)	35 gjithsej (kumulative) (2028)	90 kumulative
Kapaciteti i përdorur i EuroHPC (orë bërthamë/ <i>core hours</i>)	0 (2025)	200 000 kum. (2028)	1 000 000 kum.
Ndërmarrjet me rritje të produktivitetit 24 muaj pas ndërhyrjes	-	Matja e parë (2029)	≥ 30%



ANEKS NR. 5

M 1.1.10 – Lehtësimi i veprimtarisë industriale ndërkufitare dhe logjistika**Objektivat:**

- Reduktimi i kohës dhe kostos së kalimit kufitar për mallrat industriale;
- Digjitalizimi i dokumentacionit tregtar dhe interoperabiliteti i të dhënave;
- Modernizimi i logjistikës private (zinxhiri i ftohtë) dhe zgjerimi i statusit AEO.

Përshkrimi: Kjo masë adreson ndërhyrjet kryesore për lehtësimin e tregtisë ndërkombëtare të mallrave industriale. Masa synon kalimin drejt dokumentacionit plotësisht të digjitalizuar, realizimin periodik të studimit të kohës së kalimit së mallrave (*Time Release Study* – TRS) dhe menaxhimin operacional të pikave të kalimit kufitar në Shqipëri. Gjithashtu, parashikohet rritja e ndërveprueshmërisë (*interoperability*) së sistemeve doganore, zgjerimi i numrit të ndërmarrjeve me statusin Operator Ekonomik i Autorizuar (AEO) dhe vënia në funksion e një mekanizmi të përhershëm për identifikimin dhe zgjidhjen e barrierave tarifore, në përputhje me vendimet e Komitetit për Lehtësimin e Tregtisë në CEFTA.

Në nivel rajonal e ndërkombëtar, masa synon zbatimin e programit për lehtësimin e tregtisë dhe transportit, duke zgjeruar komponentin e korridoreve dhe korsive të gjelbra (*Green Lanes*) në kuadër të CEFTA-s, si dhe marrëveshjen dypalëshe Itali–Shqipëri për “Korsitë blu”. Masa është e dedikuar për sektorin privat dhe do të fokusohet në kryerjen e vlerësimeve të nevojave dhe ofrimit të programeve të trajnimit të dedikuara për operatorët logjistikë vendas, duke u mbështetur në asistencën teknike të partnerëve ndërkombëtarë (si IFC dhe SECO).

Aktivitetet:

Aktiviteti	Afati	Institucionet
1. Dokumentacioni digjital dhe interoperabiliteti i të dhënave ndërkufitare	2026–2029	MEI, DPD, AKSHI
2. <i>Time Release Study</i> dhe optimizimi i pikave kryesore kufitare	2026–2028	DPD, MEI
3. Zgjerimi AEO dhe mekanizmi i zgjidhjes së barrierave; zbatimi i komponentit <i>Green Lanes</i>	2026–2030	DPD, MEI, KKLT

Aktiviteti	Afati	Institucionet
4. Vlerësimet/trajnimet për operatorët privatë të logjistikës	2026–2027	MEI, AIDA, IFC, SECO

Treguesit (rezultat/ndikim):

Treguesi	Baza	Synimi i ndërmjetëm	Synimi 2030
Koha mesatare e kalimit kufitar (TRS)	Matja TRS 2026	-15% (2028)	-30%
Operatorë me status AEO	Baza DPD 2025	+50% (2028)	Dyfishim
Dokumentacion tregtar i përpunuar tërësisht digjitalisht	Matja 2026	50% (2028)	≥ 80%

ANEKS NR. 6

M 1.1.11 – Reziliencia (qëndrueshmëria) e zinxhirëve të furnizimit dhe diversifikimi i inputeve (përfshirë CRM” Lëndët e para kritike”)**Objektivat:**

Hartëzimi periodik i varësive nga importet dhe i pikave të dobëta të zinxhirëve të furnizimit për industrinë shqiptare;

Diversifikimi i burimeve të furnizimit (*near-shoring* rajonal/BE, lëndë të para dytësore dhe përdorimit të lëndëve të para dytësore/ricikluara si rezultat i ekonomisë qarkulluese);

Pozicionimi i Shqipërisë në zinxhirët strategjikë të Bashkimit Evropian: lëndët e para kritike (CRM) dhe medikamentet kritike (CM).

Përshkrimi: Për të garantuar qëndrueshmërinë e zinxhirëve të furnizimit, MEI do të bashkëpunojë me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe INSTAT-in, për analizuar varësinë nga inputet kritike, sipas metodologjisë së Komisionit Evropian (2021), një proces që do të zbatohet si një vlerësim periodik çdo dy vjet.

Një shtyllë kryesore e qëndrueshmërisë industriale është zvogëlimi i varësisë nga importet përmes parimeve të ekonomisë qarkulluese. Kjo masë synon promovimin e lëndëve të para dytësore si zëvendësuese të inputeve të importuara. Përmes nxitjes së “simbiozës industriale” (ku mbetjet e një industrie përdoren si lëndë e parë në një industri tjetër, si p.sh. skrapet industriale) dhe standardizimit të tyre në bashkëpunim me DPS-në, synohet krijimi

i një tregu funksional të lëndëve të para dytësore në vend.

AIDA do të mbështesë këtë proces duke ofruar trajnime të dedikuara për menaxhimin e riskut të zinxhirët e furnizimit. Zbatimi i planeve të veprimit për lëndët e para kritike (CRM) dhe medikamentet kritike (CM) do të realizohet në partneritet të ngushtë me MIE-n, përmes Qendra EIT Elbasan, dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale. Deri në dhjetor 2027 do të konsolidohen partneritetet e qëndrueshme të zinxhirit të vlerës industriale me BE-në, ndërkohë që aspektet e sigurisë ekonomike do të trajtohen përmes politikave tregtare dhe promovimit të investimeve të huaja.

Aktivitetet:

Aktiviteti	Afati	Institucionet
1. Vlerësimi i varësive strategjike dhe përditësimi çdo 2 vjet	2026–2030	MEI, DPD, INSTAT
2. Zbatimi i planeve të veprimit CRM/CM me partneritetet e Bashkimit Evropian	2026–2027 (plani); zbatimi deri 2030	MEI, MIE, MSHMS, Qendra EIT Elbasan
3. Trajnime për menaxhimin e riskut të zinxhirit të furnizimit	2026–2030	MEI, shoqatat AIDA,
4. Hartimi i një udhërrëfyesi për promovimin dhe standardizimin e lëndëve të para dytësore në industritë kryesore (si: metalurgji, ndërtim etj.), duke lehtësuar skemat e simbiozës industriale	2027–2028	MEI, MIE, Ministria e Mjedisit, DPS

Treguesit (rezultat/ndikim):

Treguesi	Baza	Synimi i ndërmjetëm	Synimi 2030
Indeksi i përqendrimit të importeve për inputet kritike	Raporti i parë (2027)	-5% (2028)	-10%
Inpute kritike me më shumë se 2 burime furnizimi	Raporti i parë (2027)	+8 pp (2029)	+15 pp
Plane veprimi CRM? Lëndët e para kritike?/CM të miratuara	0 (2025)	1–2 (2027)	Në zbatim

ANEKS NR. 7

M1.1.12 – Përditësimi i ligjit të investimeve dhe thjeshtimi i procedurave për projektet industriale

Objektivat:

Rishikimi i kuadrit të ri ligjor për investimet përmes miratimit të ligjit të ri “Për investimet”.

Përshkrimi:

Kjo masë parashikon rishikimin dhe unifikimin e kuadrit ligjor për investimet përmes hartimit dhe miratimit të ligjit të ri “Për investimet”. Ligji do të jetë në përputhje të plotë me politikën kombëtare të zhvillimit ekonomik dhe do të rishikojë lehtësitë në sektorët prioritarë të ekonomisë, përcaktimi dhe rishikimi periodik i të cilëve do të bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Sistemi i nxitjes do të bazohet në kritere objektive, duke mbështetur ato investime, që gjenerojnë transferim teknologjie, punësim të kualifikuar, kapacitet eksportues dhe bashkëpunim me furnizuesit vendas, të mbështetura nga programe plotësuese për modernizimin e ndërmarrjeve vendase. Kriteret dhe paketat nxitëse do të ndërtohen në përputhje me rregullat e ndihmës shtetërore dhe pragjet e intensitetit.

Për të siguruar që investimet të gjenerojnë vlerë të shtuar të lartë për ekonominë vendase, masat lehtësuese do të lidhen me standarde (*benchmarks*) të përshtatshme. Kuadri i ri ligjor do të përfshijë standarde për bashkëpunimin me furnizuesit vendas, duke i pozicionuar investimet e huaja direkte (IHD) si një përshpejtues për transformimin teknologjik të ekonomisë shqiptare.

Aktivitetet:

Aktiviteti	Afati	Institucionet
1. Rishikimi i projektligjit dhe hartimi i sistemit të pikëzimit sipas ekosistemeve prioritare	2026	MEI
2. Konsultimi publik, RIA me SME Test dhe miratimi i projektligjit	2027	MEI, KM
3. Krijimi i një regjistri të brendshëm pranë AIDA-s për të monitoruar treguesit kryesorë të performancës së investimeve të lehtësuara	2028-2030	MEI, AIDA, INSTAT

**Treguesit (rezultat/ndikim):**

Treguesi	Baza	Synimi i ndërmjetëm	Synimi 2030
Ligji i investimeve i miratuar	Draft (2026)	Miratim 2027	Zbatim i plotë
Investime të reja në ekosistemet e mbështetura nga kuadri i ri ligjor për investimet	0 (2026)	≥ 15 mln EUR (2028)	≥ 50 mln EUR kum.
Pjesa e projekteve të investimit të lehtësuara që plotësojnë kriteret prioritarë të zhvillimit	0%	Matja e parë (2028)	≥ 40% e e projekteve të miratuara (Burimi: regjistri administrativ i AIDA-s)

ANEKS NR. 8

M 1.2.7 – Transferimi i teknologjisë, qeverisja e S3 dhe rritja e kapacitetit absorbues
Objektivat:

Ngritja dhe funksionimi i “Qendrës së Transferimit të Teknologjisë dhe Komercializimit të Teknologjisë” si urë lidhëse mes kërkimit shkencor dhe nevojave të tregut.

Rritja e konkurrueshmërisë në industrisë vendase në ekosistemet prioritarë (*Agropërpunim, Tekstile – Veshje – Lëkurë (TCLF), Energjia e pastër, eksporti i saj, Metalet bazë dhe lëndët e para kritike (CRM), duke përfshirë drurin, turizmin*) përmes ndërthurjes me teknologjitë e pastra dhe të digjitalizuara, duke lehtësuar integrimin e tyre në zinxhirët evropianë të vlerës.

Përrshkrimi: Masa synon krijimin dhe funksionimin e “Qendrës së Transferimit të Teknologjisë dhe Komercializimit të Teknologjisë” si urë lidhëse mes kërkimit shkencor dhe nevojave të tregut. Në kuadër të S3, kjo qendër nuk do të funksionojë në mënyrë të izoluar, pasi fokusi i saj në ekosistemin e “Energjisë së pastër” do të jetë i orientuar drejt transferimit të teknologjive që përmirësojnë konsumin dhe eficiencën e energjisë në proceset prodhuese të industrive të tjera.

Përmes një modeli të ri, “Qendra për Transferimin e Teknologjisë dhe Komercializimit” do të mundësojë funksionimin e një ure lidhëse midis kërkimit shkencor dhe nevojave tregtare të *startup*-eve e NMVM-ve. Një synim strategjik i kësaj qendre do të jetë edhe rritja e kapaciteteve për absorbimin e fondeve të Bashkimit Evropian, duke aplikuar në programe të avancuara evropiane, si dhe

promovimin e bashkëpunimeve të qëndrueshme ndër rajonale. Duke integruar burimet e DIU-së dhe qendrave të specializuara me politikat kombëtare të koordinuara nga “*Innovation4.Albania*”, kjo masë synon arritjen e një avantazhi konkurrues të qëndrueshëm, kalimin nga kërkimi shkencor te komercializimi i teknologjisë dhe integrimin e plotë të sipërmarrjes shqiptare në zinxhirët e vlerës të Bashkimit Evropian.

Për më tepër, duke qenë se matja e produktivitetit real kërkon të dhëna të detajuara dhe të harmonizuara, MEI do të bashkëpunojë ngushtë me INSTAT-in për të lehtësuar transmetimin e të dhënave të detajuara mbi vlerën e shtuar dhe statistikave strukturore të ndërmarrjeve (SBS) drejt Eurostat-it. Për monitorimin e efekteve të kësaj mase, produktiviteti i ndërmarrjeve të mbështetura do të matet në nivel mikro përmes raporteve vjetore të performancës, që do të administrohen nga vetë Qendra e Transferimit të Teknologjisë (ITO).

Aktivitetet:

Aktiviteti	Afati	Institucionet
1. Ngritja dhe funksionimi i “Qendrës për Transferimin e Teknologjisë dhe Komercializimit të Teknologjisë”	2027–2030	MEI, Agjencia “ <i>Innovation4.Albania</i> ”
2. Aplikimi në fondet e Programit të Tregut të Përbashkët të Bashkimit Evropian	2027–2030	MEI, Agjencia “ <i>Innovation4.Albania</i> ”
3. Ndërgjegjësimi i zgjidhjeve dhe siguria kibernetike industriale për bizneset	2027–2030	MEI, Agjencia “ <i>Innovation4.Albania</i> ”
4. Koordinimi me INSTAT-in për përmirësimin e raportimit dhe transmetimit të të dhënave të detajuara të Vlerës së Shtuar (VA) dhe Statistikave Strukturore të Ndërmarrjeve (SBS) drejt Eurostatit	2027–2029	MEI, INSTAT

Treguesit (rezultat/ndikim):

Treguesi	Baza	Synimi i ndërmjetëm	Synimi 2030
Projekte kërkimore të komercializuara përmes Qendrës së Transferimit	0	5 kumulativë	20 kumulativë
Rritja mesatare e produktivitetit të ndërmarrjeve të mbështetura (vlera e	N/A	Matja e parë (2029)	≥ 30% (Raportet vjetore të vetëdeklarimit të ndërmarrjeve të



Treguesi	Baza	Synimi i ndërmjetëm	Synimi 2030
shtuar për punonjës në nivel ndërmarrjeje)			mbështetura pranë TTO)
Ndërmarrje të ekosistemeve S3, që kanë adoptuar teknologji të pastra/qarkulluese përmes mbështetjes së TTO-së.	0	10	15

ANEKS NR. 9

M1.2.9 – Instrumente financiare për modernizimin dhe transformimin industrial të ndërmarrjeve

Objektivat:

-Lehtësimi i aksesit në kredi për NMVM-të, që investojnë në modernizim teknologjik, digjitalizim, eficiencë energjetike dhe zgjerim të kapaciteteve prodhuese me fokus eksportin.

-Reduktimi i pengesave të kolateralit dhe nxitja e kreditimit bankar në sektorët prioritarë përmes skemave të garancisë sovranë (40–70%) dhe partneriteteve me institucionet financiare ndërkombëtare (IFI).

-Harmonizimi i linjave buxhetore dhe fondeve për inovacionin dhe tranzicionin e gjelbër në një instrument të vetëm të unifikuar, duke rritur transparencën dhe kapacitetin absorbues të ndërmarrjeve nëpërmjet asistencës teknike.

Përshkrimi: Kjo masë përfaqëson një reformë strukturore në ekosistemin e financimit të biznesit në Shqipëri, duke synuar kalimin strategjik nga mbështetja e fragmentuar përmes granteve drejt instrumenteve të avancuara të ndarjes së riskut që aktivizojnë kapitalin privat. Programi “Dyfisho sipërmarrjen tënde” konsolidon mbështetjen për modernizimin dhe transformimin teknologjik të NVM-ve, duke adresuar pengesën kryesore të kreditimit: mungesën e kolateralit dhe kapacitetin e kufizuar të vlerësimit të investimeve.

Në zbatim të vendimit nr. 518, datë 30.6.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime në vendimin nr. 463, datë 31.7.2025, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e skemës së veçantë të garancisë shtetërore të huas për garantimin e huamarrjes së subjekteve në sektorin e bujqësisë”, kjo masë zgjeron eksperiencën e suksesshme të garancisë sovranë bujqësore në gjithë sektorët

prioritarë të ekonomisë, duke ofruar garanci shtetërore (në nivele 40–70%) për huat bankare. Instrumenti mundëson lidhjen e financimit me rezultate të matshme ekonomike: rritje të produktivitetit, modernizim të proceseve prodhuese, digjitalizim, përmbushje të standardeve ndërkombëtare dhe rritje të kapaciteteve eksportuese. Për të garantuar efektivitetin e absorbimit të kapitalit, masa shoqërohet me një komponent të rëndësishëm, atë të asistencës teknike (grant), e cila ndihmon ndërmarrjet në *investment-readiness* – nga analiza e nevojave financiare deri tek formulimi i planeve të biznesit. Përmes kësaj ndërhyrjeje, MEI krijon urën lidhëse ndërmjet burimeve financiare dhe objektivave strategjikë të ndërlidhjes së industrisë vendase në zinxhirët e vlerës të Bashkimit Evropian. Fokusi do të jetë mbështetja e ndërmarrjeve, pjesë e ekosistemeve prioritare (*Agropërpunim, Tekstile – Veshje – Lëkurë (TCLF), Energjia e pastër, eksporti i saj, Metalet bazë dhe lëndët e para kritike (CRM), duke përfshirë drurin, turizmin*).

Aktivitetet:

Aktiviteti	Afati	Institucionet
1. Operacionalizimi i garancisë “Dyfisho ndërmarrjen” (VKM 518/2026) dhe lançimi i thirrjeve	2026–2027	MEI, MF, BSH
2. Gatishmëria për investime dhe edukimi financiar për NVM-të	2026–2027	AIDA

Treguesit (rezultat/ndikim):

Treguesi	Baza	Synimi i ndërmjetëm	Synimi 2030
Investime private të mobilizuara përmes instrumenteve	0 EUR (2025)	≥ 500 mln EUR kum. (2028)	≥ 2mld EUR kum.
Ndërmarrje prodhuese me hua të garantuara për modernizim	0 (2025)	45 kum. (2028)	110 kum.

ANEKS NR. 10

M 1.2.11 – Krijimi i Fondit Shqiptar të Inovacionit (FSHI): Instrumenti sovran i bashkinvestimit për rritjen e konkurrenshmerisë dhe ndërmarrjet me rritje të lartë (*scale-up*)

Objektivat:

-Krijimi dhe zbatimi i Fondit Shqiptar të Inovacionit (FSHI), një mjet sovran i financimit të



përzier që kombinon grantet e pakthyeshme me bashkinvestimin në kapital, për të adresuar hendekun e financimit, me të cilin përballen *startup*-et dhe ndërmarrjet novatore shqiptare në fazën e rritjes (“*Scale-Up*”).

-Përmirësimi i aksesit në kapitalin e rritjes për ndërmarrjet me potencial të lartë, duke mbështetur kalimin e tyre nga mbështetja në fazat e hershme drejt rritjes së qëndrueshme dhe integritit në zinxhirët e vlerës evropiane.

-Aktivizimi i investimeve private paralelisht me kapitalin publik, duke operuar në përputhje me rregullat për ndihmën shtetërore.

-Ndërtimi i kapaciteteve institucionale për një model të qëndrueshëm dhe të orientuar nga tregu për financimin e inovacionit, të harmonizuar me standardet e Bashkimit Evropian për mjetet e investimit kolektiv.

Përshkrimi: Ndërmarrjet shqiptare që e kanë kaluar fazën e “*startup*”-it përballen me një hendek financimi të dokumentuar si: aksesit i kufizuar në kapitalin e rritjes pengon aftësinë e tyre për të shkallëzuar prodhimin, për të adoptuar teknologji të avancuara dhe për t’u zgjeruar në tregjet ndërkombëtare. Duke u mbështetur në përvojën e shpërndarjes së 12 milionë eurove në formë grantesh gjatë tri viteve të fundit, Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit (MEI), nëpërmjet agjencisë “*Innovation4Albania*”, do të projektojë dhe do të krijojë Fondin Shqiptar të Inovacionit (FSHI).

FSHI është konceptuar si një instrument i financimit të përzier, që kombinon një dritare grantesh, të përqendruar te *startup*-et dhe komercializimi i kërkimit, me një dritare investimi në kapital, duke u mundësuar ndërmarrjeve të përparojnë nga mbështetja e fazave të hershme drejt financimit për rritje (*Scale-Up*). Dritarja e kapitalit do të operojë mbi baza bashkinvestimi paralelisht me investitorët privatë, në kushte tregu, në mënyrë që kapitali publik të aktivizojë dhe jo të zëvendësojë investimin privat. Fondi do të qeveriset nga një strukturë menaxhuese e ngjashme me fondet e konsoliduara që operojnë në BE, duke ndarë mbikëqyrjen strategjike nga vendimarrja për investimet, për të siguruar që vendimet të merren mbi baza meritokracie dhe të jenë të izoluara nga ndikimi politik, në përputhje me standardet që kërkohen nga institucionet financiare ndërkombëtare dhe rregullat e Bashkimit Evropian për ndihmën shtetërore.

Kapitalizimi i saktë, vlerat e investimeve, përparësitë sektoriale dhe parametrat operativë të Fondit do të përcaktohen gjatë fazës së projektimit (aktiviteti 1 më poshtë), duke u bazuar në vlerësimin e ekosistemit dhe punën e standardizimit (*benchmarking*), që është kryer tashmë.

Aktivitetet:

Aktiviteti	Afati	Institucionet
1. Projektimi i Fondit Shqiptar të Inovacionit: struktura ligjore, modeli i qeverisjes, strategjia e kapitalizimit dhe dritaret e investimit.	2026–2027	MEI (Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit), Ministria e Financave, Agjencia “ <i>Innovation4Albania</i> ”
2. Hartimi i bazës ligjore, licencimi dhe kapitalizimi i Fondit	2027–2030	MEI (Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit), Ministria e Financave, AFSA (Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare), institucionet financiare ndërkombëtare
3. Lançimi i dritareve të granteve dhe bashkinvestimit në kapital të Fondit.		Shoqëria Menaxhuese e FSHI-së (AIF), Agjencia “ <i>Innovation4Albania</i> ”

Treguesit (rezultat/ndikim):

Treguesi	Baza	Synimi i ndërmjetëm	Synimi 2027
Fondi Shqiptar i Inovacionit i projektuar, i krijuar me një bazë ligjore dhe i kapitalizuar	I pakrijuar (2026)	Fondi i themeluar ligjërisht (2027)	Plotësisht funksional, të dyja dritaret të vëna në zbatim
Ndërmarrje të mbështetura përmes granteve dhe/ose dritareve të investimit në kapital të Fondit	0 (2026)	Për t’u përcaktuar gjatë fazës së projektimit të Fondit	Për t’u përcaktuar gjatë fazës së projektimit të Fondit
Kapital privat i mobilizuar paralelisht me investimin publik	0 € (2026)	-	Për t’u përcaktuar gjatë fazës së projektimit të Fondit



ANEKS NR. 11

M 1.2.12 – Përmirësimi i mjedisit rregullator për NMVM-të: Implementimi i “SME Test” dhe kuadri për pagesat e vonuara

Objektivat:

- Integrimi i detyrueshëm i testit të NMVM-ve (SME Test) me metodologji sasiore brenda procesit të vlerësimit të ndikimit rregullator (RIA), me qëllim parandalimin e barrierave administrative dhe kostove të tepërta për sipërmarrjet e vogla dhe të mesme gjatë hartimit të legjislacionit të ri;

- Harmonizimi i kuadrit rregullator me Direktivën 2011/7/BE për luftën e pagesave të vonuara në transaksionet tregtare;

- Garantimi i mekanizmave efektivë të monitorimit dhe zbatimit të afateve kontraktuale, me qëllim mbrojtjen e likuiditetit të ndërmarrjeve prodhuese në transaksionet tregtare.

Përshkrimi: Kjo masë synon transformimin e mjedisit rregullator për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në Shqipëri, duke integruar në mënyrë të detyrueshme testin e NMVM-ve (*SME Test*) me metodologji sasiore brenda sistemit të vlerësimit të ndikimit rregullator (RIA). Ky instrument, i cili vjen si përgjigje direkte ndaj gjetjeve të raportit të OECD-së 2026, do të shoqërohet me trajnimin e dedikuar të administratës publike dhe do të pilotohet në të gjitha aktet normative me ndikim të lartë industrial për të parandaluar mbingarkesat administrative. Paralelisht, masa garanton përafrimin legjislativ me direktivën 2011/7/BE përmes amendimit të ligjit nr.48/2014, brenda vitit 2026, për krijimin e një klime biznesi më të besueshme dhe konkurruese, e cila nxit marrëdhënie të qëndrueshme B2B dhe forcon besimin e investitorëve në ekonominë shqiptare.

Aktivitetet:

Aktiviteti	Afati	Institucionet
1. Metodologjia SME Test, integrimi në RIA, trajnimi dhe pilotimi	2026–2028	MEI, Kryeministria (Dep. RIA)
2. Tabela e përputhshmërisë me 2011/7/BE, drafti i ligjit 48/2014, miratimi	2026–2027	MEI
3. Pyetësori, ndërmjetësimi pilot dhe fushata e ndërgjegjësimit	2026–2030	MEI, Dhoma e Ndërmjetësimit, AIDA

Treguesit (rezultat/ndikim):

Treguesi	Baza	Synimi i ndërmjetëm	Synimi 2030
Akte të reja me ndikim mbi industrinë/NVM-të me SME Test sasior	0% (2025)	50% (2027)	100%
Përafrimi me direktivën 2011/7/BE	Tabela (2026)	Ligji miratuar (2027)	Zbatim i monitoruar
Koha mesatare e pagesës B2B në sektorët prodhues	Pyetësori 2026	-10% (2029)	-20%

ANEKS NR. 12

M 1.2.13 – Programi kombëtar i zhvillimit të klasterave industriale dhe integrimi në zinxhirët e IHD-ve

Objektivat:

-Krijimi dhe funksionimi i klasterave në ekosistemet prioritare (Agropërpunim, Tekstile – Veshje – Lëkurë (TCLF), Energjia e pastër, eksporti i saj, Metalet bazë dhe lëndët e para kritike (CRM), duke përfshirë drurin, turizmi) për të rritur volumin dhe kapacitetet teknike të ndërmarrjeve vendase (NMVM), duke i transformuar ato nga prodhues të thjeshtë me kosto të ulët në partnerë të besueshëm dhe të gatshëm për t'u integruar në zinxhirët e furnizimit të investitorëve të huaj.

-Zbatimi i një sistemi nxitës për investitorët e huaj (IHD), që kushtëzon stimujt me rezultate të matshme në integrimin lokal, duke prioritetizuar projektet, që garantojnë transferim të njohurive, zhvillim të rritjes të furnizuesve vendas dhe bashkëpunim në projekte inovative e teknologjike me klasterat ekzistues.

-Ndërtimi i një strukture të qëndrueshme menaxheriale për klasterat vendas, përmes programeve të trajnimit dhe certifikimit të menaxherëve, për të rritur konkurrueshmërinë e ekosistemeve industriale shqiptare.

Përshkrimi: Masa synon krijimin dhe funksionimin e klasterave si instrumente të politikës së investimeve të huaja direkte (IHD-ve). Qëllimi është transformimi industrial nga një destinacion për “kosto të ulët” në një destinacion për “vlerë të integruar”, ku investitorët e huaj nuk operojnë në izolim, por si pjesë e një ekosistemi vendas. Kjo masë shërben si urë lidhëse midis prodhimit vendas dhe zinxhirëve të vlerës ndërkombëtare. Masa synon formalizimin dhe fuqizimin e menaxhimit të



klasterave në ekosistemet prioritarë, për t'i bërë ata “të gatshëm për tregun”. Kjo rrit volumet dhe kapacitetet teknike të ofertës vendase, duke krijuar një zinxhir furnizimi të konsoliduar që u përgjigjet kërkesave specifike të investitorëve të mëdhenj në vendin tonë. Masa synon formalizimin dhe fuqizimin e menaxhimit së klasterave të NMVM-ve, me synim arritjen e volumit dhe kapaciteteve teknike të kërkuara nga investitorët e huaj. Masa synon konsolidimin e ofertës vendase dhe përmirësimin e lidhjeve të biznesit mes ndërmarrjeve vendase dhe industrive të mëdha.

Aktivitetet:

Aktiviteti	Afati	Institucionet
1. Kuadri Operacional Kombëtar për Klasterat (udhërrëfyesi me faza, mbështetja e shkallëzuar, kriteret e daljes) + përshtatja e stimujve për IHD-të	2026–2027	MEI, AIDA
2. Fondi për krijimin dhe zhvillimin e Klasterave	2027–2030	AIDA, MEI
3. Platforma e Lidhjes IHD–NVM: <i>checklist</i> blerësi, <i>mock audits</i> me rritim 30-ditor, regjistri publik i furnizuesve gati, ndërmjetësimi i porosive të provës	2027–2030	AIDA
4. Regjistrimi në ECCP dhe pjesëmarrja në ESCP-S3/Euroclusters	2027–2030	AIDA, MEI

Treguesit (rezultat/ndikim):

Treguesi	Baza	Synimi i ndërmjetëm	Synimi 2030
Vlera e kontratave të reja të furnizimit NVM–IHD të lidhura përmes programit	0 EUR (2025)	≥ 5 mln EUR kum. (2028)	≥ 25 mln EUR kum.
NVM me status “gatishmëri furnizimi” të certifikuar	0 (2025)	25 (2028)	90
Klastera të regjistruar në ECCP/partneritete evropiane	0 (2025)	3 në ECCP (2028)	≥ 5; ≥ 2 në ESCP-S3

ANEKS NR. 13

M 1.3.6 – Paketa kombëtare e aftësive të gjelbra dhe digjitale në industri (*Green & Digital Upskilling*)

Objektivat:

-Përshtatja e kurrikulave të arsimit dhe formimit profesional (AFP) dhe arsimit të lartë me nevojat specifike dhe dinamikat e zhvillimit të ekosistemeve prioritarë industriale.

-Implementimi i programeve të dedikuara të trajnim-kualifikimit për stafin teknik të ndërmarrjeve prodhuese, me fokus të veçantë në automatizimin e proceseve, menaxhimin e mbetjeve industriale (ekonomia qarkulluese) dhe auditimin e eficiencës energjetike.

-Fuqizimi i bashkëpunimit ndërmjet ofruesve të arsimit dhe sipërmarrjeve private përmes konsolidimit të skemave të arsimit dual dhe sistemeve të të nxënës të bazuar në punë.

Përkrahimi: Masa synon adresimin e aktiviteteve ndaj sfidave të kapitalit njerëzor në industri, duke zgjeruar sistemin ekzistues të parashikimit të nevojave me module të inteligjencës sektoriale sipas ekosistemeve prioritarë (*Agropërpunim, Tekstile – Veshje – Lëkurë (TCLF), Energjia e pastër, eksporti i saj, Metalet bazë dhe lëndët e para kritike (CRM), duke përfshirë drurin, turizmin*). Përmes një bashkëpunimi të strukturuar ndërmjet universiteteve, qendrave të formimit profesional dhe industrisë, do të zhvillohen programe të dedikuara të rikualifikimit dhe ngritjes së aftësive për teknikët në sektorin e manifakturës, me fokus të veçantë në automatizim, menaxhimin e mbetjeve dhe auditimin e energjisë.

Ky proces do të mbështetet nga modernizimi i kurrikulave të AFP-së dhe arsimit të lartë, ngritja e partneriteteve të drejtuara nga vetë industria dhe funksionalizimi i një platforme digjitale të aftësive.

Aktivitetet:

Aktiviteti	Afati	Institucionet
Analiza e aftësive sektoriale sipas ekosistemeve prioritarë	2026–2030	MEI, MAS, institucionet e arsimit të lartë
Programet e rikualifikimit për teknikët e fabrikave (me universitetet/QFP-të) në ekosistemet industriale	2026–2030	MEI, AKPA, INSTAT



Aktiviteti	Afati	Institucionet
Modernizimi i kurrikulave AFP/arsim i lartë për profilet industriale	2026–2029	MAS, AKPA, MEI
Platforma digjitale e aftësive	2026–2027	AKSHI, MEI, AKPA

Treguesit (rezultat/ndikim):

Treguesi	Baza	Synimi i ndërmjetëm	Synimi 2030
Punonjës të trajnuar në aftësi të gjelbra/digjitale ($\geq 40\%$ gra)	0 (2025)	1 000 kum. (2028)	3 000 kum.
Ndërmarrje që raportojnë vështirësi në gjetjen e aftësive	Matja 2026	-10 pp (2028)	-20 pp
Kurrikula të modernizuara për profilet e ekosistemeve prioritare	0 (2025)	5 (2028)	10

ANEKS NR. 14

PJESA III. ZBATIMI, PËRGJEGJËSIA E INSTITUCIONEVE, LLOGARIDHËNIA, RAPORTIMI DHE MONITORIMI

Objektiv:

- Plotësimi i pozicioneve vakante në strukturat përgjegjëse për politikën industriale dhe mbështetjen e NVM-ve (MEI dhe AIDA), bazuar në afate të detajuara kohore, për të siguruar mbulimin e funksioneve të reja të planifikuara në këtë strategji.

- Zbatimi i një programi trajnimesh për strukturën e ngarkuar për politikën industriale dhe NVM-të, përmes instrumenteve të asistencës teknike (si TAIEX etj).

Sipas vlerësimit institucional dhe administrativ të kapitullit 20 (IAGA), struktura aktuale e MEI-t përfshin Drejtorinë e Analizës së Strategjive Ekonomike (10 punonjës) dhe Drejtorinë e Simulimit dhe Vëzhgimit (7 punonjës), në Drejtorinë e Përgjithshme të Informacionit dhe Analizës Ekonomike, si dhe 31 punonjës në tri drejtori të Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave për Zhvillimin Ekonomik, Promovimin e Biznesit dhe Tregtisë. IAGA-ja identifikon si boshllëqe kryesore nivelin e ulët të bashkërendimit të brendshëm dhe ndërinstitucional, si dhe burimet e pamjaftueshme për mbështetjen e konkurre-

eshmërisë industriale, gjetje që kjo masë synon t'i adresojë drejtpërdrejt. Iniciativa synon që ky plan kapacitësh të mbështesë zbatimin e koordinuar të të gjitha masave mbështetëse për industrinë dhe NVM-të (ekosistemet prioritare (*Agropërpunim, Tekstile – Veshje – Lëkurë (TCLF), Energjia e pastër, eksporti i saj, Metalet bazë dhe lëndët e para kritike (CRM), duke përfshirë drurin, turizmin*), IHD, instrumentet financiare, reziliencën (qëndrueshmërinë), tranzicioni i gjelbër/digjital), në lidhje me planin e veprimit dhe mekanizmin e vetëm ndërinstitucional, pa dublikuar planet ekzistuese të kapaciteteve në strategji.

Për të garantuar zbatimin efektiv të politikave të reja industriale, strategjia parashikon hartimin e një plani gjithëpërfshirës për forcimin e kapaciteteve institucionale. Ky proces përfshin vlerësimin dhe plotësimin e vakancave në strukturat përgjegjëse, me një objektiv ambicioz për të arritur 80% të stafit deri në vitin 2027 dhe 100% deri në vitin 2028. Për të siguruar forcimin e kapaciteteve, do të implementohet një program disaveçar trajnimi në fusha si politikën industriale të Bashkimit Evropian, ndihma shtetërore, mekanizmat e monitorimit dhe vlerësimit, si dhe menaxhimi i fondeve të Bashkimit Evropian.

Aktivitetet:

Aktiviteti	Afati	Institucionet
Kryerja e një vlerësimi të nevojave për trajnim (TNA), sipas rekomandimit të vlerësimit institucional dhe administrativ të kapitullit 20 (IAGA), si bazë për hartimin e programit të trajnimeve.	T1-T2 2026	MEI, AIDA, DAP
Funksionimi i sekretariatit teknik dhe përditësimi i përshkrimeve të punës	2026–2027	MEI, DAP
Vlerësimi i vakancave dhe miratimi i planit të plotësimit (numra, afate, buxhet)	T1-T2 2026	MEI, AIDA, DAP
Programi disaveçar i trajnimeve (TAIEX/ <i>twinning</i> /SIGMA)	2026–2030	MEI, DAP
Plotësimi i vendeve vakante në Drejtorinë e Përgjithshme të Informacionit dhe Analizës Ekonomike dhe në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave për Zhvillimin Ekonomik, sipas boshllëqeve të identifikuara nga IAGA	2026–2030	MEI, DAP



Lidhur me operacionalizimin e Mekanizmit të vetëm ndërinstitucional, strategjia do të synojë:

- krijimin e një mekanizmi të vetëm bashkërendues për monitorimin e strategjisë në bashkëpunim me përfaqësuesit e industrisë dhe NVM-të;

- implementimin e një arkitekture administrative të qartë, të mbështetur nga një sekretariat teknik permanent, që siguron ndjekjen e një kalendarit aktivitetesh, përmbushjen e produkteve dhe përcaktimin e përgjegjësiave institucionale;

- publikimin e raportit vjetor mbi ecurinë e strategjisë;

- forcimin e kapaciteteve njerëzore dhe koordinuese të Sekretariatit Teknik (aktualisht Drejtoria e Politikave të Zhvillimit Ekonomik, MEI) dhe përditësimi i përbërjes institucionale të grupit ndërinstitucional të ngritur me urdhrin nr. 214, datë 13.12.2023, të Kryeministrit, “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për monitorimin e Strategjisë së Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2021–2027 dhe planit të saj të veprimit”, në përputhje me riorganizimin e strukturës qeveritare dhe funksionet e reja të kësaj strategjie.

Monitorimi i strategjive kombëtare shpesh përballlet me sfida që lidhen me fragmentimin e të dhënave dhe mungesën e një koordinimi të ngushtë ndërinstitucional. Masa synon të adresojë këtë sfidë, duke e shndërruar monitorimin e strategjisë nga një detyrim administrativ në një Sistem të Inteligjencës Ekonomike. Pjesa kryesore e kësaj reforme është krijimi i grupit ndërmintor të punës, një mekanizëm i nivelit të lartë që do të kryesohet nga zëvendësministri përgjegjës për ekonominë në MEI. Ky komitet nuk do të jetë thjesht një forum diskutimi, por një qendër vendimmarrjeje, që bashkon përfaqësuesit më të lartë të Ministrisë së Financave, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrisë së Mjedisit dhe AIDA-s, së bashku me përfaqësues të sektorit privat dhe akademisë. Ky mekanizëm shërben si struktura koordinuese qendrore për të gjitha masat mbështetëse të reja (ekosistemet prioritare (Agropërpunim, Tekstile – Veshje – Lëkurë (TCLF), energjia e pastër, metalet bazë dhe lëndët e para kritike (CRM), duke përfshirë drurin, turizmi), IHD, instrumentet financiare, rritja e kapaciteteve, reziliencia (qëndrueshmëria) e zinxhirëve të furnizimit, tranzicioni i gjelbër dhe digjital), duke garantuar zbatimin e njësuar të planit të veprimit të

BIDS pa dublikime institucionale. Strategjia njih dhe formalizon rolin strategjik të rrjetit diplomatik në shërbim të zhvillimit ekonomik. Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ) në zbatimin e BIDS 2030 përfshihet si institucion bashkëpunues në mekanizmin ndërmintor të koordinimit dhe në masat që lidhen me tërheqjen e investimeve të huaja direkte, ndërkombëtarizimin e ndërmarrjeve shqiptare dhe promovimin e eksporteve në tregjet e huaja. Roli i MEPJ-së është konceptuar si promovues, lehtësues dhe ndërlidhës nëpërmjet diplomacisë ekonomike (misionet diplomatike dhe pikave të kontaktit jashtë vendit), duke mbështetur AIDA-n dhe MEI-n në identifikimin e tregjeve potenciale dhe lidhjen e bizneseve shqiptare me rrjetet ndërkombëtare. Ky rol ushtrohet brenda mandatit zyrtar të MEPJ-së, pa i ngarkuar kësaj ministrie përgjegjësi direkte zbatuese sektoriale apo detyrime financiare buxhetore, të cilat mbeten përgjegjësi e institucioneve zbatuese.

Gjithashtu, sipas vlerësimit institucional dhe administrativ të kapitullit 20 (IAGA), rekomandohet që qeverisja e përhershme e Strategjisë së Specializimit Inteligjent (S3) të integrohet dhe formalizohet brenda grupit ndërinstitucional ekzistues (urdhri nr. 214, datë 13.12.2023, i Kryeministrit, “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për monitorimin e strategjisë së zhvillimit të biznesit dhe investimeve 2021-2027 dhe planit të saj të veprimit”), dhe që ky i fundit të harmonizohet me IPMG-në për konkurrueshmërinë dhe Investimet, në përputhje me qasjen gjithë-qeveritare të rekomanduar nga IAGA, për të shmangur krijimin e strukturave paralele apo dokumenteve të reja të pakoordinuara.

Strategjia synon gjithashtu në krijimin e sekretariatit teknik, i cili do të jetë si një “Njësi e Analizës dhe Monitorimit të Politikave”. Ky sekretariat nuk do të mjaftohet me hartimin e raporteve vjetore, por do të shërbejë si qendra kryesore analitike e strategjisë. Përmes integritit të të dhënave nga burime të ndryshme (dogana, QKB, tatime etj.), Sekretariati do të gjenerojë analiza parashikuese mbi ecurinë e masave dhe raportime mbi zbatimin e tyre. Ky sistem monitorimi do të ngrihet përmes rishikimit të urdhrit nr. 214, datë 13.12.2023, të Kryeministrit, “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për monitorimin e strategjisë së zhvillimit të biznesit dhe investimeve 2021–2027 dhe planit të saj të veprimit”, brenda vitit 2027.



Aktiviteti	Afati	Institucionet
1. Projekturdhri i Kryeministrit për përditësimin e urdhrit nr. 214, datë 13.12.2023, të Kryeministrit, “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për monitorimin e strategjisë së zhvillimit të biznesit dhe investimeve 2021-2027 dhe planit të saj të veprimit” (përbërja institucionale sipas strukturës së re qeveritare - MEI) dhe forcimin e mandatit të grupit ndërinstitucional ekzistues	T4 2026 – T1 2027	MEI (Drejtoria e Politikave të Zhvillimit Ekonomik), Kryeministria
2. Forcimi i kapaciteteve të sekretariatit teknik (staf shtesë dhe trajnim i dedikuar) dhe riaktivizimi/rregullimi i mbledhjeve periodike të grupit ndërinstitucional sipas urdhrit nr. 214, datë 13.12.2023, të Kryeministrit, “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për monitorimin e strategjisë së zhvillimit të biznesit dhe investimeve 2021–2027 dhe planit të saj të veprimit”,	2026–2027	MEI
3. Raportimi: gjashtëmujor te kabineti i KM + raporti vjetor publik + GMIP/IPSIS	Nga 2027	Sekretariati, të gjitha institucionet përgjegjëse



Aktivitetet:

ANEKS NR. 15

FORMATI I PLANIT TË VEPRIMIT, I PËRMBLEDHUR

PLANI I VEPRIMIT NË ZBATIM TË DOKUMENTIT STRATEGJIK (2021–2030)

I. QËLLIMI STRATEGJIK: “Një ekonomi shqiptare konkurruese, e nxitur nga inovacioni dhe e bazuar në njohuri, e cila krijon vende pune të reja dhe më cilësore, duke shfrytëzuar mundësitë që ofron transformimi digjital dhe transformimi i zinxhirit të vlerave ndërkombëtare, me theksin mbi zhvillimin e qëndrueshëm, integrimin evropian dhe atë rajonal”

II. QËLLIMI I POLITIKËS: Zhvillimi plotësisht i potencialeve të investimeve për zhvillimin ekonomik dhe nxitjen e integritimit në tregjet ndërkombëtare dhe zinxhirët e vlerës

III. PROGRAMI BUXHETOR: Programi buxhetor i MEI 04130 “Mbështetje për zhvillimin ekonomik”

Nr.	Objektivi specifik, produkti, Masa	Produkti	Institucionet përgjegjëse		Afati i zbatimit		Totali 2021–2030				Komente
			Institucioni udhëheqës	Institucion kontribues	Afati i fillimit	Afati i mbarimit	Kostoja indikative	Burimi i financimit		Hendeku financiar	
								Buxheti i shtetit Programi 04130 “Mbështetje për zhvillimin ekonomik”	Financimi i huaj		
1.1	Tërheqja e investimeve dhe ndërkombëtarizimi	- Rritja e fluksit të investimeve nga 7.6 në9% të PBB-së; - Rritja e totalit të eksportit të mallrave dhe shërbimeve nga 31.5% në 36% të PBB-së; - Rritja e vlerësimit në indeksin e politikave për NVM-të (integrimi iNVM-ve në zinxhirin e vlerave globale) nga 1.1 në 3.1.	AIDA	Ministri përgjegjës për ekonominë,MEPJ, MIE, MTM, MBZHR, BDHTI dhe shoqatat e biznesit	TM1-2021	TM4-2027	152,706,415	66,882,383	1,601,100	(84,222,932)	Ishte
1.1	Tërheqja e investimeve dhe ndërkombëtarizimi	- Rritja e fluksit të investimeve nga 7.6 në 9% të PBB-së; - Rritja e totalit të eksportit të mallrave dhe shërbimeve nga 31.5% në 36% të PBB-së; - Rritja e vlerësimit në indeksin e politikave për NVM-të (integrimi iNVM-ve në zinxhirin e vlerave globale)	Ministri përgjegjës për ekonominë	AIDA, ministrinë dhe shoqatat e biznesit	2026	2030	322,850,604	230,323,706	63,126,334	(29,400,564)	Bëhet



		nga 1.1 në 3.1.									
1.1.1	Promovimi/lehtësimi sistematik i investimeve të synuara	- 7 fushata specifike të targetimit për grupet e synuara; - 51 projekte tërheqësetë investimeve; - 127,500 mijë euro volumi i investimeve; - Krijimi i 15,300 vendeve pune të reja.	AIDA	Ministri përgjegjës për ekonominë, MEPJ, MIE, MTM, MBZHR, BDHTI dheshoqatat e biznesit	TM1-2021	TM4-2027	30,824,970	16,301,130	-	(14,523,840)	Ishte
1.1.1	Promovimi/lehtësimi sistematik i investimeve të synuara	- 7 fushata specifike të targetimit për grupet e synuara; - 51 projekte tërheqësetë investimeve; - 127,500 mijë euro volumi i investimeve; - Krijimi i 15,300 vendeve pune të reja.	AIDA	Ministri përgjegjës për ekonominë, MEPJ, MIE, MTM, MBZHR, BDHTI dheshoqatat e biznesit	TM1-2026	TM4 2030	28,698,780	14,174,940	-	(14,523,840)	Bëhet
1.1.2	Program i strukturuar për shërbimin e përkujdesjes së mëtejshme	- 300 klientë të <i>after-care</i> (investitorët ekzistues); - 20 memorandume mirëkuptimi të nënshkruara me bashki/partner; - 160 projekte të riinvestimit; - 320,000 mijë EUR vëllimi i riinvestimit; - 16,000 vende pune të krijuara nga investitorët ekzistues.	AIDA	AIDA, ministri përgjegjës për ekonominë, bashkitë, dhomat dhe shoqatat e tregtisë	TM1-2022	TM4-2027	-	-	-	-	Masë ekzistuese
1.1.3	Vlerësimi dhe reforma e programit të TEDA-ve	- Finalizimi i vlerësimit, udhëzuesit të reformës dhe konceptit të zhvillimit (deri në vitin 2022); - 30 ha tokë e zhvilluar/20 ha e përdorur nga investitorët në zonën e zgjedhur; - 20 rezident aktivë në zonën e zgjedhur; - 3,000 vende pune të reja, të krijuara në zonën e zgjedhur.	Ministri përgjegjës për ekonominë	Ministri përgjegjës për ekonominë, Korporata Shqiptare e Investimeve	Vlerësimi dhe koncepti i zhvillimit (2021) zbatimi dhe koncepti i zhvillimit (2022)	Vlerësimi dhe koncepti i zhvillimit (2022) zbatimi dhe koncepti i zhvillimit (2027)	11,876,724	-	-	(11,876,724)	Masë ekzistuese
	Programi i zhvillimit të	- Pjesëmarrje e 30	AIDA	AIDA, ministri përgjegjës	Faza pilot	Faza pilot	62,013,581	7,261,253	-	(54,752,328)	Masë e



	ofruesve	investitorëve deri në 2027; - Pjesëmarrje e 150 bizneseve lokale deri më 2027; - Lehtësimi i nënkontratave me vlerë 75 milionë euro deri më 2027.		për ekonominë	(2021) zbatimi i programit (faza pilot (2023)	(2024) zbatimi i programit (2027)					hequr (në rishikimin e 2025)
1.1.4	Programi i ekonomisë qarkulluese industriale dhe parqet ekoindustriale	- Riorientimi i 30% të mbetjeve industriale nga landfilli drejt riciklimit deri në vitin 2029, me synim final prej $\geq 50\%$; - Rritja e nivelit të ujit industrial të ricikluar në ndërmarrjet e asistuar TCLF në 20% deri në vitin 2029, me synim final prej $\geq 40\%$; - Zbatimi i protokolleve qarkulluese ose planeve të gjelbra në 15 NVM deri në vitin 2028, me synim final prej 40 NVM; - Arritja e një përqindjeje prej 30% të ndërmarrjeve në parqet pilot sipas standardeve EIP deri në vitin 2028, me synim final prej 60%.	Ministri përgjegjës për ekonominë	Korporata Shqiptare e Investimeve, AIDA	TM1-2026	TM4-2030	46,908,000	-	46,908,000	-	Masë e re



1.1.5	Përgatitja e industrisë për tregun e gjelbër në tregun e përbashkët (MRV, Gatishmëria CBAM dhe efienca e energjisë në prodhim)	- Ndërmarrje industriale dhe eksportuese të mbështetura për zbatimin e kërkesave për zbatimin e kërkesave MRVA dhe gatishmëri CBAM: Vlera bazë prej 0 në vitin 2025, me një synim të ndërmjetëm prej 25 ndërmarrjesh deri në vitin 2028, duke synuar një objektiv final prej 60 ndërmarrjesh deri në vitin 2030; - Kapaciteti i ri i vetëprodhimit nga burimet e rinovueshme të energjisë (BRE) i ndërmarrjeve (MW): Vlera bazë do të përcaktohet nga ERE në vitin 2026; synimet e ndërmjetme do të vendosen sipas pasaportës përkatëse të projektit, ndërsa objekti final i vitit 2030 do të përcaktohet në koordinim me MIE/ERE; - Intensiteti energjetik i industrisë përpunuese: Vlera bazë e monitoruar përmes INSTAT/Eurostat (2025), duke synuar një reduktim prej -5% deri në vitin 2028 (synimi i ndërmjetëm) dhe një reduktim final prej -10% deri në vitin 2030.	Ministria e Mjedisit	Ministria e Mjedisit, MEI, MIE, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Agjencia e Eficiencës së Energjisë, Enti Rregullator i Energjisë.	TM1-2026	TM4-2030	-	-	-	-	Masë e re
1.1.6	Standardet, certifikimi dhe gatishmëria për tregun e vetëm (me modul ndërkombëtarizimi)	- Certifikimi CE/ISO i fituar nga 25% e ndërmarrjeve përmes programit deri në vitin 2028, me synim final prej 50% e ndërmarrjeve kumulative; - rritja e eksporteve drejt Bashkimit Evropian për ndërmarrjet e mbështetura me +10% deri në vitin 2028, me	Ministri përgjegjës për ekonominë	Komiteti Ndërmnistror për Integrimin Ekonomik të Sipërmarrjes, Ekipi Kombëtar për hartimin dhe ndjekjen e procesit të implementimit të programit.	TM4-2026	TM4-2030	144,840,000	144,840,000	-	-	Masë e re



		synim final prej +25%.									
1.1.7	Iniciativa e zhvillimit të biznesit elektronik	- 300 biznese përfituese (2022–2024); - 75 zgjidhje për biznesin elektronik/tregtinë elektronike të miratuaranga përfituesit; - 15% rritje në eksportet e biznesevepërfituesve.	Ministri përgjegjës përkërkonominë	Ministri përgjegjës përkërkonominë, AIDA	TM2-2022	TM3-2024	47,801,100	43,200,000	1,601,100	(3,000,000)	Masë ekzistuese
1.1.8	Digjitalizimi industrial dhe akses në AI/EuroHPC	- Integrimi i zgjidhjeve digjitale/AI në 35 NVM prodhuese përmes skemës deri në vitin 2028, me synim final prej 90 NVM-sh kumulative; - Shfrytëzimi i 200,000 <i>core hours</i> të kapacitetit EuroHPC deri në vitin 2028, me synim final prej 1,000,000 <i>core hours</i> kumulative; - Arritja e rritjes së produktivitetit në ndërmarrjet e mbështetura 24 muaj pas ndërhyrjes, me një synim final prej ≥ 30% duke filluar nga matja e parë në vitin 2029.	Ministri përgjegjës përkërkonominë	AKSHI, DIU	TM4-2026	TM4-2030	37,200,000	22,582,766	14,617,234	-	Masë e re
1.1.9	Vlerësimi i modelit të diplomacisë ekonomike	Vlerësimi i modelit ekzistues të diplomacisë ekonomike dhe identifikimi i opsioneve të reformës në periudhën 2025–2027	MEPJ	Ministri përgjegjës përkërkonominë, AIDA	TM4-2026	TM4-2030	5,538,000	5,538,000	-	-	Masë ekzistuese
1.1.10	1.1.10 Lehtësimi i veprimtarisë industriale ndërkufitare dhe logjistika	- Reduktimi i kohës mesatare të kalimit kufitar (TRS) me 15% deri në vitin 2028, me synim final prej -30%; - Rritja e numrit të operatorëve me status AEO me +50% deri në vitin 2028, me synim final dyfishimin e numrit aktual; - Përpunimi digjital i 50% të dokumentacionit tregtar deri në vitin 2028, me synim final	Ministri përgjegjës përkërkonominë	DPT, AIDA	TM2-2026	TM4-2030	-	-	-	-	Masë e re



		prej $\geq 80\%$.									
1.1.11	Rezilienca (qëndrueshmëria) e zinxhirëve të furnizimit dhe diversifikimi i inputeve	- Reduktimi i indeksit të përqendrimit të importeve për inputet kritike me 5% deri në vitin 2028, me synim final prej -10%; - Diversifikimi i furnizimit me mbështetje për 30 ndërmarrje kumulative deri në vitin 2028, me synim final prej 80 ndërmarrjesh kumulative.	Ministri përgjegjës për ekonominë	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, AIDA, DPD, INSTAT, DPT	TM4-2026	TM4-2030	-	-	-	-	Masë e re
1.1.12	Përditësimi i ligjit të investimeve dhe thjeshtimi i procedurave për projektet industriale	Miratim brenda 2027 i projekligjit Zbatimi i ligjit	Ministri përgjegjës për ekonominë	AIDA, ministrinë e linjës	TM4-2027	TM4-2030	-	-	-	-	Masë e re
1.2	Zhvillimi i NVM-ve, sipërmarrja dhe inovacioni	100% pas hyrjes në fuqi	100%	Ministri përgjegjës për ekonominë, MIE, MTM, MZHBR, Agjencia “Innovation4.Albania”, ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, inkubatorët, përsheptuesit dhe organizatat e mbështetjes së mëtejshme	TM2-2021	TM4-2027	9,271,689,226	6,699,318,082	2,147,163,624	(425,207,520)	Ishte
1.2	Zhvillimi i NVM-ve, sipërmarrja dhe inovacioni	≥ 15 mln EUR (2028)	≥ 50 mln EUR kum.	AIDA, MIE, Ministria e Mjedisit, MZHBR, Agjencia “Innovation4.Albania”, inkubatorët, përsheptuesit dhe organizatat e mbështetjes së biznesit.	2026	2030	6,468,034,366	5,534,341,342	40,135,008	(893,558,016)	Bëhet
1.2.1	Skema për mbështetjen e sipërmarrjes me bazën konkurrencën	- 360 NMVM që marrin pjesë në CoSolve-19; - 150 pjesëmarrës në trajnime çdo vit (të paktën 40% femra); - 30 grante çdo vit (të paktën 40% ndaj grave).	AIDA	AIDA, ministri përgjegjës për ekonominë	TM1-2021	TM4-2025	675,601,114	140,698,714	534,902,400	-	Masë e përfunduar
1.2.2	Lidhja mes NMVM-ve dhe startup-eve	- Organizimi i aktiviteteve ndërgjegjësuere me startup-e	AIDA dhe Agjencia “Innovation4.Albania”	Ministri përgjegjës për ekonominë	2025	2030	5,760,000	5,760,000	-	-	Masë ekzistuese



		dhe biznese NMVM në periudhën 2025–2027.									
1.2.3	Fuqizimi i ekosistemit të <i>startup</i> -eve	- Funksionimi i Agjencisë së <i>startup</i>-eve; - Regjistruar 375 biznese <i>startup</i> inovative; - Shkalla e mbijetesës prej 65% pas 5 vjetësh 3,000 vende pune të krijuara nga bizneset <i>startup</i>.	Ministri përgjegjës për ekonominë	Agjencia “ <i>Innovation4.Albania</i> ”, ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, inkubatorët, përsheptuesit dhe organizatat e mbështetjes së mëtejshme	TM1-2021	TM4-2027	1,663,476,624	59,802,624	1,603,674,000	-	Masë e përfunduar
1.2.4	Akresi në programet e Bashkimit Evropian në fushën e biznesit	- Mbështetje për NMVM-të dhe bizneset <i>startup</i> për të marrë pjesë në programet e Bashkimit Evropian (Programin e Tregut të Përbashkët 2021–2027).	AIDA dhe Agjencia “ <i>Innovation4.Albania</i> ”	AIDA	2025	2027	36,516,000	-	36,516,000	-	Masë ekzistuese
1.2.5	Integrimi ndërkombëtar i ekosistemit të <i>startup</i> -eve	- 30 biznese <i>startup</i> shqiptare dhe 25 mentorë të diasporës që marrin pjesë; - 12 organizata mbështetëse shqiptare që bashkëpunojnë me qendrat ndërkombëtare - 25 biznese <i>startup</i>; - shqiptare që bashkëpunojnë me qendrat ndërkombëtare.	Ministri përgjegjës për ekonominë	Ministri përgjegjës për ekonominë, AIDA, Agjencia e Diasporës dhe Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Agjencia “ <i>Innovation4.Albania</i> ”	2025	2030	47,577,024	-	3,619,008	(43,958,016)	Masë ekzistuese
1.2.6	Nisma për përmirësimin e zinxhirit të vlerave me bazë konkurrencën	- 40 aplikime/20 konsorciume të zgjedhura për fazën e konceptit më 2022 - 10 konsorciume të mbështetura në fazën e zbatimit 2023–2024; - 15% rritje në të ardhurat e NVM-ve pjesëmarrëse në vitet 2023 dhe 2027; - 50 vende të reja punetë krijuara nga përfituesit deri në 2023 dhe 2027.	AKKSHI	AIDA, ministri përgjegjës për ekonominë, MASR etj. dhe organizata të tjera mbështetëse	TM1-2022	TM4-2024	367,200,000	-	-	(367,200,000)	Masë ekzistuese



1.2.7	Transferimi i teknologjisë, qeverisja e S3 dhe kapaciteti absorbues	- Ndërmarrje që përdorin shërbimet e zgjerimit/transferimit/DIH: 0 (2025) 80 kum. (2028) 200 kum; - Pjesa e ndërmarrjeve industriale me veprimtari inovacioni: 41.6% (2024) 45% (2028) ≥ 50%; - Projekte industri-kërkim të bashkëfinancuara: 0 (2025) 15 kum. (2028) 40 kum.	Ministri përgjegjës përkonominë	Agjencia "Innovation4.Albania", AKKSHI, akademia dhe shoqatat e biznesit.	2026	2030	24,000,000	24,000,000	-	-	Masë e re
1.2.8	Rritje e aksesit në financë për NMVM-të	- 60 përfitues të Fondit të Zhvillimit të NVM- ve çdo vit (2022–2027); - 30% përfitues e sipërmarrëse gra /biznese të drejtuara nga gratë (2022–2027); - 180 vende pune të reja të krijuara nga përfituesit e Fondit çdo vit (2022–2027); - Hartuar një kornizë ligjore dhe nënligjore për NMVM-të (deri në 2021); - VKM për skemën e garancisë shtetërore e hartuar (deri në vitin 2023); - Hartuar korniza ligjore për financimin e investimeve <i>crowdfunding</i>; - Krijimi i një rrjeti të engjëjve të biznesit.	Ministri përgjegjës përkonominë	AIDA	TM1-2026	TM4-2030	449,441,100	449,441,100	-	-	Masë ekzistuese
1.2.9	Instrumente financiare për modernizimin dhe përshtatjen e ndërmarrjeve	- Investime private të mobilizuara përmes instrumenteve: 0 EUR (2025) ≥ 15 mln EUR kum. (2028) ≥ 50 mln EUR kum; - Ndërmarrje prodhuese me hua të garantuara për modernizim: 0 (2025) 45 kum. (2028) 110 kum.	Ministri përgjegjës përkonominë	AIDA	TM1-2026	TM4-2030	5,024,000,002	5,024,000,002	-	-	Masë e re



1.2.10	Program për aftësitë sipërmarrëse për NVM-të	- 12 trajnime çdo vit; - 300 pjesëmarrës në trajnime çdo vit.	AIDA	Ministri përgjegjës për ekonominë, AKPA, BDHTI dhe shoqatat e biznesit	TM1-2022	TM4-2030	31,140,240	31,140,240	-	-	Masë ekzistuese
1.2.11	Krijimi i Fondit Shqiptar të Inovacionit (FSHI): Instrumenti Sovran i Bashkinvestimit për Rritjen e Konkurrueshmërisë dhe Ndërmarrjet me Rritje të Lartë (<i>Scale-Up</i>)	- Fondi i krijuar ligjërisht (2027).	MEI	Ministria e Financave, Agjencia “ <i>Innovation4Albania</i> ”, AMF	2027	2030	482,400,000	-	-	482,400,000	Masë e re
1.2.12	Mjedisi rregullator për NVM-të: SME Test dhe pagesat e vonuara	- Akte të reja me ndikim mbi industrinë/NVM-të me SME Test: 0% (2025) 50% (2027) 100%; - Përafrimi me Direktivën 2011/7/BE: Tabela (2026) Ligji i miratuar (2027) Zbatim i monitoruar; - Koha mesatare e pagesës B2B në sektorët prodhues: Pyetësori 2026 -10% (2029) -20%.	Ministri përgjegjës për ekonominë	AIDA, ministrinë e linjës, BDHTI dhe shoqatat e biznesit	TM1-2022	TM4-2030	-	-	-	-	Masë e re
1.2.13	Programi kombëtar i zhvillimit të klasterave industriale dhe integrimi në zinxhirët e IHD-ve	- Gjenerimi i vlerës së kontratave të reja të furnizimit NVM-IHD prej ≥ 5 milionë EUR (kumulative) deri në vitin 2028, me synim final prej ≥ 25 milionë EUR (kumulative); - Certifikimi i 25 NVM-ve me status “gatishmëri furnizimi” në laboratorët e përbashkët deri në vitin 2028, me synim final prej 90 NVM; - Formalizimi i 3 klasterave me menaxhim sipas ECEI deri në vitin 2028 (prej të cilëve 1 me Bronze Label), me synim final prej ≥ 5 klasterash,	Ministri përgjegjës për ekonominë	AIDA	TM1-2026	TM4-2030	7,309,210	7,309,210	-	-	Masë e re



		nga të cilët ≥ 3 të vetëfinancuar; - Regjistrimi i 3 klasterave në ECCP deri në vitin 2028, me synim final prej ≥ 5 klasterash të regjistruar dhe ≥ 2 në ESCP-S3.									
1.3	Zhvillimi i kapitalit njerëzor	- Rritje e PBB-së për person të punësuar nga 34,600 në 37,000 (në vitin 2017, PPP konstante në \$); - Rritje e përqindjes së punësimeve në profesione që kërkojnë njohuri të thelluara nga 17.5% në 19.5%; - Rritje e vlerësimit në indeksin e politikave për NVM-të (aftësitë sipërmarrëse) nga 4.3 në 3.9.	Ministri përgjegjës për ekonominë	AIDA, MASR, AKKSHI	TM1-2021	TM4-2027	181,140,000	37,700,000	-	(142,440,000)	Ishte
1.3	Zhvillimi i kapitalit njerëzor	- Rritje e PBB-së për person të punësuar nga 34,600 në 37,000 (në vitin 2017, PPP konstante në \$); - Rritje e përqindjes së punësimeve në profesione që kërkojnë njohuri të thelluara nga 17.5% në 19.5%; - Rritje e vlerësimit në indeksin e politikave për NVM-të (aftësitë sipërmarrëse) nga 4.3; në 3.9.	Ministri përgjegjës për ekonominë	AIDA, AKPA, AKAFP, MASR, AKKSHI	2026	2030	98,640,000	98,640,000	-	(98,640,000)	Bëhet
	Skema e mbështetjes për zhvillimin e kapitalit njerëzor bashkëpunues	- 150 përfitues (të paktën 40% gra); - 100 NVM që punësojnë talente përtej kohëzgjatjes së mbështetjes.	AIDA	Ministri përgjegjës për ekonominë, MASR, AKKSHI	TM2-2023	TM4-2027	108,000,000	-	-	(108,000,000)	Ishte
1.3.1	Skema e mbështetjes për zhvillimin e kapitalit	- 150 përfitues (të paktën 40% gra)	AIDA	Ministri përgjegjës për ekonominë, MASR,	TM2-2026	TM4-2030	86,640,000	-	-	(86,640,000)	Bëhet



	njerëzor bashkëpunues	- 100 NVM që punësojnë talente përtej kohëzgjatjes së mbështetjes		AKKSHI							
1.3.2	Program për zhvillimin e fuqisë punëtore për dhemirëkuptimi me partnerët; me NVM-të dhe investitorët	- 20 memorandume mirëkuptimi me partnerët; 10 investitorë/NVM-të mbështetur çdo vit (2021–2023), 25 investitorë/NVM të mbështetur çdo vit (2024–2027); - 40 pjesëmarrës në trajnime çdo vit (2021–2023), 175 pjesëmarrës çdo vit (2024–2027).	AIDA	Ministri përgjegjës për ekonominë, MEPJ, AKPA, bashkitë, qendrat e formimit, dhomat dhe shoqatat e tregtisë	TM4-2021	TM4-2027	60,900,000	-	-	(60,900,000)	Masë e hequr
1.3.3	Sensibilizimi dhe përfshirja e bizneseve në reformat e sistemit të VET-es	- Ndërgjegjësimi dhe përfshirja e bizneseve në prezantimin e modelit të VET-ës në periudhën 2025–2027.	Ministri përgjegjës për politikat e punësimit	Ministri përgjegjës për ekonominë	2026	2027	-	-	-	-	Masë ekzistuese
1.3.4	Sistemi i parashikimit të nevojave për aftësi	- Sistemi i parashikimit i zhvilluar/implementuar (deri në vitin 2022); - 3 raporte parashikimi.	AKPA	AKAFPK, ministri përgjegjës për ekonominë, MASR, BDHTI dhe shoqatat e biznesit, sektoriprivat	TM3-2021	TM4-2027	12,240,000	-	-	(12,240,000)	Masë ekzistuese
1.3.5	Vlerësim periodik i nevojave për trajnim	- 1 vlerësim i nevojave për trajnim çdo vit; - 250 SME të asistuar çdo vit.	AIDA	AIDA, ministri përgjegjës për ekonominë, AKPA, BDHTI dhe shoqatat e biznesit.	TM4-2021	TM-2027	-	-	-	-	Masë ekzistuese
1.3.6	Paketa kombëtare e aftësive të gjelbra dhe digjitale në industri (<i>Green & Digital Upskilling</i>)	- Punonjës të trajnuar në aftësi të gjelbra/Digjitale ($\geq 40\%$ gra): 0 (2025) 1,000 kum. (2028) 3,000 kum; - Ndërmarrje që raportojnë vështirësi në gjetjen e aftësive: Matja 2026 -10 pp (2028) -20 pp; - Kurrikula të modernizuara për profilet e ekosistemeve: 0 (2025) 5 (2028) 10.	MEI	AKPA, AIDA, akademia, shoqatat e biznesit	TM4-2026	TM-2030	-	-	-	-	Masë e re

**VENDIM****Nr. 627, datë 30.7.2026****PËR MIRATIMIN E ORGANIZIMIT DHE ZHVILLIMIT TË PROGRAMIT “PAS SHKOLLE” TË KATEGORIVE, KRITEREVE DHE MËNYRËS SË PËRZGJEDHJES, SHPËRBLIMIT TË TRAJNUESVE, SI DHE MËNYRËS SË FINANCIMIT TË KËTIJ PROGRAMI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 47/1, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:**I. ORGANIZIMI DHE ZHVILLIMI I PROGRAMIT “PAS SHKOLLE”**

1. Programi “Pas shkolle” është i organizuar dhe i strukturuar në veprimtari, që zhvillohen jashtë orarit mësimor të detyruar dhe ka për qëllim përfundimin e të nxënësve dhe zhvillimin gjithëpërfshirës të aftësive edukative, sociale, sportive, kulturore dhe krijuese të nxënësve.

2. Programi “Pas shkolle” realizohet për nxënës të regjistruar në institucionet arsimore parauniversitare publike të arsimit bazë dhe të arsimit të mesëm të lartë.

II. KATEGORITË DHE KRITERET E TRAJNUESVE

1. Programi “Pas shkolle” për veprimtari që lidhen me mbështetjen dhe përfundimin e të nxënësve, të cilat synojnë konsolidimin e njohurive, aftësive, zhvillimin e kompetencave dhe përmirësimin e arritjeve të nxënësve, zhvillohen nga trajnuesit, të cilët ndahen në kategoritë e mëposhtme:

a) Mësuesi i punësuar në institucionet arsimore parauniversitare publike, me kontratë me kohëzgjatje të pacaktuar apo me kohëzgjatje të caktuar;

b) Individidi, i cili plotëson kriteret e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për ushtrimin e profesionit të mësuesit, i është nënshtruar provimit të portalit “Mësues për Shqipërinë”, sipas akteve të posaçme që rregullojnë procedurën e konkurrimit në këtë portal dhe ndodhet në listë pritjeje për një vend të

lirë pune në institucionet arsimore parauniversitare publike;

c) Individidi, i cili ka mbushur moshën e pensionit të pleqërisë dhe ka ushtruar më parë mësimdhënie në institucionet arsimore publike;

ç) Individidi, që është diplomuar në fushën e mësuesisë apo në fusha të përafërta në një program të ciklit të dytë të studimeve, në institucione të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë apo në institucione të huaja të arsimit të lartë, për të cilin është njohur dhe është njësuar diploma e huaj, bazuar në përcaktimet e legjislacionit në fuqi.

2. Programi “Pas shkolle”, për veprimtari që lidhen me zhvillimin e aftësive artistike, kulturore, krijuese dhe praktike të nxënësve, zhvillohet nga trajnuesit, të cilët ndahen në kategoritë e mëposhtme:

a) Mësuesi, i cili ushtron profesionin e mësuesit në profilet artistike, i punësuar në institucionet arsimore parauniversitare publike, me kontratë me kohëzgjatje të pacaktuar apo me kohëzgjatje të caktuar;

b) Individidi, i cili plotëson kriteret e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për ushtrimin e profesionit të mësuesit në profilet artistike, i është nënshtruar provimit të portalit “Mësues për Shqipërinë”, sipas akteve të posaçme që rregullojnë procedurën e konkurrimit në këtë portal dhe ndodhet në listë pritjeje për një vend të lirë pune në institucionet arsimore parauniversitare publike;

c) Individidi, i cili ka mbushur moshën e pensionit të pleqërisë dhe ka ushtruar më parë mësimdhënie në profilet artistike në institucionet arsimore publike ose ka ushtruar profesionin në këto profile në institucionet kulturore publike;

ç) Individidi, i cili është diplomuar në fushën e mësuesisë apo në programe studimi të ngjashme ose të përafërta me fushën/lëndën e mësimdhënies në arsimin parauniversitar në profilet artistike, në institucione të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë apo institucione të huaja të arsimit të lartë, për të cilin është njohur dhe është njësuar diploma e huaj, bazuar në përcaktimet e legjislacionit në fuqi;

d) Individidi, i cili ka përfunduar një program studimi të ciklit të dytë në fushën e arteve;

dh) Artizanë të mjeshtrive të ndryshme të dijëbërjes dhe zejeve, të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Bartësve të Folklorit ose në Regjistrin e Vlerave të Trashëgimisë Jomateriale.



III. APLIKIMI I KANDIDATËVE PËR TRAJNUES

1. Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar shpall në faqen zyrtare thirrjen për aplikim për kandidatët për trajnues për t'u angazhuar në programin "Pas shkolle".

2. Kandidatët për trajnues kanë të drejtë të aplikojnë brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e publikimit të shpalljes, sipas përcaktimeve të pikës 1, të këtij kreu.

3. Kandidati, i cili ushtron profesionin e mësuesit, sipas përcaktimit të shkronjës "a", të pikës 1, dhe të shkronjës "a", të pikës 2, të kreut II, të këtij vendimi, aplikon për t'u angazhuar në programin "Pas shkolle" në Sistemin e Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar (SMIP).

4. Kandidati, sipas përcaktimit të shkronjës "b", të pikës 1, dhe të shkronjës "b", të pikës 2, të kreut II, të këtij vendimi, aplikon për t'u angazhuar në programin "Pas shkolle", duke përzgjedhur opsionin përkatës në shërbimin elektronik "aplikim për konkurrim për punësim", "Mësues për Shqipërinë", në portalin "*e-Albania*".

5. Kandidatët për trajnues të kategorive të tjera, të përcaktuara në pikat 1 dhe 2, të kreut II, të këtij vendimi, dorëzojnë dosjen e aplikimit në zyrën vendore të arsimit parauniversitar (në vijim ZVAP), nën juridiksionin e së cilës ndodhet institucioni arsimor.

6. Të dhënat elektronike të dosjes për aplikimin e kandidatëve, sipas përcaktimit të shkronjave "a" dhe "b", të pikave 1 dhe 2, të kreut II, të këtij vendimi, merren përmes ndërveprimit nga SMIP-ja ose nga portali "Mësues për Shqipërinë".

7. Dosja e aplikimit për kandidatët, sipas përcaktimit të shkronjave "c", "ç" dhe "d", të pikës 2, të kreut II, të këtij vendimi, përmban dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Kopjen e diplomës/ave të arsimit të lartë dhe listës së notave/suplement i diplomës;

b) Vërtetimin mjeko-ligjor;

c) Certifikatën e gjendjes gjyqësore (dëshmi penalteti);

ç) Vërtetimin nga prokuroria, që kandidati nuk është në ndjekje penale për kryerjen e një vepre penale;

d) Vërtetimin nga gjykata, që kandidati nuk është i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

dh) Kopjen e certifikatave/dëshmime për trajnime të kryera (nëse ka);

e) Deklaratën nga kandidati për autorizimin e institucionit arsimor, që të shqyrtojë vërtetësinë e dokumenteve të paraqitura;

ë) Vërtetimin e pensionit për kandidatët, sipas përcaktimit të shkronjës "c", të pikës 2, të kreut II, të këtij vendimi.

8. Dosja e aplikimit për kandidatët, sipas përcaktimit të shkronjës "dh", të pikës 2, të kreut II, përmban dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Vërtetimin e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Veprimtarive Tradicionale, që janë pjesë e Regjistrat Kombëtar të Bartësve të Folklorit ose Regjistrat të Vlerave të Trashëgimisë Jomateriale;

b) Certifikatën e gjendjes gjyqësore (dëshmi penalteti);

c) Vërtetimin nga prokuroria, që kandidati nuk është në ndjekje penale për kryerjen e një vepre penale;

ç) Vërtetimin nga gjykata, që kandidati nuk është i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

d) Kopjen e certifikatave/dëshmime për trajnime të kryera (nëse ka);

dh) Deklaratën nga kandidati për autorizimin e institucionit arsimor, që të shqyrtojë vërtetësinë e dokumenteve të paraqitura.

IV. MËNYRA E PËRZGJEDHJES SË TRAJNUESVE

1. Kandidatëve, mësues të arsimit fillor, të punësuar në institucionin arsimor parauniversitar publik përkatës, u jepet përparësi për angazhimin në programin "Pas shkolle", që zhvillohet në klasat e arsimit fillor, për veprimtaritë që lidhen me mbështetjen dhe përforcimin e të nxënësve. Në mungesë të kandidatit të interesuar, kanë të drejtë të aplikojnë për t'u angazhuar në programin "Pas shkolle" mësuesit e arsimit të mesëm të ulët të institucionit arsimor parauniversitar publik përkatës.

2. Kandidatëve, mësues të profileve përkatëse, sipas veprimtarive, të punësuar në institucionin arsimor parauniversitar publik përkatës, u jepet përparësi për angazhimin në programin "Pas shkolle", që zhvillohet në arsimin e mesëm të ulët, për veprimtaritë që lidhen me zhvillimin e aftësive artistike, kulturore, krijuese dhe praktike të nxënësve.



3. Kandidatët e përcaktuar në pikat 1 dhe 2, të këtij kreu, kanë të drejtë të aplikojnë vetëm në institucionin arsimor parauniversitar publik, në të cilin janë të punësuar.

4. Pikëzimi i dosjeve dhe përzgjedhja e kandidatit, të përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 1, dhe në shkronjën “a”, të pikës 2, të kreut II, të këtij vendimi, të punësuar në institucionin arsimor parauniversitar publik përkatës, bëhet nga një komision në nivel shkolle, me 3 (tre) anëtarë me përbërje, si më poshtë:

- a) Drejtori i shkollës;
- b) Një mësues i zgjedhur nga këshilli i mësuesve;
- c) Kryetari i këshillit të prindërve të institucionit.

5. Në rast se numri i aplikimeve është më i ulët se numri i kërkuar nga institucioni arsimor parauniversitar publik, drejtori i shkollës përcjell me shkresë zyrtare në ZVAP kërkesën për plotësimin e vendeve të lira.

6. Kandidati që ka konkurruar në portalin “Mësues për Shqipërinë”, të përcaktuar në shkronjën “b”, të pikës 1, dhe në shkronjën “b”, të pikës 2, të kreut II, të këtij vendimi, përzgjidhet në përputhje me profilin e mësuesit të kërkuar nga institucioni arsimor, duke respektuar renditjen e tyre në portal, sipas pikëve totale të fituara. Procedura për angazhimin e trajnuesit kryhet nga komisioni *ad hoc* i ngritur nga ZVAP-ja, i cili përbëhet nga drejtuesi i ZVAP-së dhe nga dy anëtarë.

7. Pikëzimi i dosjeve për kandidatët e përcaktuar në shkronjat “c” dhe “ç”, të pikës 1, dhe në shkronjat “c”, “ç”, “d” dhe “dh”, të pikës 2, të kreut II, të këtij vendimi, bëhet nga një komision vlerësimi *ad hoc* i ngritur nga zyra vendore e arsimit parauniversitar, i cili përbëhet nga 3 (tre) anëtarë, nga të cilët dy janë përfaqësues të zyrës vendore arsimore parauniversitare dhe 1 (një) përfaqësues nga drejtoria rajonale arsimore parauniversitare.

8. Anëtarët e komisionit të vlerësimit nuk marrin pjesë në shqyrtimin dhe vlerësimin e dosjeve të personave me të cilët kanë konflikt interesi. Deklarimi dhe konstatimi i konfliktit të interesit bëhet sipas procedurave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për konfliktin e interesit.

9. Komisioni i vlerësimit kryen vlerësimin dhe pikëzimin e dosjes së kandidatit, sipas kritereve dhe metodologjisë, të përcaktuar me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin.

10. Vendimet e komisionit merren me shumicën e të gjithë anëtarëve.

11. Përzgjedhja e kandidatëve të përcaktuar në pikën 6, të këtij kreu, bëhet sipas renditjes në pikat 1 dhe 2, të kreut II, të këtij vendimi.

12. Procedura e ankimimit bëhet sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurave Administrative.

13. Në rast mungese të kandidatit ose largimit të tij, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar rishpall thirrjen për trajnues, në kuadër të programit “Pas shkolle”.

14. Pas përzgjedhjes së trajnuesit, lidhet kontrata e shërbimit ndërmjet tij dhe institucionit arsimor parauniversitar, ku trajnuesi angazhohet për programin “Pas shkolle”.

V. MËNYRA E FINANCIMIT DHE SHPËRBLIMI I TRAJNUESVE PËR PROGRAMIN “PAS SHKOLLE”

1. Programi “Pas shkolle” financohet nga fondi buxhetor i miratuar për këtë qëllim, për çdo vit buxhetor, nëpërmjet akordimit të fondeve për zyrat vendore të arsimit parauniversitar për realizimin e këtij programi.

2. Shpërblimi i trajnuesve të programit “Pas shkolle” trajtohet si pagesë për shërbim të veçantë arsimor, të kryer jashtë detyrimeve, që rrjedhin nga kontrata e punës.

3. Për shkollat me status të veçantë, fondi për pagesën e mësuesve të angazhuar në program akordohet drejtpërdrejt në buxhetin e institucionit arsimor përkatës.

4. Pagesa për çdo orë për zbatimin e programit “Pas shkolle” për trajnuesit, për veprimtaritë që zhvillohen jashtë orarit mësimor të detyruar, është 1 000 (një mijë) lekë. Shpërblimi për realizimin e programit “Pas shkolle”, për trajnuesit e punësuar në institucionet parauniversitare publike, nuk përbën pjesë të pagës mujore dhe nuk ndikon në ngarkesën mësimore të detyrueshme.

VI. MONITORIMI, RAPORTIMI DHE ADMINISTRIMI I DOKUMENTACIONIT

1. Institucioni arsimor parauniversitar publik mban dokumentacionin përkatës për zhvillimin e veprimtarive, pjesëmarrjen e nxënësve dhe realizimin e orëve, sipas formatit të miratuar nga Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar.

2. Institucioni arsimor parauniversitar publik administron portofolin digjital të arritjeve të nxënësve pjesëmarrës në programin “Pas shkolle”.

3. ZVAP-ja raporton periodikisht në drejtorinë rajonale të arsimit parauniversitar për realizimin e



programit “Pas shkolle”, përfshirë numrin e institucioneve arsimore përfituese, numrin e trajnuesve, numrin e nxënësve pjesëmarrës, veprimtaritë e zhvilluara dhe realizimin e fondit të akorduar.

4. Drejtoria rajonale e arsimit parauniversitar monitoron realizimin e programit “Pas shkolle” dhe raporton periodikisht në Agjencinë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar, e cila raporton në ministrinë përgjegjëse për arsimin.

5. Realizimi i programit “Pas shkolle” është objekt monitorimi dhe kontrolli nga drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar dhe nga Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar.

6. Zbatimi i programit “Pas shkolle” vlerësohet mbi bazën e treguesve që lidhen me numrin e institucioneve arsimore përfituese, numrin e trajnuesve, numrin dhe frekuencimin e nxënësve pjesëmarrës, realizimin e veprimtarive, nivelin e përdorimit të fondit, shtrirjen territoriale dhe rezultatet e arritura.

VII. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Përgjashtimisht, për vitin shkollor 2026–2027, kërkesa për aplikim për t’u angazhuar në programin “Pas shkolle” për mësuesin e klasifikuar në portalin “Mësues për Shqipërinë”, kryhet në rrugë elektronike.

2. Vendimi nr. 606, datë 14.9.2022, i Këshillit të Ministrave, “Për zbatimin e programit ‘pas shkolle’”, i ndryshuar, shfuqizohet.

3. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM

Nr. 630, datë 30.7.2026

PËR KRIJIMIN E REGJISTRIT KOMBËTAR TË AKTIVITETIT TË LICENCUAR DHE TË LEJUAR TË BIMËS SË *CANNABIS*-it

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të pikës 6, të nenit 13, të ligjit nr. 61/2023, “Për kontrollin e kultivimit të bimës së *cannabis*-it dhe prodhimit të nënprodukteve të saj për qëllime mjekësore dhe industriale”, dhe të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazën e të dhënave shtetërore”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe të ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Krijimin e bazës së të dhënave shtetërore “Regjistri Kombëtar i Aktivitetit të Licencuar dhe të Lejuar të Bimës së *Cannabis*-it” (në vijim Regjistri).

2. Në Regjister regjistrohen dhe ruhen elektronikisht të gjitha informacionet për kërkesat e vendimmarrjet për licencim, leje, autorizim, gjurmim, mbikëqyrje, kontroll dhe inspektim, masa administrative lidhur me të gjitha fazat e kultivimit të *cannabis*-it, duke filluar nga dhënia e licencës, lejes dhe autorizimit deri tek pezullimi apo shfuqizimi i tyre, si dhe sekuestrimi apo asgjësimi i bimëve apo produkteve dhe nënprodukteve të saj, sipas parashikimeve të ligjit nr. 61/2023, dhe të akteve nënligjore, në zbatim të tij.

3. Agjencia Kombëtare e Kontrollit të *Cannabis*-it (në vijim Agjencia) është institucioni administrues i Regjistrit, i cili bashkëpunon dhe bashkërendon punën me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (në vijim AKSHI) për ngritjen e hostimit, si dhe ofrimin e asistencës teknike për përdorimin e Regjistrit.

II. NDËRVEPRIMET DHE NIVELI I AKSESIT

1. Regjistri shkëmben të dhëna përmes një ndërfaqeje, duke garantuar sinkronizimin dypalësh të informacionit me bazat e tjera të të dhënave.



2. Regjistri ndërvepron me portalin qeveritar “e-Albania”, me qëllim lehtësimin e procedurave të aplikimit për t’u pajisur me licencë dhe leje.

3. Regjistri ndërvepron me:

a) sistemin e shënimit dhe gjurmueshmërisë, i cili administrohet nga Agjencia, në aspektin e të dhënave, dhe nga shoqëria “ALBTrace CO” sh.a., në aspektin teknik;

b) bazën e të dhënave shtetërore “Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile”, të administruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile;

c) bazën e të dhënave shtetërore “Regjistri Tregtar” dhe “Regjistri Kombëtar i Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve”, të administruara nga Qendra Kombëtare e Biznesit;

ç) bazën e të dhënave shtetërore “Sistemin elektronik tatimor”, të administruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;

d) bazën e të dhënave shtetërore “Sistemi i Automatizuar i të Dhënave Doganore”, të administruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

4. Përdorues të Regjistrit janë, si më poshtë vijon:

a) Ministria përgjegjëse për shëndetësinë;

b) Ministria përgjegjëse për bujqësinë;

c) Agjencia Kombëtare e Kontrollit të *Cannabis*-it;

ç) Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore;

d) Autoriteti Kombëtar i Ushqimit;

dh) Administrata doganore;

e) Administrata tatimore;

ë) Agjencia Kombëtare e Mjedisit;

f) Policia e Shtetit;

g) Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve;

gj) Shoqëria “ALBTrace CO” sh.a.;

h) subjektet e licencuara apo të lejuara.

5. Tipologjitë e niveleve të aksesit në Regjistër përcaktohen, si më poshtë vijon:

a) Administratori është përgjegjës për krijimin dhe administrimin e të gjithë përdoruesve, mbikëqyrjen, dhënien, heqjen e kredencialeve të aksesimit të përdoruesve, si dhe gjenerimin e raporteve e të statistikave. Administratori gëzon të drejtat e të gjitha niveleve të tjera, si regjistruesi dhe shikues;

b) Regjistruesi është përgjegjës për hedhjen e të dhënave të reja e dokumentacionit, duke mbajtur përgjegjësi për vërtetësinë e të dhënave që regjistron.

Regjistruesi ka të drejtë të shikojë të dhëna ekzistuese dhe të gjenerojë nga Regjistri analiza, statistika dhe raporte të të dhënave të aksesueshme prej tij. Regjistruesi mund të modifikojë ose të fshijë të dhënat e hedhura në mënyrë të pasaktë, brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga hedhja e tyre. Pas mbarimit të këtij afati, modifikimi mund të kryhet vetëm nga administratori, me kërkesë të regjistruesit;

c) Shikuesi ka akses vetëm për leximin e të dhënave të regjistrit, pa të drejtë ndërhyrjeje, modifikimi, fshirjeje apo gjenerimi të raporteve, si dhe pamundësi për të ndryshuar ose për të përpunuar në çfarëdo forme të dhënat e aksesuara.

6. Agjencia, në rolin e administratorit të Regjistrit:

a) është përgjegjës për sigurimin e mirëfunksionimit të Regjistrit;

b) autorizon dhe administron nivelet e aksesit të përdoruesve në Regjistër;

c) mbikëqyr dhe monitoron veprimet që kryhen në Regjistër.

7. Institucionet janë përgjegjëse për kryerjen e veprimeve në Regjistër, në përputhje me këtë vendim, sipas tipologjisë së aksesit.

8. Agjencia përcakton nivelin e aksesit të përdoruesit në regjistër, në përputhje me funksionet dhe përgjegjësitë që ushtrojnë institucionet e subjektet.

9. Subjektet janë përgjegjëse për hedhjen e të gjitha të dhënave në Regjistër, sipas parashikimeve në ligjin nr. 61/2023, dhe në aktet nënligjore në fuqi, si dhe përcaktimeve në këtë vendim. Moshedhja e tyre në kohën e duhur dhe/ose jo në përputhje me situatën reale përbën shkelje për subjektin. Agjencia, kur konstaton se të dhënat e hedhura apo të modifikuara nga subjekti nuk janë të sakta, i evidenton ato përmes aktit të konstatimit, si dhe korrigjon të dhënat në Regjistër.

10. Të gjithë përdoruesit, pjesë të fushës së veprimit të këtij vendimi, kanë detyrimin të kujdesen për ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave të aksesit në Regjistër, si dhe mbajnë përgjegjësi personale të drejtpërdrejtë, në rast të shkeljes së rregullave, pakujdesisë apo keqpërdorimit të nivelit të tyre të aksesit.

11. Në rast të konstatimit të veprimeve të paligjshme, Agjencia pezullon menjëherë aksesin e institucionit ose subjektit, i cili ka vepruar në kundërshtim me ligjin apo me udhëzimet e procedurat për administrimin e bazës së të dhënave



shtetërore. Pezullimi i aksesit nuk përjashton përgjegjësinë administrative, civile ose penale.

III. PËRMBAJTJA, ADMINISTRIMI DHE RUAJTJA E TË DHËNAVE TË REGJISTRIT

1. Regjistri përmban të dhënat, si më poshtë vijon:

1.1 Të dhëna parësore:

a) Të dhënat e procesit të licencimit;

b) Të dhënat e procesit të lejimit;

c) Të dhënat e importit;

ç) Të dhënat e procesit të kultivimit dhe të përpunimit (evidentimi i kryerjes së proceseve teknike me datat dhe sasitë përkatëse të materialit të përfutur);

d) Të dhënat e kontrollit laboratorik (certifikatat e analizave me rezultatet e testimit apo të rëtestimit);

dh) Të dhënat e gjurmueshmërisë dhe të etiketimit (administrimi i etiketave);

e) Të dhënat e menaxhimit të mbetjeve dhe të asgjësimit (dokumentimi i plotë i procesit të asgjësimit të mbetjeve);

ë) Të dhënat e eksportit (autorizimet e eksportit, kontratat me subjektet e huaja dhe procedurat doganore dalëse);

f) Të dhënat e transportit (autorizimet e lëvizjeve të bimës së *cannabis*-it, nënprodukteve dhe produkteve të saj);

g) Të dhënat e mbikëqyrjes, kontrollit dhe inspektimit (procesverbale, akte e raporte të monitorimit në terren dhe në distancë, masat administrative, konfiskimet).

1.2 Të dhëna dytësore, të cilat Regjistri i merr nga ndërveprimi me bazat e tjera të të dhënave, përmendur në pikën 3, të kreut II, të këtij vendimi, që janë nga:

a) sistemi i shënimit dhe i gjurmueshmërisë, si më poshtë vijon:

i. të dhënat e dokumentit të transportit;

ii. të dhënat e importit;

iii. të dhënat e kultivimit;

iv. të dhënat e paketimit;

v. të dhënat e konfiskimit;

vi. të dhënat e asgjësimit;

b) Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile, si më poshtë vijon:

i. numri i identifikimit personal;

ii. emri, atësia, mbiemri;

iii. datëlindja;

iv. vendlindja (shteti, njësia administrative bashkia/qarku);

c) Regjistri Tregtar dhe Regjistri Kombëtar i Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve, si më poshtë vijon:

i. emri i subjektit;

ii. NIPT-i;

iii. forma juridike (p.sh.: sh.p.k., sh.a., person fizik etj.);

iv. adresa e selisë;

v. licenca aktive;

vi. objekti i veprimtarisë;

vii. lloji i dokumentit të lëshuar (licencë, autorizim, leje, certifikatë ose certifikatë autorizimi);

viii. të dhëna për adresën e ushtrimit të aktivitetit;

ix. të dhëna për administratorët, këshillin mbikëqyrës, pjesëmarrjen në drejtim;

x. kapitali i shoqërisë së huaj;

xi. emri i degës ose i zyrës së përfaqësimit, nëse është i ndryshëm nga ai i shoqërisë së huaj;

ç) baza e të dhënave shtetërore, sistemi elektronik tatimor, si më poshtë vijon:

i. të dhëna për detyrimet në kohë reale;

ii. të dhënat e listëpagesave;

d) Sistemi i Automatizuar i të Dhënave Doganore, si më poshtë vijon:

i. vlera e mallit;

ii. numri dhe data e deklaratës doganore;

iii. vendi i origjinës;

iv. vendi i destinacionit të mallrave;

v. numri i procesverbalit të kontrollit;

vi. rezultatet e kontrollit (konform/jokonform deklarimit);

vii. statusi i deklaratës doganore (regjistruar/pranuar/çliruar).

2. Institucionet ose subjektet që kanë akses në Regjistrë kanë detyrim të emërojnë personin e autorizuar për përdorimin e Regjistrit, si dhe të njoftojnë zyrtarisht me shkresë Agjencinë për emërimin apo ndryshimin e tyre.

3. Pas marrjes së njoftimit për caktimin e një punonjësi të autorizuar nga institucioni ose nga subjekti i licencuar apo i lejuar për aksesimin e Regjistrit apo zëvendësimin e tij, Agjencia, brenda 5 (pesë) ditëve punë nga marrja e këtij njoftimi, aktivizon aksesin, në përputhje me tipologjinë e aksesit në Regjistrë.

4. Agjencia heq aksesin brenda 1 (një) dite pune nga marrja e njoftimit zyrtar për largimin e punonjësit të autorizuar nga institucioni ose nga subjekti i licencuar apo i lejuar për aksesimin e Regjistrit.



5. Agjencia i heq aksesin punonjësve të autorizuar të subjektit menjëherë nga marrja e vendimit për shfuqizimin e lejes apo të licencës.

6. Të gjitha veprimet e kryera në bazën e të dhënave shtetërore të Regjistrit regjistrohen automatikisht në *log*-e të auditueshme e të pamodifikueshme, duke përfshirë kredencialet e përdoruesit, kohën, vendndodhjen, funksionet e aksesit dhe veprimin e kryer.

IV. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Agjencia, në cilësinë e autoritetit rregullator koordinues të bazave të të dhënave shtetërore, harton manuale për përdorimin e Regjistrit dhe planifikon trajnime në ndihmë të përdoruesve, sipas ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”.

2. Mirëmbajtja teknike e Regjistrit kryhet në zbatim të ligjit nr. 43/2023, “Për qeverisjen elektronike”, të ndryshuar. Të gjitha kostot për krijimin dhe mirëmbajtjen e Regjistrit do të mbulohen nga fondi buxhetor i AKSHI-t.

3. Përpunimi dhe mbrojtja e të dhënave personale kryhen në zbatim të ligjit nr. 124/2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar.

4. Çdo ndryshim i të dhënave në Regjistër, përfshirë shtesa apo pakësime, përveç atyre të përcaktuara në këtë vendim, realizohet nga Agjencia, në bazë të një kërkesë të argumentuar nga institucionet dhe subjektet. Efektet financiare për realizimin e ndryshimeve të kërkuara në Regjistër përballohen nga buxheti i shtetit.

5. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia Kombëtare e Kontrollit të *Cannabis*-it, Agjencia Kombëtare e Shqërisë së Informacionit, Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, shoqëria “ALBTrace CO” sh.a. dhe subjektet e licencuara apo të lejuara për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM

Nr. 631, datë 30.7.2026

PËR KRIJIMIN E INSTITUTIT KOMBËTAR ONKOLOGJIK, SI STRUKTURË SHËNDETËSORE UNIVERSITARE DHE KËRKIMORE-SHKENCORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të pikës 7, të nenit 12, të ligjit nr. 109/2024, “Për shkencën dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 28, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe të ministrit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. KRIJIMI, STATUSI DHE MISIONI I INSTITUTIT

1. Krijimin e Institutit Kombëtar Onkologjik, si strukturë shëndetësore universitare dhe kërkimore-shkencore, në vijim “Instituti”, në fushën e onkologjisë, si person juridik në varësi të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, për ofrimin e kujdesit shëndetësor terciar, mësimdhënien universitare e pasuniversitare, si pjesë e Universitetit të Mjekësisë Tiranë, si dhe kërkimin shkencor dhe inovacionin.

2. Instituti ka për mision integrimin e veprimtarisë klinike, akademike dhe kërkimore në fushën e onkologjisë, përmes ofrimit të shërbimeve të specializuara shëndetësore, zhvillimit të arsimit mjekësor dhe edukimit profesional, si dhe avancimit të kërkimit shkencor dhe inovacionit në bashkëpunim me institucionet e arsimit të lartë dhe të kërkimit shkencor.

3. Instituti ushtron veprimtarinë, në përputhje me standardet dhe udhëzimet kombëtare për cilësinë e kujdesit onkologjik, duke synuar harmonizimin me praktikat më të mira të qendrave onkologjike me standarde të njohura ndërkombëtare.

4. Instituti raporton pranë ministrit përgjegjës për shëndetësinë për treguesit e performancës dhe cilësinë e shërbimeve të ofruara.



5. Instituti ka personalitet juridik publik dhe ushtron veprimtarinë e tij, duke shërbyer njëkohësisht, si:

a) institut kërkimor dhe shkencor në fushën e onkologjisë;

b) institut kombëtar reference në fushën e onkologjisë, i cili siguron ekspertizë të specializuar klinike dhe shkencore, mbështet unifikimin e praktikave profesionale dhe harton standarde, udhëzime e protokolle klinike për diagnostikimin, trajtimin dhe ndjekjen e sëmundjeve tumorale;

c) institut për ofrimin e shërbimit spitalor onkologjik për Qarkun e Tiranës, duke garantuar diagnostikimin, trajtimin dhe ndjekjen klinike të pacientëve;

ç) institut me funksione diagnostikuese e trajtuese, si dhe funksione mësimore e kërkimore-shkencore në fushën e onkologjisë, si pjesë e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, dhe në bashkëpunim me /ose universitete të tjera;

d) institut koordinues i Rrjetit Kombëtar të Sëmundjeve Tumorale, duke siguruar bashkëpunimin funksional ndërmjet Institutit dhe strukturave onkologjike në spitalet rajonale dhe vendore;

dh) institut që bashkërendon veprimtarinë me institucione të tjera publike dhe private që ofrojnë shërbime onkologjike, me qëllim garantimin e standardeve të unifikuara të diagnostikimit dhe trajtimit.

6. Instituti koordinon Rrjetin Kombëtar të Sëmundjeve Tumorale, që është tërësia e strukturave shëndetësore publike dhe universitare që ofrojnë shërbime për parandalimin, diagnostikimin, trajtimin dhe ndjekjen e sëmundjeve tumorale dhe shërbimit paliativ, në nivel qendror dhe nivel qarku. Rrjeti Kombëtar i Sëmundjeve Tumorale përfshin:

a) Institutin, si qendër kombëtare reference dhe koordinuese e rrjetit;

b) shërbimet dhe njësitë onkologjike pranë spitaleve universitare, rajonale dhe vendore;

c) strukturat diagnostike dhe laboratorike që kontribuojnë në diagnostikimin dhe monitorimin e sëmundjeve tumorale;

ç) strukturat e trajtimit onkologjik, përfshirë onkologjinë mjekësore, kirurgjinë onkologjike, radioterapinë dhe shërbimet e tjera të lidhura me trajtimin e kancerit;

d) strukturat e rehabilitimit dhe kujdesit paliativ për pacientët onkologjikë;

dh) strukturat e mbështetjes klinike dhe shkencore, sistemet e referimit dhe kundërreferimit të pacientëve;

e) *tumor-board*-et multidisiplinare që janë mekanizma të detyrueshëm konsultimi për rastet onkologjike komplekse. Organizimi dhe funksionimi i tyre përcaktohen në statutin e Institutit dhe në aktet e ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

7. Rregullat e hollësishme për organizimin, funksionimin, raportimin, treguesit e performancës, referimin dhe kundërreferimin, si dhe përgjegjësitë e strukturave pjesëmarrëse në Rrjetin Kombëtar të Sëmundjeve Tumorale miratohen me urdhër të ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

8. Instituti kryen detyrat e përcaktuara në këtë vendim dhe në statutin e tij i cili miratohet me urdhër të përbashkët të ministrit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe ministrit të Arsimit.

II. FUNKSIONET KOORDINUESE TË INSTITUTIT

1. Instituti shërben si institucion koordinues i Rrjetit Kombëtar të Sëmundjeve Tumorale, duke siguruar lidhjen funksionale ndërmjet shërbimit spitalor onkologjik universitar dhe strukturave onkologjike në nivel qarku.

2. Instituti mbështet dhe koordinon zhvillimin dhe zbatimin e programeve të diagnostikimit të hershëm, menaxhimit të riskut, si dhe të kujdesit paliativ për pacientët onkologjikë, në përputhje me politikat dhe strategjitë kombëtare të shëndetësisë.

3. Instituti koordinon shërbimin onkologjik kombëtar dhe, në këtë kuadër:

a) orienton zhvillimin dhe organizimin e shërbimeve onkologjike në nivel kombëtar, universitar, rajonal dhe vendor, dhe mbështet funksionimin e integruar të Rrjetit Kombëtar të Sëmundjeve Tumorale;

b) harton dhe përditëson udhëzime, standarde dhe protokolle të unifikuara për diagnostikimin, trajtimin dhe ndjekjen e pacientëve onkologjikë, përfshirë rrugët e integruara diagnostiko-terapeutike dhe asistencën e pacientit;

c) mbështet zhvillimin e vendimmarrjes klinike multidisiplinare përmes *tumor-board*-eve dhe koordinon bashkëpunimin profesional, ndërmjet strukturave onkologjike rajonale;

ç) përcakton mekanizmat e referimit dhe kundërreferimit të pacientëve ndërmjet niveleve të



sistemit shëndetësor, të cilët bazohen në protokolle të unifikuara klinike, që sigurojnë vazhdimësinë e kujdesit dhe shpërndarjen e drejtë të rasteve sipas nivelit të kompleksitetit;

d) ofron mbështetje profesionale për njësitë onkologjike rajonale përmes konsulencës klinike, trajnimeve dhe programeve të edukimit të vazhdueshëm profesional.

4. Instituti bashkëpunon me Institutin e Shëndetit Publik për funksionimin dhe zhvillimin e Regjistrin Kombëtar të Kancerit, duke siguruar raportimin e të dhënave mbi rastet e kancerit dhe përdorimin e tyre për analizë epidemiologjike, planifikim shërbimesh dhe zhvillim politikash shëndetësore, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

5. Institucionet shëndetësore private, që ofrojnë shërbime onkologjike, zbatojnë standardet kombëtare klinike dhe raportojnë të dhënat epidemiologjike në Regjistrin Kombëtar të Kancerit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për kujdesin shëndetësor dhe shëndetin publik.

6. Instituti harton, përditëson dhe miraton teknikisht udhëzuesit dhe protokollin klinike diagnostiko-terapeutike për sëmundjet tumorale dhe i depoziton ato pranë ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë. Protokollin hyjnë në fuqi dhe bëhen të detyrueshme pas miratimit të tyre me urdhër të ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

7. Ministria përgjegjëse për shëndetësinë ushtron monitorimin institucional e politik mbi mbarëvajtjen e Rrjetit Kombëtar të Sëmundjeve Tumorale, si dhe miraton Planin Kombëtar të Kontrollit të Kancerit, të propozuar nga Instituti.

III. FUNKSIONI MËSIMOR DHE KËRKIMOR-SHKENCOR

1. Instituti, në cilësinë e strukturës shëndetësore universitare, sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë dhe për shëndetësinë, ushtron veprimtari mësimore, praktike dhe kërkimore-shkencore, si pjesë e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, si dhe bashkëpunon me institucione të tjera të arsimit të lartë, vendas ose të huaj.

2. Instituti kryen procedurat e regjistrimit në Regjistrin Kombëtar të Institucioneve, Instituteve dhe Njësive të Veçanta të Kërkimit Shkencor, në përputhje me legjislacionin në fuqi për shkencën dhe kërkimin shkencor.

3. Instituti zhvillon dhe koordinon bashkëpunimin shkencor dhe profesional me

institucione homologe ndërkombëtare, organizata ndërkombëtare dhe rrjete evropiane të kërkimit dhe trajtimit të kancerit, me qëllim përmirësimin e praktikës klinike, zhvillimin e kërkimit shkencor dhe transferimin e teknologjive të avancuara në fushën e onkologjisë.

IV. ORGANIZIMI I BRENDSHËM I INSTITUTIT

Instituti organizohet në organet drejtuese, njësitë e kërkimit shkencor dhe në njësinë e shërbimit spitalor, si më poshtë vijon:

A. Organet drejtuese

1. Këshilli Shkencor i Institutit është organi më i lartë vendimmarrës i institucionit, i cili drejton, orienton dhe vlerëson veprimtarinë kërkimore-shkencore dhe akademike të tij. Këshilli Shkencor përbëhet nga jo më pak se 5 anëtarë dhe kryesohet nga drejtuesi i Institutit. Përbërja, organizimi, mënyra e përzgjedhjes dhe kompetencat e tjera të Këshillit Shkencor përcaktohen në rregulloren e miratuar nga Këshilli Shkencor, në përputhje me ligjin nr. 109/2024, “Për shkencën dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”.

2. Bordi i Administrimit është organi kolegjial përgjegjës për mbikëqyrjen administrative dhe menaxhimin e burimeve financiare e të aseteve të institucionit. Ai përcakton politikat kryesore të zhvillimit institucional, miraton projektbuxhetin dhe mbikëqyr përdorimin e fondeve, në përputhje me objektivat afatgjatë. Organizimi dhe funksionimi i Bordit të Administrimit përcaktohen në statutin e institutit.

3. Drejtuesi i Institutit është autoriteti ekzekutiv, administrativ dhe shkencor i institucionit, i cili emërohet nga ministri përgjegjës për shëndetësinë, bazuar në kriteret akademike dhe procedurat sipas legjislacionit në fuqi. Drejtuesi i Institutit është kryetar i Këshillit Shkencor. Kompetencat dhe detyrat e drejtuesit të institucionit përcaktohen në statutin e institutit.

4. Organet drejtuese të Institutit mbështeten nga stafi administrativ i Institutit, i cili është pjesë e strukturës organizative dhe e numrit të punonjësve të miratuar për institucionin.

B. Njësitë e kërkimit shkencor

1. Qendra Kombëtare e Epidemiologjisë Onkologjike dhe Parandalimit është njësi e kërkimit shkencor, përgjegjëse për koordinimin dhe zhvillimin e studimeve mbi popullatën për shpërndarjen e sëmundjeve tumorale në Republikën



e Shqipërisë dhe menaxhimin teknik të të dhënave të Regjistrit Kombëtar të Kancerit. Ajo hulumton mbi faktorët e riskut mjedisor, profesional e gjenetik, udhëheq shkencërisht programet kombëtare të depistimit (*screening*) dhe koordinon Rrjetin Kombëtar të Sëmundjeve Tumore, duke siguruar bashkëpunimin me Institutin e Shëndetit Publik dhe strukturat rajonale.

2. Qendra e Kërkimit Onkologjik Klinik dhe Terapive të Reja është njësi e kërkimit shkencor, përgjegjëse për ushtrimin e funksionit diagnostikues e trajtues, funksioneve mësimore e kërkimore-shkencore, si dhe për iniciimin, negociimin, formalizimin dhe menaxhimin e studimeve klinike (provave të medikamenteve) në fushën e onkologjisë. Ajo shërben si urë lidhëse midis kërkimit laboratorik dhe pacientit përmes studimit të mutacioneve gjenetike (mjekësisë së personalizuar), vlerëson teknologjitë e reja terapeutike dhe menaxhon marrëdhëniet kërkimore me Universitetin e Mjekësisë Tiranë, Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, si dhe me institucionet homologe ndërkombëtare.

C. Shërbimi Spitalor Universitar Onkologjik

Shërbimi Spitalor Universitar Onkologjik është struktura e Institutit, përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve të specializuara të integruara të diagnostikimit, trajtimit dhe ndjekjes së pacientëve onkologjikë, si dhe shërben si bazë klinike universitare për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, specializimeve dhe kërkimit shkencor si pjesë e Universiteti të Mjekësisë, Tiranë, dhe/ose në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë. Në përbërje të tij përfshihen strukturat e diagnostikimit, kujdesit mjekësor, kirurgjikal, radioterapisë dhe kujdesit paliativ, si dhe farmacia spitalore onkologjike, e cila siguron menaxhimin dhe shpërndarjen e barnave specifike, në përputhje me legjislacionin dhe standardet në fuqi.

Ç. Organet këshillimore dhe strukturat ndërlidhëse

1. Komiteti i Etikës është organ këshillimor për çështje të kërkimit shkencor, bioetikës dhe respektimit të parimeve të integritetit shkencor në studimet me subjektet njerëzore apo materialet biologjike. Përbërja dhe mënyra e funksionimit të tij përcaktohen në statutin e Institutit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për kërkimin shkencor dhe atë shëndetësor.

2. *Tumor-board*-et (Konsultat multidisiplinare) në të gjitha strukturat shëndetësore spitalore, që ofrojnë kujdes onkologjik në vend, janë pjesë funksionale dhe ndërlidhëse e Rrjetit Kombëtar të Sëmundjeve Tumore që koordinohet nga Instituti, duke shërbyer si mekanizëm i detyrueshëm konsultimi dhe vendimmarrjeje klinike për rastet onkologjike.

V. FINANCIMI DHE MARRËDHËNIET E PUNËS

1. Financimi i Institutit Kombëtar Onkologjik realizohet përmes:

a) fondeve të buxhetit të shtetit, të alokuara për funksionimin administrativ të Institutit;

b) fondeve të alokuara nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për shërbimet spitalore, sipas legjislacionit të posaçëm për financimin e shërbimeve spitalore;

c) fondeve për kërkimin shkencor dhe inovacionin, sipas legjislacionit të posaçëm për shkencën dhe kërkimin shkencor;

ç) të ardhurave nga projekte kombëtare dhe ndërkombëtare;

d) donacioneve dhe granteve;

dh) burimeve të tjera, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Instituti përbëhet nga këto kategori personeli:

a) Personel kërkimor-shkencor;

b) Personel akademik;

c) Personel mjek dhe punonjës të tjerë me arsim të lartë, teknik të shkencave mjekësore dhe ndihmësteknikë;

ç) Personel administrativ dhe mbështetës.

3. Marrëdhëniet e punës së personelit të institutit rregullohen, sipas dispozitave të Kodit të Punës.

4. Numri i punonjësve, përfshirë drejtorin dhe punonjësit e kërkimit shkencor, është brenda numrit të përgjithshëm të punonjësve të miratuar për ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë. Numri i punonjësve të shërbimit mjekësor dhe organika e institutit miratohen me urdhër të ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

5. Pagat e personelit të Institutit përcaktohen, në bazë të vendimeve përkatëse të Këshillit të Ministrave.

VI. DISPOZITA TË FUNDIT DHE TRANZITORE

1. Selia e Institutit është në Tiranë dhe stema e Institutit përbëhet nga stema e Republikës dhe shënimet: “Republika e Shqipërisë, Instituti Kombëtar Onkologjik”.



2. Vula e Institutit ka formën dhe elementet e përcaktuara në pikën 2, të vendimit nr. 390, datë 6.8.1993, të Këshillit të Ministrave, “Për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave zyrtare”, të ndryshuar.

3. Drejtuesi i Institutit emërohet brenda (30) tridhjetë ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

4. Personeli ekzistues i shërbimit onkologjik që integrohet në Institut vijon marrëdhëniet e punës pa ndërprerje, në përputhje me Kodin e Punës dhe rregullimet e përcaktuara në aktet nënligjore dhe marrëveshjet përkatëse.

5. Të gjitha asetet, infrastruktura fizike, pajisjet mjekësore, burimet njerëzore dhe detyrimet e Shërbimit të Onkologjisë pranë Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” (QSUNT) i transferohen Institutit brenda periudhës kalimtare, e cila përfundon më 31 dhjetor 2026.

6. Marrëdhëniet ndërmjet Institutit dhe Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” gjatë periudhës tranzitore dhe pas përfundimit të saj rregullohen me urdhër të ministrit përgjegjës për shëndetësinë, i cili përcakton modelin e bashkëpunimit, detyrimet, përgjegjësitë, mënyrën e përdorimit dhe administrimit të burimeve të përbashkëta, si dhe ndarjen e kostove përkatëse ndërmjet palëve. Për zbatimin e këtij vendimi gjatë periudhës tranzitore, ministri përgjegjës për shëndetësinë ngre një grup pune ndërinstitucional, i cili koordinon dhe ndjek procesin, si dhe garanton vazhdimësinë e pandërprerë të shërbimeve.

7. Pajisjet e akseleratorit janë në pronësi dhe administrohen nga QSUNT-ja, si dhe përdoren edhe në funksion të ofrimit të shërbimeve për pacientët e Institutit. Modalitetet e përdorimit, përfshirë planifikimin, prioritetet dhe aksesin, përcaktohen me marrëveshje ndërinstitucionale ndërmjet palëve.

8. Deri në fillimin e funksionimit të plotë të Institutit, sipas përcaktimeve të këtij vendimi, shërbimi onkologjik, pjesë e QSUT-së, do të vazhdojë të funksionojë sipas strukturave dhe organikave të miratuara.

9. Instituti i nënshtrohet auditimit të brendshëm dhe të jashtëm financiar, si dhe vlerësimeve periodike të performancës institucionale, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

10. Instituti siguron transparencën e veprimtarisë së tij në përputhje me legjislacionin në fuqi për llogaridhënie publike.

11. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Ministria e Arsimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2026

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 240 lekë



[[FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË[Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare]Viti: 2026 - Numri: 172]Datë: 05.08.2026 15:08:06
+02:00[[fc6a5223-54ff-487b-be1a-07cff5298635

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik(Qendra e Botimeve Zyrtare)